

UNITED NATIONS

United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES

Mission d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPTI I
SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 9 DHE 10.10.2006

TRANSKRIPT
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 9 i 10.10.2006. godine

SHTATOR – OKTOBAR 2006-10-13

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 1 e 6, 14 dhe 21 shtatorit 2006,
3. Koha për pyetje parlamentare,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/17 “Për prokurim publik në Kosovë”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/49 “Për patentim”,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe të produkteve të tij,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisjet nën presion,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trashëgiminë kulturore,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hulumtimet gjeologjike,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin riprodhues,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për peshkatari dhe akukulturë dhe
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit – nr. 2004/5 “Për naftë dhe derivatet e saj”.

DNEVNI RED

1. Usvajanje dnevno redi,
2. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica od 1 i 6, 14 i 21 septembra 2006.god.,
3. Vreme za parlamentarna pitanja,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 2003/17 “ o javnoj nabavci na Kosovu“,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 2004/49 „ o patentiranju“,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o transfuziji krvi, kontrole krvi i njegovih produkata,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti od buke,
8. Prvo razmatranje Nacrta zakona o opremi pod pritiskom,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona o kulturnom nasledju,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o geološkim istraživanjima,
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o reprodukcijom zdravstvu,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o ribarstvu i akuakulturi i
13. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona broj 2004/5 „o nafti i naftnim derivatima“.

Seancën e kryesoi kryetari i Kuvendit, Kolë Berisha

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Xhevat Bislimi e ka fjalën rreth rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar, zotëri deputetë.

Partitë dhe shoqatat e Vitisë kanë bërë një kërkesë të cilën e kanë dorëzuar në Kryesinë e Kuvendit. Po ashtu kërkesë të tillë kanë bërë edhe partitë dhe shoqatat e Gjilanit dhe kërkesa është për organizimin e referendumit.

Një iniciativë tjetër ka qenë e deputetëve, të cilën e kanë nënshkruar 28 deputetë. Me dy pika, e para, që Kuvendi Kosovës të shpallë urgjentisht referendum dhe pika e dytë ka qenë që Kuvendi i Kosovës të deklarohet kundër decentralizimit “ose copëtimit të Kosovës”. Kjo iniciativë është pezulluar, e ka humbur rrugën dhe ka përfunduar në adresë për të cilën nuk është nisur dhe nuk ka shkuar në Kuvendin e Kosovës dhe jam shumë i bindur po të vazhdonte nënshkrimi i asaj kërkesë, do të nënshkruhej nga shumica prej jush. Prandaj kërkoj që kjo pikë të futet në rendin e ditës, organizimi i referendumit, ose shpallja e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran nga Kuvendi i Kosovës dhe që Kuvendi, ashtu siç është deklaruar gjatë debatit, të deklarohet edhe me votim kundër decentralizimit, ose copëtimit të Kosovës. Kërkoj të votohet për këtë pikë të rendit të ditës. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Emrush Xhemajli e ka fjalën.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAJLI – I respektuari kryetar, qeveritarë të Kosovës, të nderuar kolegë deputetë dhe të pranishëm. Ju përsërites të gjithëve.

Unë e kam një emocion procedural. I respektuari kryetar. A bën të më dëgjoni, ju lutem? Qe disa mbledhje rendi i ditës nuk është duke u punuar në bazë të Rregullores, sipas së cilës rendi i ditës i mbledhjes së sotme duhet të ishte caktuar në seancën e mëparme plenare, siç qe praktikuar mirë para një kohe. Tash ua keni marrë të drejtën deputetëve që edhe ne të marrim pjesë në krijimin e rendit të ditës, por çka është më e keqja duket qartë se ju nuk jeni duke harruar, po ju jeni duke bërë këtë me qëllim, që rendi i ditës të mos përfshijë temat që kërkohen sot nga opinioni i Kosovës, siç janë: shpallja e menjëhershme e pavarësisë, rregullimi kushtetutës, referendumi në radhë të parë për nevojat e Kosovës për ecje përpara. Pra, që t’u përgjigjemi qëndrimeve agresive të të tjerëve, propozoj që rendi i ditës të bëhet menjëherë pas pikës së sotme, të caktohet për mbledhjen e ardhshme si e parasheh Rregullorja. Ju lutem, ta keni këtë parasysh, përndryshe ky Kuvend po duket se është plotësisht i bllokuar ndaj çdolloj iniciative të deputetëve. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit, vetëm për sqarim të rendit të ditës: nëse mbani mend më 1 qershor kemi bërë ndryshimet në Rregulloren e

punës, sa i përket rendit të ditës dhe sipas rregullës 22 rendi i ditës d.m.th. paragrafi i 4 i tij zëvendësohet me tekstin në vijim.

Seanca plenare e Kuvendit mbahet zakonisht 2 herë në muaj. Java plenare fillon, sipas rregullës 23, paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores së punës së Kuvendit, që e kemi zbatuar deri me 1 qershor ka qenë, por kjo është ndryshuar me seancën e rregullt që e kemi mbajtur këtu, ku thotë: Kryesia përgatit një propozim për rendin e ditës për seancën e radhës së Kuvendit dhe menjëherë e vë në dispozicion për deputetët e Kuvendit.

Në fillim të seancës ky propozim i rendit të ditës duhet të konsiderohet i miratuar, përveç nëse një ose më shumë grupe parlamentare apo 6 anëtarë të Kuvendit i propozojnë me shkrim kryetarit të Kuvendit një amendament të ri për rendin e ditës, që duhet të hidhet në votim. Nëse cilido deputet në cilëndo kohë e sheh të nevojshme të amendamentohet rendi i ditës për ta përfshirë një çështje urgjente, duhet ta bëjë një propozim të tillë në pajtim me rregullën 29 dhe nuk ka kurrfarë shkeljeje të Rregullores deri më tash që e tha z. Xhemali.

Ramadan Kelmendi e ka fjalën, ta keni parasysht krejt kohën se 2 minuta e kemi rreth rendit të ditës të diskutohet.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit, i nderuari kryetar, i nderuari kryeministër, të nderuar ministra, deputetë të respektuar.

Kam për obligim, pa dallim, të paraqes kërkesën e qytetarëve të lagjes veriore të Mitrovicës të fshatit Suhodoll 7 shtatori, lagjja e Boshnjakëve, Kodra e Minatorëve ; Gushac, Vinarc dhe Vidimriq, që Kuvendi i Kosovës në një mbledhje sa më shpejtë ta shtrojë çështjen e proceseve politike në Mitrovicë, në veçanti me theks të veçantë krijimin e komunës së re veriore të Mitrovicës, se këta qytetarë kërkojnë që patjetër Grupi Negociator të gjendet sa më parë në mesin e tyre me të vetmin qëllim ta kenë të qartë çka po ndodh në këtë proces dhe të mos marrin rrjedha negative në procese politike në Kosovë. Po që se kjo nuk realizohet ata qytetarë do të na dalin prej dore. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, zoti Bislimi duhet ta ndjekim procedurën e rregullt sipas Rregullores që e parasheh këtë dhe duhet të shkojë kërkesa nëpërmjet zgjidhjes së parashtrësave, Kryesia ta marrë në shqyrtim për formulimin e rendit të ditës dhe ta përfshijë në rend dite, apo jo.
Urdhëroni Bislim edhe një herë

DEPUTETI XHEVAT BISLIMI - Z. kryetar, komuna e Vitisë dhe komuna e Gjilanit zyrtarisht i kanë dorëzuar këto kërkesa të nënshkruara nga të gjitha partitë politike dhe nga shoqatat e atyre komunave. Unë mendoj se mos zyrtarisht sa këto kërkesa që janë shtruar nuk ka si do të ndodhë ndryshe, edhe iniciativa e 28 deputetëve që besoj se do të vijë shpejtë aty, lista me ato nënshkrime, nuk besoj se duhet bërë diçka tjetër. Lëshimet që i ka bërë grupi negociator janë tragjike për Kosovën dhe nuk e di çka duhet të ndodhë që ky kuvend të merret me këtë problematikë dhe me fatin e Kosovës,

sepse dikush rajonin e Ana Moravës nuk po e konsideron të Kosovës, por po e konsideron të huajin, prandaj meriton të caktohet. Edhe kjo është tragjike më vete.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Rendin e ditës së seancave nuk e përcaktojnë komunat as degët në E përcaktojnë deputetët e Kuvendit. Vazdojmë më tutje.

2. Miratimi i procesverbaleve të seancave të 1 dhe 6 shtatorit, të 14 shtatorit dhe të 22 shtatorit 2006,

A ka vërejtje? E dini procedurën që mund t'ia ofroni sekretarisë për të intervenuar në procesverbal në qoftë se ka vërejtje në te, konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të datës 1 dhe 6 shtator 14, shtator dhe 22 shtator 2006, me vërejtjet që mund të jepen.

Pika e tretë e rendit të ditës,

3. Koha për pyetje parlamentare

Ju njoftoj se në pajtim me rregullën 26.1 të Rregullores së punës së Kuvendit koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta. Deri tash janë paraqitur 4 pyetje të deputetëve. Deputeti Gani Koci ka pyetje për Qeverinë e Kosovës, nuk është këtu fare.

Kalojmë në pyetjen e dytë. Deputeti Emrush Xhemali ka pyetje për ministrin e Drejtësisë, Doni ta përsëritni pyetjen? Urdhëroni.

DEPUTETI EMRUXH XHEMAJLI – Më 18 shtator Gjykata e Serbisë në Beograd e ka dënuar më 13 vite burg, në cilësinë e ish -ushtarit të UÇK, z. Anton Lekaj. Unë më parë në seanca plenare të Kuvendit dy herë kam ngritur çështjen e burgosjes së padrejtë në Serbi të qytetarëve të Kosovës. Pyetja është kjo:

Çka kanë ndërmarrë Ministria e Drejtësisë e Kosovës për lirim dhe për sjelljen në Kosovë të z. Anton Lekaj,

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Urdhëroni z. ministër.

MINISTRI JONUZ SALIHAIJ – I nderuari z. kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër i nderuar ministër, deputetë të nderuar.

Z. Lekaj ka qenë i arrestuar në Mal të Zi më 17 gusht 2004 nga një fletë arrest e lëshuar nga një gjykatë paralele në Kosovë që janë ilegale për institucionet e Kosovës dhe për UNMIK-un. Si ministër menjëherë e kam shtruar këtë çështje me drejtorin e Departamentit të Drejtësisë dhe ai më ka sjellë një dokument të nënshkruar nga z. Jesen Petersen të cilin më 9 mars 2006 ia ka drejtuar ministrit të Drejtësisë të Serbisë, Zoran Stojković në të cilin përveç tjerash thuhet:

Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë ka juridiksion parësor ndaj shkeljeve të kryera në Kosovë. Do t'jua përkujtoj se Serbia dhe Mali i Zi si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara duhet t'i pranojë dhe t'i zbatojë vendimet e Këshillit të Sigurimit dhe të lehtësojë implementimin e mandatit të UNMIK-ut në Kosovë. Në këtë kontekst procesi i drejtuar nga paneli për krime lufte i Serbisë është në kundërshtim me Rezolutën 1244 dhe si i tillë duhet të ndërpritet menjëherë, thuhet me një pasus të letrës së Petersenit, që këtë letër e kam me vete.

Më tutje në letër kërkohet që z. Lekaj të sillet para gjykatës kompetente në Kosovë. Z. Xhemaili, Ministria e Drejtësisë ka bërë atë që është e mundur në këtë moment, sigurisht që nuk do të pushojë aktiviteti ynë për një presion shumë më të madh ndaj regjimit të Serbisë për ta ekstraduar z. Lekaj për në Kosovë, edhe pse në këtë moment kemi të bëjmë me kompetenca të rezervuara ende që mendojmë se shpejt do t'i kthejmë. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA –Ju faleminderit. Keni pyetje shtesë? Urdhëroni z. Xhemaili.

DEPUTETI EMRUSH XHEMAILI- Po kjo qenka e lidhur me UNMIK-un, sepse UNMIK-u i ka shkruar Serbisë, mirëpo po duket që nuk ka marrë më tepër se një letër dhe asgjë tjetër, kështu që po të duhet në të ardhmen Anton Lekaj për Grupin Negociator, me siguri do të bëhet trysni më e madhe. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – ju faleminderit. Deputeti Gazmend Muhaxheri, ka pyetje për ministrin e mjedisit z. Gjini. Urdhëroni z. Muhaxheri

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Pyetja ka të bëjë me Këshillin për Planifikim Hapësinor të Kosovës. Ministria e Planifikimit Hapësinor me ligjin e nxjerrë në korrik të vitit 2003, ka paraparë se do të themelojë Këshillin për Planifikim Hapësinor të Kosovës. Drafti i Planit Hapësinor të Kosovës ka ardhur në Kuvend, ndërsa Këshilli për planifikim kaluan 3 vjet e nuk është themeluar, na e shpjegon ministri pse ka ndodhur kjo. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Urdhëroni z. ministër,

MINISTRI ARDIAN GJINI- Ju faleminderit, z. kryetar i Kuvendit, z. kryeministër, të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës. Edhe një herë dua ta falënderoj deputetin Muhaxheri për shkak se është shumë e evidente se në vazhdimësi i ka pasur shumë të qartë punën e Ministrisë dhe punën e ministrive të tjera, prandaj mendoj se edhe pyetja është e qëlluar.

Është e vërtetë se Këshilli për Planifikim Hapësinor nuk është themeluar. Me ligjin e vitit 2003 parashihet të themelohet, ekzistojnë edhe një rregullore ose një udhëzim administrativ nr. 4 i ish -kryeministër të Kosovës z. Bajram Rexhepi, i nënshkruar në fund të prillit të vitit 2004, i cili aty e tutje si akt nënligjor e autorizon themelimin e

Këshillit. Në të njëjtën kohë mund t'ju them se gjatë kohës sa është hartuar plani hapësinor i Kosovës i cili shumë shpejtë do të jetë edhe këtu ,që ka kaluar në Qeveri pa asnjë votë kundër, gjithë ekspertë e Kosovës të cilët do të ishin në Këshillin për Planifikimin Hapësinor janë realisht të konsultuar.

Këshilli për Planifikim Hapësinor do t'i ketë punët e veta për momentin kur miratohet plani hapësinor i Kosovës. Në këtë fazë- edhe pse do të kishte qenë shumë -ndoshta i nevojshëm edhe i dëshirueshëm, problemi i vetëm i Ministrisë ka qenë çështja e pagesës. Me rregulloren nr. 4 me udhëzimin administrativ nr. 4 parashihet që të paguhen anëtarët e Këshillit për Planifikim Hapësinor dhe në tjetër kohë Ministria është ballafaquar me shkurtim të stafit të vazhdueshëm për shkak të obligimeve që dalin nga shumë dokumente të miratuara edhe në Kuvend, nga buxheti i Kosovës dhe nga çështjet e tjera. Në momentin kur ne është dashur t'i shkurtonim stafet e kemi pasur vështirë të angazhohim njerëz tjerë që do t'i paguanim nga buxhetit i Ministrisë.. Kjo është arsyeja e vetme pse nuk ka ndodhur, mirëpo ajo që unë dua t'ju garantoj juve sot është pse nuk është cenuar kualiteti i Planit Hapësinor të Kosovës, për shkak se gjithë ata njerëz të cilët eventualisht do të ishin në këtë këshill, kanë qenë të konsultuar, është bërë një propozim. Unë propozimin e kam me vete, ndoshta për hir të korrektesës do t'ju jap juve z. Muhaxheri, nuk do ta lexoj për shkak se emrat e njerëzve të cilët janë propozuar për këtë këshill dhe do ta shihni se edhe ata njerëz të propozuar janë njerëz që janë konsultuar, kjo do të ndodhë shpejtë, mirëpo për shkaqe buxhetore nuk besoj se mund të ndodhë para 1 janari të vitit 2007. Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Keni pyetje shtesë?
Urdhëroni Gazmend Muhaxheri

DEPUTETI GAZMEND MUHAXHERI – Z. ministër, a është privuar me këtë Kuvend që të jetë gjatë gjithë hartimit të Planit Hapësinor dhe t'i ketë propozimet edhe rekomandimet e këtij këshilli, se ky këshill është formuar në një mënyrë që t'i bëjë rekomandime Kuvendit të Kosovës, për miratimin e Planit Hapësinor të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Z. ministër urdhëroni,

MINISTRI ARDIAN GJINI – Ju faleminderit z. kryetar, mendoj se këtu në këtë Kuvend janë të ulur shumë deputetë të cilët kanë marrë pjesë aktivisht në punë gjatë hartimit të planit hapësinor të Kosovës. Është e vërtetë se këta persona të cilët do të jenë në këshill do ta këshillojnë Kuvendin e Kosovës për çështje më të tutjeshme, por jo gjatë hartimit të planit, për shkak se gjatë hartimit të tij janë konsultuar gjithë ekspertët nëpër sektorë të ndryshëm, janë konsultuar deputetët e Kuvendit, është konsultuar shoqëria civile dhe gjithë njerëzit e tjerë. Do të thotë nuk është cenuar puna e Kuvendit të Kosovës në këtë fazë, mirëpo do të cenohet puna e Kuvendit pas miratimit, për shkak se edhe pas miratimit të planit hapësinor do të ketë shumë punë për Kuvendin e Kosovës, për shkak se dalin shumë çështje të cilat do të jenë objekt i vendimeve vetëm të këtij Kuvendi. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA –Ju faleminderit. Deputetja Sala Berisha Shala ka pyetje për ministrin e Financave. Nuk është këtu, do të thotë mbetet për më vonë dhe pyetja e fundit është nga deputeti Hydajet Hyseni Kaloshi. Urdhëroni.

DEPUTETI HYDAJET HYSENI- KALOSHI – Ju faleminderit z. kryetar. Kjo Qeveri u ka borxh qytetarëve të pakënaqur të Gjilanit. Një pyetje që është shtruar prej tyre shumë kohë më parë dhe është rishtruar këtu. Edhe unë jam i obliguar që edhe një herë t’jua rikujtoj.

Pyetja është :

Si janë shpenzuar mjetet e ndara për eliminimin e pasojave të tërmetit në Gjilan,

Borxhi kur vonohet thonë i shtohet kamata. Unë kësaj radhe do t’i shtroj vetëm një pyetje shtesë:

A janë shpenzuar, përveç tjerash ,këto mjete dhe për destinime të tilla si: terrene sportive dhe treg kafshësh dhe nëse është e vërtetë, cili është shpjegimi i Qeverisë? Presim përgjigjen

KRYETARI I KUVENDIT, KOLË BERISHA – Ju faleminderit.Është një pyetje që është shtruar disa herë .Vërtet deri më tash nuk kemi marrë përgjigje , mbetet për seancën tjetër bashkë me pyetjet që sot nuk morën përgjigje këtu. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi.

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI- I nderuari kryetar, e nderuara Qeveri në krye me Çekun, kam konfirmimin se më 11.8.2006 nr. 02/2482 është pranuar pyetja ime drejtuar ministrit për Komunitete dhe Kthim. Përgjigjen e kam pritur, por nuk kam marrë përgjigje. Ju lutem të më përgjigjet, po e përsëris pyetjen:

Çka është ndërmarrë nga ministria e lartëcekur deri më tani për kthimin e 23820 shqiptarëve të dëbuar nga lagjet veriore të Mitrovicës, dhe pse ende nuk ka filluar ndërtimi i asnjë shtëpie të këtyre lagjeve nga programi i Qeverisë?

Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Kelmendi. Ju e dini që pyetja disa herë përsëritet dhe nuk merr përgjigje, botohet në Buletinin e Kuvendit dhe është një lloj vërejtje Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/17 “Për prokurim publik në Kosovë”.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 1 shtator 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimi e tij në parim.

Ftohet kryeministri të marrë fjalën

KRYEMINISTRI AGIM ÇEKU - I nderuari z. kryetar, të nderuar deputetë, zonja dhe zotërinj,

Para jush për miratim është Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr 2003/17 Për Prokurimin Publik në Kosovë, i cili rregullon përmirësimin e sigurimit të mallrave dhe të shërbimeve publike nëpërmjet prokurimeve efikase dhe me kohë. Gjithashtu Projektligj reformon institucionet e prokurimit publik dhe ndryshon dispozitat e ligjit ekzistues për vendosjen e elementeve kyçe dhe praktike, që mund të kuptohen dhe zbatohen nga zyrtarët publikë në të gjitha nivelet e qeverisjes në Kosovë.

Është me rëndësi të veçantë që ky projektligj ndryshon ligjin ekzistues, ku pasqyrohen më mirë standardet dhe vendoset një strukturë institucionale për zbatimin më të mirë të dispozitave të tij. Një gjë e tillë siguron se prokurimi publik kryhet në mënyrë efikase dhe transparente në Kosovë, me qëllim të kursimit të portofolit të publikut.

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr 2003/17 për prokurimin publik në Kosovë është amendamentuar konform kërkesës suaj. Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit ekzistues bëhet në dy nene dhe atë :Neni 1, ndryshohet materia e nevojshme e përfshirjes së dispozitave të cilat nga propozuesi janë konsideruar si të nevojshme që të ndryshohen. Neni 2, sqaron hyrjen në fuqi të këtij projektligji.

Materia e ndryshuar nga Qeveria ka të bëjë me :

- (a) Ristrukturimin institucional, vendosjen e sistemit më të decentralizuar, përmirësimin e zbatimit të ligjit si dhe ndarjen e funksioneve rregullative nga ato për shqyrtimin e ankesave;
- (b) Rihartimin e disa dispozitave për t'u sqaruar dhe thjeshtësuar ato;
- (c) Ndryshimin e disa dispozitave për shkak të zhvillimeve legislative në lëmi të tjera dhe
- (d) Përveç kësaj, ligji është azhurnuar për t'i përmbushur kushtet e Acquis Communautaire të Unionit Evropian.

Si rezultat i kësaj pune, Projektligji për prokurimin tani është më i qartë dhe me i saktë, më i kuptueshëm, më i gatshëm për t'u zbatuar në praktikë dhe është eliminuar mundësia e keqinterpretimit. .

Projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit Nr .2003/17 për prokurimin publik në Kosovë është aprovuar nga ana e Qeverisë në mbledhjen e saj më 02.08.2006, konform kërkesës së Kuvendit.

Sipas vlerësimit të Qeverisë, miratimi i këtij projektligji, nga Kuvendi përbën një hap përpara në përmbushjen e standardeve në veçanti,të standardeve që promovojnë përmirësimin e qasjes së përgjithshme në prokurim, drejtësi në jetën e përditshme, aplikimin e rregullave me të avancuara, ndikon pozitivisht në buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe në respektimin e historisë tradicionale të prokurimit në Kosovë.

Nisur nga arsyeja qe prokurimi ka vlerë të theksuar jo vetëm për një parti politike, apo një entitet, por për të gjithë qytetaret e Kosovës, presim që çdo qytetar i Kosovës ta

mirëpresë dhe ta mbështet këtë ligj pas miratimit nga ky Parlament, nënshkrimit dhe shpalljes nga PSSP.

Prandaj të nderuar deputetë, ju propozoj që ta aprovoni këtë projektligj me qëllim të implementimit të këtyre standardeve përkitazi me maksimalizimin e ndryshimeve të mundshme në njërën anë dhe në anën tjetër vendosen kornizat ligjore të nevojshme në fushën e prokurimit .Ju faleminderit,

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. kryeministër, fjalën e ka kryetari i komisionit për buxhet z. Naser Osmani

DEPUTETI NASER OSMANI – Ju faleminderit, i nderuari kryetar, i nderuar kryeministër, të nderuar ministra dhe kolegë deputetë . Kam kënaqësinë të paraqes para jush vlerësimin e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe të Komisionit për Buxhet dhe Financa pranë Kuvendit të Kosovës mbi Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për prokurimin publik 2003/17.Me këtë plotësim dhe ndryshim synohet të bëhen ndryshime të cilat janë rezultat i përvojës që është bërë gjatë zbatimit praktik të ligjit në fuqi. Thelbin e ndryshimeve e përbëjnë riorganizimi i strukturës institucionale që është kompetente për mbikëqyrjen e prokurimit publik sipas ligjit në fuqi, komisioni rregullativ për prokurim publik është organ rregullativ dhe njëkohësisht është edhe organ për shqyrtimin e ankesave.

Një përqendrim i këtyre dy funksioneve në një organ është konsideruar se është në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve, për këtë arsye në ndryshimet e propozuara me Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit në fuqi është propozuar që Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik të mbetet organ rregullativ, ndërsa për shqyrtimin e ankesave të themelohet një organ shqyrtues i prokurimit që do të jetë organ i ndarë nga Komisioni rregullativ.

Përveç ndryshimeve të lartpërmendura synohet të bëhen ndryshime edhe në lehtësimin e përdorimit të procedurave të veçanta të prokurimit publik. Duke eliminuar nevojën e marrjes së pëlqimit nga Agjencia e Prokurimit Publik para përdorimit të këtyre procedurave, gjë që ka për qëllim ngritjen e efikasitetit dhe të përsheptimit të procedurave, ndryshimet e tjera konsistojnë në sqarimin e disa dispozitave ligjore për të cilat mendohet se nuk janë të qarta sa duhet. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur disa seanca për shqyrtimin në parim të ndryshimeve të propozuara në të cilën janë ftuar përfaqësuesit e Qeverisë dhe të atyre që i kanë ndihmuar në hartimin e këtyre ndryshimeve. Komisioni ka konstatuar se disa nga ndryshimet e propozuara, siç janë ato për ndryshimin në strukturën e organizimit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit, janë të domosdoshme, sepse i shërbejnë një transparencë dhe një vendosjeje më të drejt lidhur me procedurat e prokurimit në Kosovë. Gjithashtu Komisioni për Buxhet dhe financa është i mendimit se duhet të bëhen ndryshimet të cilat mundësojnë përsheptimin e procedurave të prokurimit deri në atë masë të mundshme duke mos i rrezikuar transparencën dhe drejtësinë e vendosjes që do të mundësonte përsheptimin e realizimit të projekteve të rëndësishme në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Megjithatë Komisioni është i mendimit se një pjesë e madhe e ndryshimeve të propozuara nuk janë

substanciale. Këto ndryshime vetëm e bëjnë një riformulim të ri të ligjit pa ndryshuar përmbajtjen,

Komisioni është i mendimit që ndryshimet, të cilat nuk janë substanciale ,por vetëm kanë për qëllim një strukturim të ri të ligjit, nuk do të pranohen, ngase do të krijojnë konfuzion në zbatimin e ligjit, sepse terminologjia në ligjin që është në zbatim është shumë më e mirë dhe shumë më profesionale se ajo e propozuar tani.

Komisioni shpreh mendimin se ndryshimet janë të mirëseardhura, vetëm aty ku janë të domosdoshme dhe ku do të krijohen procedura transparente si dhe do të vlerësohet zbatimi i ligjit. Prandaj komisioni i propozon Kuvendit miratimin në parim të Ligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për prokurim publik, ndërsa komisioni në procedurën e mëtejme do t'i shqyrtojë dhe do t'i amendantojë ndryshimet e propozuara, në afatin sa më të shkurtër . Ju faleminderit

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Nga PDK-ja a ka përfaqësues?Fjalën e ka deputetja Safete Hadergjonaj.

DEPUTETJA SAFETE HADERGJONAJ – Ju faleminderit z. kryetar. Ne para veti kemi pasur Ligjin për prokurimin publik 2003/7, d.m.th. ne amendamentet për ndryshimin e këtij projektligji, mirëpo, në fakt ndryshimet janë aq të mëdha në këtë projektligj dhe ndryshimet janë të pa arsyeshme, të panevojshme dhe të palogjikshme në pjesën më të madhe të këtyre amendamenteve, d.m.th. në vend që të krijohet mundësia e lehtësimit të zbatimit të këtij ligji, në fakt në shumicën e amendamenteve të cilat janë paraqitur për shqyrtim, vetëm shkaktohen konfuzion dhe vështirësi në aplikimin në praktik të këtij projektligji.

Ne në Komisionin për Buxhet dhe Financa kemi shqyrtuar dhe përfaqësuesi i Zyrës së USAID-it Viliam Kloun Bili edhe ai ka qenë shumë i pakënaqur me pjesën shumë më të madhe të amendamenteve të cilat na janë dhënë për shqyrtim. Neve si Kuvend Komisioni për Buxhet dhe Financa na ka premtuar që së shpejti do të vijë me një reduktim të këtyre amendamenteve të cilat do ta bënin ligjin më funksional dhe më të aplikueshëm. Unë personalisht edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa e kam theksuar disa herë që jam shumë e shqetësuar që këto amendamente të cilat kanë kaluar në komisionin e formuar edhe nga ana e Qeverisë ,ka qenë jo në harmoni me atë të sqarohen amendamentet ,por faktikisht vetëm sa kanë vështirësuar aplikimin e ligjit të mëparshëm dhe se amendamentet nuk bëjnë ndonjë sqarim esencial

Megjithatë , meqenëse ne në Komisionin për Buxhet dhe Financa kemi filluar me një punë efektive dhe ato amendamente çka nuk kanë qenë të nevojshme, faktikisht edhe i kemi anuluar dhe do t'i anulojmë edhe në të ardhmen, mirëpo këto ndryshimet janë jashtëzakonisht të mëdha. Ndoshta ne si grup parlamentar do të kishim qenë më shumë të pajtimit që ky ligj të mos shqyrtohet edhe sot deri sa të bëjmë reduktimin e këtyre amendamenteve dhe vërtet t'i kemi parasysh ato amendamente të nevojshme për t'u ndryshuar, siç është p.sh. organi për rishqyrtimin e prokurimit apo te disa amendamente të tjera ,të cilat ndoshta duhet të hiqen si ka qenë organi rregullativ për rregullimin e

prokurimit publik dhe disa amendamente të cilat e zvogëlojnë afatin e prokurimit publik, por jo në disa amendamente të tjera të panevojshme për t'u shqyrtuar. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Ju faleminderit në emër të AAK-së deputeti Mazllum Kumnova

DEPUTETI MAZLLUM KUMNOVA – I nderuar kryeministër, kryetar dhe ministra, Grupi i AAK-së e ka shqyrtuar me kujdes këtë projektligj dhe me këtë rast ka konstatuar se ligji në fuqi i prokurimit publik gjatë zbatimit në disa nene është treguar i papranueshëm, ka pasur mangësi që kanë reflektuar në ndërlikueshmërinë e procedurave, ka penguar në realizimin e disa pozicioneve të buxhetit, ka pretenduar rregullimin dhe azhurnimin e procedimeve që janë të rregulluar me ligjet e tjera ,si Ligji për menaxhimin e financave publike, të koncesioneve etj.

Duke u nisur nga këto dhe argumentet e tjera e mbështesim nismën për ndryshimin dhe përmirësimin e këtij ligji, mirëpo sot kemi në dorë një projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji dhe hartuesit kanë bërë përpjekje që të kemi një projektligj më të mirë.

Sipas këtij teksti grupi ynë ka vërejtje sidomos në disa nene të ligjit që janë përshkruar thjeshtë me ndonjë korrigjim vetëm terminologjik, disa nene nuk janë korrigjuar , por janë mjegulluar, sidomos në pjesën e parë dhe të dytë të këtij projektligji.

Grupi ynë, përkundër kësaj , mendon se Komisioni për Buxhet dhe Financa, në këtë rast si komision funksional, do ta bëjë korrigjimin e mundshëm në drejtim të funksionalitetit të këtij ligji në praktikë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit, në emër të ORA-së, deputeti Nazim Jashari

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuar përfaqësues i Qeverisë, të nderuar deputetë, Ligji për prokurimin publik është ligj shumë i rëndësishëm për funksionimin ose mirëfunksionimin e pushtetit në Kosovë. Mendoj se jo vetëm në Kosovë por kudo qoftë dhe se si i tillë edhe duhet patjetër t'u nënshtrohet kohë pas kohe rishikimeve dhe përmirësimeve që procedurat të bëhen më efektive . Që ligji të bëhet më i zbatueshëm, duhet ta them këtu në emër të grupit tim edhe si anëtar i Komisionit gjatë kontakteve që kemi pasur në terren, kanë ardhur vërejtje për mënyrën se si është konceptuar ligji dhe këto vërejtje kryesisht janë marrë parasysht edhe nga ata që e kanë amandamentuar ligjin.

Mirëpo, po ashtu duhet të thuhet që shumë më tepër se nevojat për ta përmirësuar ligjin ekziston nevojat për ta arritur aftësinë e zyrtarëve të prokurimit në të gjitha nivelet që ta bëjmë një punë më të madhe në planifikim edhe në programim të shpenzimeve dhe të investimeve, sepse nuk ka ligj që mund t'i përmbushë kërkesat e një shoqërie, po qe se planifikimi dhe programimi nuk rriten cilësisht, prandaj mendoj se nevojat për këtë ndryshim shtrohen patjetër. Ne si komision i kemi trajtuar, mirëpo amendamentet që

kanë ardhur nga Qeveria aktualisht janë të shumta në sasi, kurse pak në cilësi . Ne si komision kemi marrë për detyrë që vetëm ato amendamente të cilat cilësisht e ndryshojnë ligjin , pra që paraqesin një përmirësim cilësor të këtij ligji, të merren në konsideratë, kurse amendamentet të cilat paraqesin formë tërhiqen për shkak të respektimit të punës sonë paraprake. Pra, të mos ia lëmë fajin ligjit, por një pjesë të mirë të fajit ta marrin edhe zyrtarët nëpër gjitha instancat e pushtetit, sepse ata duhet ta rritin përgjegjësinë e vet, cilësinë e punës së tyre, pra duhet patjetër të organizohen trajnime të nevojshme nëse nuk ka përgatitje të mjaftueshme që njerëzit t'i bëjnë planifikimet dhe që koha e tendereve dhe koha e planifikimit të shpenzimeve të shkurtohet, duke pasur parasysh përgatitje më të mira e jo të kërkohet zgjerim aq i madh të kohës më të madhe në ligj. Kjo është ajo që desha ta përcjell. Ne në komision sigurisht që do të punojmë dhe do të bëjmë përpjekje që ta përmirësojmë të gjitha ato pika ku duhet patjetër të bëhen përmirësime. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka Mahir Yagcilar

Sayın Başkan, Sayın Bakanlar, Değerli Milletvekilleri

6+ Parlamento Gurubu, Kamu Tedariklerle ilgili Yasanın Değişmesine ait Yasa Tasarısını dikkatle görüşmüştür. Düşüncemize göre, kamu enstitülerin normal çalışması amacıyla sözkonusu Yasa, tedariklerin faydalı süreçleri sayesinde, malların tedarik edilmesi ile hizmetlerin başarıyla yerine getirilmesi yönünde büyük önem taşımaktadır. Bundan önce onaylanan 2003/17 numaralı Tedarikleri Yasası yanı sıra, aynı Yasanın uygulanması sırasında başarı kaydetmediği görülmüştür, bundan ötürü de önerilen değişimler sayesinde Yasanın daha faydalı olacağı kanısındayız.

Prensipite Kamu tedarikler sürecinin, kendi özel çıkarları yüzünden resmi görevlerini kötüye kullanan ya da saygı göstermeyen şahızlara sert ceza hükümlerinin uygulanmasıyla, ayan Yasa hükümlerinin getirilmesiyle birlikte, en kısa ve uygun bir süre içerisinde gerçekleşmesinin gerekli olduğu düşüncesindeyiz.

Bu yasa Tasarısının metni sözkonusu iken, ortaya atılan yeni önerilerin sayı bakımından oldukça çok ve geniş olması yüzünden, bu Yasanın yeniden görüşülmesinin daha yararlı olacağı kanısındayız.

Bazı maddeler oldukça geniş ve tüm ayrıntıları içermektedir. Örneğin madde 3.5.

Önerilen deęiřtirgelerin alt noktaları sıralamaya göre yapılmamıřtır ve bu, sözkonusu Yasanın standartlara uygun olarak yazılmadıęını göstermektedir.

“Organ i administruar nga drejta e publike” tanımı uygun deęildir ve İngilizce ile Sırpça şeklinden farklıdır.

Komisyon ile Acenta üyelerinin görevinden alınması daha ayan olmalı ve dięer bakanlıklardaki benzeri organlarla uyumlu olarak bileşik süreçlerden ibaret olmamalıdır.

Yasak çalışmalar yanı sıra bu Yasada, kötüye kullanmalar seviyesinin düşürülmesi ve suç işleyen şahızlara tekrar aynı alanlarda çalışmalarının önlenmesi için olanakların sağlanması amacıyla, suç işleyen kişilere karşı sert ceza önlemlerin yer alması da gereklidir.

Önerilen bu Yasanın ilerideki Meclis sürecinde en iyi olası şekilde kazanacağını umut ederek, bunun sayesinde tedarik sürecinin zamanında yerine getirileceği ve mevcut kötüye kullanmalar ile rüşvetçiliğin ortadan kalkacağı kanısındayız.

İlginize teşekkürler!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit, në emër të Grupit për Integrim Numan Baliq

DEPUTETI NUMAN BALIQ – Dozvolite mi da iznesem neka zapaženja u ime grupe za integraciju i u svoje osobno ime. Slažem se sa tim apsolutno da se ardi o zakonu koji je izuzetno važan i mislim da se takođe trebamo svi složiti da je značajno vreme prošlo od donošenja predhodnog zakona do predloga novog zakona o izmeni i dopuni prošlog zakona koji je donetu 2003 god. Pokušao sam da proučim o prošli zakon i predložene izmene tako da se mogu složiti sa onim što su klege malopre rekly, a to je da postoje prava u određenim delovima, preobimnost, preoterećenost, konfuzija različiti pojmovi, zatim mnogi delovi po smislu nisu dovoljno jasno izraženi, a ja bih takođe istakao i vezano za pravopis, odnosno za prevod da je jako loš, albanska verzija, srpskohrvatska verzija i ona treća. Dakle ima velikih nedostataka u toku pisanja toga prevoda i u prijavljivanju mnogih neopravdano nepotrebnih gramatičkih grešaka, mislim da se to ne bih trebalo dešavati u toku donošenja ovakvih zakona. U vezi sa ovim što sam istako vezano za preobimnost, mislim da je zakon napisan na gotovo dve stotine stranica da je hiper volominozan, da u pojedinim delovima postoji prava konfuzija između toga šta je napisano u starom zakonu šta u novom, a šta su predložene izmene. Vrlo se često govori o tome da se pojedini članovi brišu iz starog zakona iako ih pokušate naći tamo nemožete ih naći, ili su jednostavno izmješteni. Ono što bih želeo da istaknem je u vezi sa podrškom vezanom za ostvarivanje realizaciju rada od odbora koji radi na ovom zakonu mislim da imaju neke stavke koje bi se u najmanju ruku trebalo ozbiljno razmotriti. U pojedinim stavkama ovaj budžet mi izgleda prevelik posebno ako se tiče za 2006 godinu kada se samo za inventar spominje 90.000 € i obavezno nabavku dva auta za 40.000€ . Mislim da bi to trebalo razmotriti i da bi trebalo imati u vidu situaciju koja postoji na Kosovu. U vezi sa onim delom koji je dobar mislim da sama namera koja se želi postići u novom zakonu je veoma dobra, a ona razdvaja ulogu regulatorne komisije za javnu nabavku i tela za reviziju nabavke. Dakle, to su dva tela koja zaista moraju biti odvojena, međutim nisam siguran da je baš dobro zakonski precizirano na koji način će telo za reviziju nabavke ostvariti tu potrebnu samostalnost. Dobro je da su one odvojen ali treba raditi u zakonu da se zakonski podpomogne da to telo za reviziju ima zaista stvarnu samostalnost i da se izbegnu oni štetni uticaji o kojima se govori koji su doveli to toga da imamo pravi haos, ako ne jednu pravu poplavu problema u oblasti snabdevanja i posebno onoga što zovemo objavljivanje tendera i nepravilnosti koje se javljaju sa time. Mi smo često bili upoznati sa time na lokalnom nivou više opština tako da sa našeg aspekta je vrlo bitno da se omogući delovanje ovih mehanizama kako regulativne komisije tako i tela za reviziju i da naravno da telo za reviziju ima svoju učinkovitost. Ovde bih dodao takođe da možda fali jedan deo koji bi još pojasnio kako da se omogući ravnopravnost drugih etničkih zajednica u vezi sa celokupnom proceduralnom stvari vezano za tenderski proces, počev od raspisivanja preko obaveštavanja veliki problem je obaveštavanje veoma često je obaveštavanje je nedostupno za pojedine etničke zajednice, potom vezano

za konkurisanje i dodeljivanje tendera, s obzirom da je vrlo često su pojedine etničke zajednice ne ravnopravne u vezi sa krajnim ishodom tendera, na to bi trebalo obartiti pažnju sa predloženim zakonom. U celini mislim da je vrlo važno da se zakon što pre usvoji, slažem se sa predhodnim kolegama koji su rekli da se pojednostavi da se onda pređe na usvajanje što je moguće pre i mislim da trebamo prionuti na taj posao. Hvala vam!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit, fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi

DEPUTETI RAMADAN KELMENDI- I nderuari kryetar, e respektuara Qeveri, deputetë të nderuar.

Në fillim më lejoni të konstatojë se nuk bëhet fjalë për propozim ligjin mbi prokurorin publike në Kosovë siç është cekur në hyrje të shkresës nr. 02 22 55 L/86/1 të datës 7.06. 2006, por fjala është për propozim ligjin mbi prokurorimin publik në Kosovë i cili është miratuar në vitin 2003, andaj shikuar nga këndi i së drejtës ne sot do të duhej dhe natyrisht ashtu po veprojmë të bëjmë shqyrtimin e propozim ligjit mbi ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi prokurorimin publik në Kosovë.

Në fakt kjo nuk ka ndodhur, por kemi të bëjmë me një rrit punim të ligjit mbi prokurorimin publik, Personalisht mendoj se ka shumë arsye që kanë kushtëzuar nevojën e domosdoshmërisë së amandamentimit, plotësimit dhe të ndryshimit, për shkak të zgjidhjeve jo adekuate të cilat janë paraqitur në zbatimin dhe mangësitë të cilat janë paraqitur me kohë ngase nuk janë marrë parasysh dhe pikërisht kemi ardhur në këtë rishqyrtim nga centralizmi i tepruar i strukturës së institucioneve mos harmonizimi i dispozitave ligjore brenda ligjit të cilat nuk kanë bërë sigurimin e plotë të mallrave dhe shërbimeve përmes prokurorimit efikas dhe cilësor, këto shkaqe kanë kushtëzuar domosdoshmërinë e reformës së strukturës së institucionit të prokurorimit përcaktimit vetëm me këtë ligj dhe formave tjera të korrigjimit të përcaktuar si duhet.

Ligji ekzistues e ka vuar në dilemë dhe vështëresi shumë zyre dhe shërbime për aplikimin e tij. Nga ana tjetër edhe ky propozim ligj nuk i përmbahet lidhshmërisë së standardeve dhe vendimit të Kuvendit në hyrje të preambulës si bazë juridike e nxjerrjes së ligjit. Nga se unë kam mundur të kuptojë edhe ky propozim ligj nuk arrin të sigurojë instrumentet metodat mjetet juridike për një shfrytëzim efikas transparent të së drejtës të fondeve dhe të burimeve publike. Në të njëjtën kohë vështërsia e sigurimit të integritetit dhe përgjegjësisë së zyrtarëve publikë dhe nëpunësve civilë është larg. Vlerësojë se shmangia e aplikimit të ligjit mbi prokurorimin nga përfaqësuesi special dhe kryeministri në raste të aktiviteteve specifike dhe nevojat për fshehtësitë ose siguritë i vënë që të dy mbi ligjin dhe parimit i sundimit të ligjit, shiko nenin 3, pika 1, 2, 3, 4, 5, dhe 6 duhet amandamentuar plotësuar në harmoni me ligjet.

Dhe përkufizimi i nocioneve është në disa raste jo i saktë dhe i gjatë me çka humbë qëllimin dhe kuptimin e përkufizimit të nocioneve juridike në rastet konkrete të përcaktuara me këtë propozimligj. Propozimigji nuk garanton siguri të plotë juridike në rastet kur fondet publike ose rezervat publike të dhëna sipas kontratave nuk përdoret për dedikime kontraktuese, çka do të ndrronte më tutje sikurse në rastet konkrete nuk

bëhet si duhet në minimumin e shënimeve për secilin aktivitet të prokurorit, mendoj se dispozita e nenit 13. pika 2 kur dokumentet përgatiten vetëm në gjuhën angleze është në kundërshtim me ligjin mbi barazinë gjuhësore në Kosovë.

Klasifikimi dhe vlerësimi i kontratave përcillen me disa të meta të cilat është e domosdoshme të mënjahen, procedimi në mënyrën kohën dhe trajtimin apo aftësimin e zyrtarëve për prokurorim duhet të jetë më preciz për të mos shkaktuar probleme të hapura dhe dilema profesionale.

Në këtë propozim ligj ka qenë dashur të sigurohet një transparentë më e madhe më efikase në rastet e pranimit dhe të dorëzimit të tenderimit dhe të heqjes dorë nga ai si dhe të gjitha informatat dhe veprimet tjera lidhur me tenderimin. Sigurimi i tenderimit hapja e tenderimit vlerësimi dhe krahasimi i tenderimeve sigurimi i ekzekutivit të tenderimit, shkaqet e tenderimit me çmime më të ulëta, si dhe vlerësimi i arsyes ekonomike njoftimi mbi rezultatet dhe përmbajtjen e tyre juridike përfundimtare gjatë procesit tenderues.

Me këtë propozim ligj nuk është përcaktuar mënyra e zgjedhjes së funksioneve përgjegjëse dhe obligimet e tyre, institucionet e Kosovës për administratën publike, komisioni i rregullimit të prokurimit publik etj, diagrami i organizimit funksioneve dhe përshkrimi i punëve, dhe së fundi edhe në këtë propozim ligj hapet mundësi dhe forma të mundësisë së formimit të agjencisë së prokurimit publik pranë qeverisë, kjo është shpesh po e ngarkon buxhetin e Kosovës dhe për këtë nuk duhet dhënë ndonjë mendim por për këtë agjenci duhet shikuar me mençuri dhe përshtatshmëri ekonomike. Me gjithë këto sugjerime qëllimi dhe qëllimmirët, unë mendoj që në shqyrtimin e parë duhet aprovuar ky propozim projektligj për procedurë të mëtutjeshme. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Selviqe Halimi

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Ju faleminderit z. kryetar, i nderuar kryeministër dhe ju kabinet qeveritarë të nderuar deputetë.

Tash tre vjet të aplikimit të Ligjit për prokurimin publik në Kosovë, shtrohet nevoja e ndryshimit dhe plotësimit të këtij ligji, a thua nevoja për ndryshim dhe plotësim ka marrë për bazë kriteret, çfarë qëllimi po donë të arrijë me ndryshimin dhe plotësimin kur kemi për bazë amendamentin që na ofruar për shqyrtim, sa ka pas për bazë që të ruajë buxhetin e Kosovës kur dihet se vetëm vija buxhetore për paga nuk i nënshtrohet rregullave të prokurimit, kurse të dy vijat të tjera janë të obliguara të shkojnë sipas prokurimit publik, sa ka pas për bazë që të plotësojë zbrazësirat juridike ky ligj duke eliminuar mundësinë e shumë interpretimit të normave juridike të ligjit për prokurimin publik. E kam fjalën edhe për amendamentet e reja të cilat janë ofruar për shqyrtim, dhe sa ka marrë për bazë që të eliminojë mundësinë e shumë interpretimit edhe nga ana e KRPP-së në rast të shqyrtimit të ankesave.

Duke pasur për bazë këto edhe duke pasur për bazë dilemat gjatë zbatimit të ligjit në praktikë unë mendoj se amendamentet e ofruara për plotësim dhe ndryshim të këtij ligji nuk e arrin efektin e duhur, gjegjësisht nuk e arrin këto pikat të cilat i ceka më lartë.

Unë mendoj se edhe Qeveria, por edhe Kuvendi edhe për kundër faktit që në afatet e shpejta kohore kërkohet që të aprovojme ligje dhe ti plotësojmë ato ta ndërprejmë praktikën e aprovimit qoftë edhe në parim të projektligjeve të cilat do të shkaktojnë pastaj edhe në vetë komisionet funksionale, e sidomos kur i kemi për bazë edhe një fakt tjetër, se ligjet e plotësojnë njëra tjetrën dhe amendamentet e ofruara nuk kanë pas për bazë ligjet e reja të cilat janë aprovuar dhe janë në fuqi që nga viti 2003 e këndeje prej kur ky ligj ka hyrë në fuqi.

Unë mendoj se edhe Komisioni funksional, por edhe komisionet tjera apo vetë deputetët që të shprehin interesimin për amendamente që një tekst voluminoz i ligjit për prokurimin publik të zvogëlohet dhe të vijë një tekst më praktik, më i kuptueshëm, dhe në aspektin juridik i harmonizuar me ligjet tjera, por gjithë herë duke i pasur parasysh edhe vërejtjet e auditimeve dhe revizioneve të cilat janë bërë nëpër zyrat e prokurimit në institucionet e Kosovës, qoftë në ato nivelit qendror, apo lokal, me qëllim që të eliminohen mundësitë e keqpërdorimeve apo abuzimeve në forma të ndryshme me buxhetin e Kosovës.

Unë personalisht jam kundër ecjes së këtij ligji qoftë edhe në parim për shkak se nuk e arrin qëllimin e duhur. Edhe në vetë amendamentimin, apo duhet të presim edhe 3 vjet të tjera që të bëhet edhe një plotësim i ri, me qenë se po bëhet plotësimi dhe ndryshimi, atëherë le të bëhet plotësim dhe ndryshim në bazë të vërejtjeve dhe në bazë të sugjerimeve nga vetë zyrtarët të cilët e kanë aplikuar këtë ligj deri tash dhe vetëm ata e dinë më mirë se si dhe në çfarë mase janë shfaqur problemet gjatë aplikimit të ligjit në praktikë. Unë po ju them se shumica e ligjeve e në këtë rast edhe ligji i prokurimit publik diku 80% le mundësi të keqinterpretimit e gjithëherë kur ka mundësi të shumë interpretimeve të një apo shumë normave ligjore, atëherë dihet se ato interpretime do të bëhen me qëllime të caktuara, mendoj se ndoshta është koha e fundit që ne të jemi më serioz dhe të jemi më të përgjegjshëm qoftë edhe gjatë aprovimeve të ligjeve në fillimi, por qoftë edhe gjatë plotësimeve dhe ndryshimeve të ligjeve të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA - Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori, njëkohësisht ftoj deputetët të cilët nuk gjinden në sallë që të kthehen sa më shpejtë.

BEHXHET BRAJSHORI - I nderuari kryetar i Kuvendit, i nderuari kryeministër, ministra të nderuar, kolegë deputetë.

Para veti kemi Projektligjin për ndryshimet dhe plotësimin e ligjit nr. 2003/17, vetë koha ka treguar se është koha për të ndryshuar diçka që është diçka e mirë, sepse praktika tregon realitetin dhe ajo që është bërë në këtë Projektligj unë mendoj se në këtë masë e ka arritur qëllimin e vet dhe para veti kemi një Projektligj me ndryshime dhe plotësime që mund të jetë më efikas se sa versioni që e kemi pasur deri më tash. Me gjithë këtë, mendoj se në tri çështje ne duhet të fokusohemi, qoftë si komisione parlamentare, qoftë si Qeveri bashkërisht për të nxjerrë një ligj përfundimtar të prokurimit më efikas dhe ato tri çështje që do t'i përmendi janë:

1. Që ka të bëjë me afatet e tenderimit, ka hapësirë për të pa se çka mund të bëjmë më shumë në shkurtimin e afateve me qëllim të shfrytëzimit më efikas të mjeteve e sidomos në pjesën e investimeve kapitale.
2. E dyta ka të bëjë me nenin 34 të rinumëruar në nenin 29 që ka të bëjë me blerje të reja dhe me kontratat shtesë që duhet parë aty se çka mund të ndryshohet se ka vend për ndryshim, dhe
3. Ka të bëjë me organin shqyrtues ose organin e ankesave, përkatësisht përbërjen e vetë organit, natyrisht të anëtarëve të bordit qoftë në numër qoftë në kualitet ose në përgatitje profesionale në krahasim me atë që kërkohet në Projektligjin e ndryshuar, nëse arrijmë që këto t'i harmonizojmë në masën e duhur unë mendoj se do të kemi një ligj i cili do të na shërben në formën më të mirë të mundshme për të zhvilluar këtë aktivitet, përkatësisht prokurimin si një nga fushat më të ndjeshme në aktivitetet publike të Qeverisë dhe të institucioneve të vendit.

Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit dhe me që nuk ka të interesuar për diskutim, lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim të ligjit në parim.

Në sallë janë 74 deputet.

Votojmë tash:

Për 49

Kundër 16

Kalon ligji në parim.

Në bazë të rregullës 23 pika 6 të rregullës 35 pika 2 Kuvendi ngarkoi këto komisione: Komisioni për Buxhet dhe Financa si komision funksional dhe referues, Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe kornizë kushtetuese dhe Komisioni për Komunitete.

Kalojmë në pikën e 5 të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/49 për patentim

Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 1 shtator 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj sponsorin e ligjit që ta merë fjalën.

MINISTRI BUJAR DUGOLLI – I nderuari kryetar i Kuvendit, të nderuar deputet.

Unë do të paraqes qëllimin, fushën e rregullimit dhe përmbajtjen e ndryshimit të ligjit për patenta, gjegjësisht propozimin për të ndryshuar nenin 13.1 dhe 13.3 të këtij Ligji. Ndryshimi i këtij ligji është inicuar për këto qëllime, të krijoj bazë ligjore e cila do të implementojë barrierat për vendosjen e sistemit të pronësisë industriale në Kosovë nëpërmjet të krijimit të zyrës së patenteve. Të plotësoj kërkesat e shumta të biznesit

kosovar dhe investitorëve të huaj. Të mundësoj implementimin e ligjeve tjera që kanë të bëjnë me lidhmëri organike me këtë ligj në fushën e pronësisë industriale si dhe të markës tregtare dhe atë të dizajnit industrial, të krijoj një mekanizëm efikas për vendosjen e sistemit të pronësisë industriale konform praktikave të mira të vendeve të BE-së, si dhe kursimin e mjeteve të buxhetit dhe shfrytëzimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore ekzistuese pranë Ministrisë së Tregtisë pa pasur nevojë krijimin e mjeteve shtesë për këtë qëllim.

A r s y e t i m i

MTI ka hartuar programin strategjik për krijimin e sistemit të pronësisë industriale në Kosovë. Ministria e Tregtisë, Industrisë ka Projektuar që nga viti 2005 buxhetin i cili i dedikohet ekskluzivisht funksionimit të zyrës të pronësisë industriale dhe implementimit të sistemit të pronësisë industriale, prandaj funksionim i këtij sistemi nuk do të ketë fare implikime buxhetore. Ministria e tregtisë ka investuar një kohë të gjatë në aftësimin e kuadrit për zbatimin e legjislacionit për vendosjen e sistemit të pronësisë industriale dhe duke marrë për bazë se shumica e vendeve të përparuara me një zhvillim ekonomik të ngritur në botë si Shtetet e Bashkuara, Anglia, Belgjika, Holanda, Sllovenia, Kroacia, Maqedonia, por edhe vendet tjera në rajon, Shqipëria këtë sistem e kanë të rregulluar pranë ministrisë përkatëse me një zyre të tillë, atëherë shtrohet nevoja që edhe ne ta bëjmë këtë ndryshim plotësim që t'i krijojnë mundësi funksionimit të kësaj zyre, njëkohësisht të mos e ngarkojmë as buxhetin me ndërtimin e agjencive që shpesh konsiderohen edhe si ngarkesë e tepruar. Duke pasur parasysh rëndësinë e rregullimit juridik të fushës që e thamë më herët ne kërkojmë nga deputetët e Kuvendit të ta miratojnë ndryshimin dhe plotësimin e këtyre neneve 13.1 dhe 13.3. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA -Ju faleminderit z. ministër. Ftoj përfaqësuesin e LDK-së z. Ibush Jonuzi ta merë fjalën.

DEPUTETI IBUSH JONUZI – Faleminderit kryetar i nderuar i Parlamentit, ministra, të nderuar deputet, të respektuara znj. dhe zotërinj.

Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 2004/49 për patentim që tani po e shqyrtojmë në parim e kemi shqyrtuar ne si grup parlamentar, por edhe Komisioni funksional gjithashtu dhe kemi dalë me vlerësim se ndryshimi i bërë e bën më funksional projektligjin në fjalë. Fjala është për ndryshimin e nenit 13. pika 13.1 dhe 13.3. Agjencia e pavarur që ishte në kuadër të Qeverisë tani propozohet të jetë zyrë në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Grupi parlamentar i LDK-së i jep përkrahje këtij ndryshimi në parim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit në emër të PDK-së deputetja Hatixhe Hoxha.

DEPUTETJA HATIXHE HOXHA – Faleminderit z. kryetar, të nderuar deputet. Ministria e Tregtisë dhe Industrisë duke i parë vështirësitë në zbatimin e ligjit për patentim ka kërkuar të bëhen ndryshime dhe plotësimet në ligjin nr. 2004/49 për patentim dhe këto ndryshime siç u theksuan edhe nga ministri dhe nga përfaqësuesi, gjegjësisht kryetari i Komisionit kanë të bëjnë me nenet 13.1 dhe 13.3 e që i referohen

Agjensionit të pavarur të themeluar në kuadër të Qeverisë. Në Projektligjin që e kemi para vetes neni 1 kërkohet që të fshihet Agjensioni i pavarur brenda Qeverisë dhe në vend të saj propozohet të krijohet zyra në kuadër të Ministrisë së tregtisë dhe industrisë, pra është kërkuar që në vend të këtij agjensionit të jetë kjo zyrë dhe jo në kuadër të Qeverisë, por të Ministrisë. Ne si grup parlamentar po edhe në kuadër të Komisionit e kemi dhënë kontributin tonë dhe mendojmë se është mirë të mbështetet në parim ky Projektligj. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të AAK-së Xhevdet Niziraj.

DEPUTETI XHEVDET NEZIRAJ – I nderuari kryetar i Parlamentit, të nderuar ministra, të respektuar kolegë deputet. Pas iniciativës së Tregtisë dhe Industrisë për ndryshimin e nenit 13.1 dhe 13.3 dhe përkrahjes së Komisionit funksional për ekonomi, tregti dhe industri edhe grupi parlamentar i aleancës përkrah këto ndryshime në këto nene 13.1 dhe 13.3 sepse me këtë definohet më mirë krijimi dhe operacionalizimi i pronave industriale në Kosovë, kjo nuk është vetëm interes, por është edhe obligim i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë. Ky ligj është harmonizuar edhe me ligjet e tjera në fuqi, prandaj edhe ndryshimet e këtij Ligji janë përshtatur rrethanave në Kosovë, prandaj Grupi parlamentar i Aleancës përkrah këto ndryshime pasi që një vizë të gjelbër e ka marrë edhe nga Komisioni për ekonomi dhe Industri ku deputetët nga Aleanca e kanë dhënë kontributin e tyre. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit, përfaqësuesi i Orës e ka fjalën.

DEPUTETI NAZIM JASHARI – Edhe ne e përkrahim këtë projektligj dhe votojmë për.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit, në emër të grupit 6+ Mahir Jakcilar.

DEPUTETI MAHIR JAGCILAR - Meclis Başkanı, Sayın Bakanlar ve değerli milletvekilleri 6+ Parleментар Grubu, Yeni buluş Yasası'nın değişme ve tamamlamalarına ilişkin Yasa Önergesi'ni görüştük ve önerilen değişmelerle bu Yasanın genelde, daha etkili ve pratikte uygulanması için daha isabetli olacağını düşünüyoruz.

Prensipte önerilen değişmeleri destekliyoruz, ancak gelecekte Hükümet ve uygun bakanlıkların Yasaları hazırlamadan önce, yetenek ve yetkilerin saptanması konusuna dikkat etmeleri gerektiğini ileri sürmek istiyoruz. Çeşitli acentalar, kurullar veya komisyonlar ve onların Hükümet ile bağlantısı, Hükümet ile Bakanlıkların önceden hazırlanmış programları ile planlaştırılmış olmalıdır.

Dikkatinize teşekkür ederim.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit, para se t'ja jap fjalën z. Numan Baliq, ftoj deputetët që të kthehen në sallë, se do të votojmë tash, urdhëroni z. Baliq.

POSLANIK NUMAN BALIĆ – U ime grupe za integraciju s obzirom da su se parlamentarne grupe očigledno podržale ovo, mislim da je racionalno i da će to poboljšati efikasnost rada u vezi predloženim izmenama člana 13, mislim da treba ismestiti iz kancelarije premijera u uredu Minstarstvu, dakle podržavam predlog.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Në sallë janë 61 deputetë. Lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Për56

Kundër3

Kalon në parim ky ligj. Ju faleminderit.

Kalojmë në pikën e 6 të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe të produkteve të tij.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve me 1 shtator 2006, dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin e tij në parim. Ftoj përfaqësuesin ministrin Sadik Idriz.

MINISTRI SADIK IDRIZ - Poštovani predsedniče, poštovani poslanici, pozdravljam otvaranje procedure u Skupštini Kosova za usvajanje N/Z o transfuziji krvi, kontroli krvi i njenih produkata, o značajnom dokumentu za zdravlje građana i za zdravstveni sektor uopšte. Imajući u vidu da na Kosovu danas živi preko 2 miliona stanovnika i da prosek građana koji daju krv za bolesnike i povredene je ispod 1% od ovog proseka većina obuhvata porodične davaoce , društveno podržavanje akcije i prikupljanja krvi od dobrovoljnih davaoca je veoma nisko, prosek saobraćajnih nesreća i onih na radu je u dramatičnom porastu, broj trudnica i porodilja dece i ostalih koji imaju potrebe za krv i krvne produkte je takođe u stalnom porastu napominjem da samo u QKU koji ima godišnje 12 hiljada porađaja u 2005. Broj operacija do onih najkomplikovanijih za koje je potrebna velika količina krvi je u porastu, u QKU u 2005 16. 800 operacija. Primena hemoterapije i vrlo brz početak radio terapije na Kosovu posle kojih je neophodna upotreba krvnih komponenta. Potrebu lečenja pacijenta kojih je sve više u porastu sa rođenim poremećajima, tehnološke potrebe radi obezbeđivanja krvnih komponenti radi lečenja pacijenata, promociju davanja krvi na dobrovoljnoj osnovi, anonimno i bez plaćanja na nezadovoljavajućem je nivou. Ovo su razlozi zbog kojih treba da se donese Zakon o transfuziji krvi, kontroli krvi i njenih komponenti. Transfuzionarna medicina je nezavisna disciplina koja se bavi obezbeđivanjem upotrebom i sprečavanjem prenošenja bolesti preko krvi tako da upotreba krvi bude u skladu sa dobrom kliničkom praksom. Cilj N/zakona o transfuziji krvi, kontroli krvi i njenih komponenti je da obezbedi osnovu

za sprovođenje efikasne politike koja će regulisati organizaciju i funkcionisanje službe za transfuziju krvi, kao i za održavanje institucija koje su glavni nosioci odgovornosti. Poštovani poslanici, vredi pomenuti da primena ovog zakona neće imati budžetskih implikacija mada je u jednom predlogu bilo dato od strane onih koji su ga pripremili onda je komisija dala da ostane na nivou 2005/2006 903.000, to su sredstva obezbeđena budžetom do sada, a prednost donošenja n/zakona je jer ova oblast nije do sada regulisana zakonom pa je potrebno i obavezno donošenje ovog n/zakona. Radeći na ovom n /zakonu radna grupa je koristila dokumenta i praksu drugih evropskih zemalja kao i postojaće zakonodavstvo. Radna grupa je u toku izrade n/zakona polazila od zakona o zdravstvu Kosova br.4/2004, zakona o pravima i obavezama građana u zdravstvenoj zaštiti br. 38/2004, zakona o snabdevanju krvlju Slovenije, upustva o primeni i upotrebi obezbeđivanja kvaliteta kopponenta krvi saveta evrope, i drugih dokumenata međunarodnih koji se bave ovom problematikom. N/zakona o transfuziji krvi, kontroli krvi i krvnih komponenti sastavljen je od 7 poglavlja i 40 članova. Na kraju, siguran sam da će diskusija i vaši predlozi poboljšati i proširiti bolje delovanje ovog n/zakona na dobrobit građana Kosova. Hvala!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. ministër. Fjalën e ka deputeti Naim Jerliu në emër të LDK-së

DEPUTETI NAIM JERLIU – Faleminderit z. kryetar, anëtarë të kabinetit qeveritar, të nderuar deputetë. Duke e mbështetur ekspozenë e ministrit lidhur me rëndësinë e miratimit të Ligjit mbi transfuzionin e gjakut, kontrollin e gjakut dhe të produkteve të tij dhe qëllimin e ligjit që të rregullohen aktivitetet për këtë fushë, më lejoni që të bëj një vështrim të shkurtër për disa nga vërejtjet e mia lidhur me projektligjin. Dua të them që në fillim se me ligjin për shëndetësi kjo fushë ishte paraparë që të mbulohet me një akt nënligjor, ndërsa sot ne kemi një propozim që vjen nga Qeveria për të rregulluar këtë fushë dhe mendoj se duke pasur parasysh rëndësinë e rregullimit sa më të mirë të kësaj fushe është ardhur deri te konkludimi që të kemi sot një propozimligj. Në letren përcjellëse që vjen nga Agjensioni për integritet evropiane lidhur me këtë projektligj po ashtu ka pasur disa vërejtje për përputhshmërinë e ligjit me atë të BE-së dhe nuk është shumë e qartë nëse disa nga vërejtjet specifike të këtij Agjensioni lidhur me raportet me legjislacionin e BE-së janë implementuar apo janë në propozim në ligjin që e kemi përpara. Unë po ashtu dua të jap mendimin tim lidhur me disa fusha të cilat ose nuk janë mbuluar fare ose nuk janë adresuar drejt në këtë dokument. Është fjala para së gjithash për raportet midis qendrës kombëtare të transfuzionit të gjakut dhe të spitaleve, respektivisht të institucioneve private, rregullimit të marrëdhënieve të këtyre institucioneve, po ashtu ky Projektligj nuk e mbulon apo nuk e adreson në mënyrë të duhur edhe transportin apo kushtet e transportit të gjakut dhe të produkteve të gjakut. Adreson çështje që kanë të bëjnë me regjistrin që kanë të bëjnë me dhuruesit e gjakut dhe transfuzionin e gjakut, mendoj se çështja e hemovigjilencës do të duhej të rregullohej si kaptinë e veçantë dhe do të duhej të jetë më mirë e adresuar si sistem për adresimin dhe analizën e informatave do të duhej që në Projektligj të gjej vend edhe adresimi i çështjes së reklamimit të gjakut dhe të produkteve të gjakut dhe po ashtu për mendimin tim edhe te kaptina e dispozitave disiplinore ose ndëshkimore apo shkeljeve të këtij ligji , respektivisht dënimeve që do të duhej të pasonin për institucionin dhe individët do të

duhej të jetë kaptinë e specifikuar më qartë dhe jo vetëm një adresim tek zgjidhjet që ofrohen me ligjin për shëndetësi.

Dhe në fund do të thosha se kaptina e dispozitave kalimtare do të duhej të specifikoj në mënyrë në mënyrë të qartë afatet e implementimit të këtij ligji, respektivisht afatet se deri kur do të duhej që Ministria e Shëndetësisë të jetë e obliguar që të nxjerrë aktet nënligjore dhe të përshtat legjislacionin substituar me këtë ligj i cili pritet të miratohet. Ndonëse ligji përshkohet edhe nga disa mangësi që janë edhe të natyrës teknike dhe logjike që e kemi nenin 34.2 që përmban një formulim tejet të paqartë dhe unë në emër të Grupit parlamentar do të theksoj se Grupi Parlamentar i LDK –së mbështet miratimin në parim të këtij ligji dhe ne do të kontribuojmë në punën e mëtejme të komisioneve në përmirësim dhe aprovim të ligjit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të PDK-së Zahrije Jusufi.

DEPUTETJA ZAHRIJE JUSUFI - I nderuari z. kryetar, të nderuar ministra dhe deputetë. Projektligji për transfuzionin e gjakut, kontrollet e gjakut dhe produktet e tij është i rëndësishëm, sepse sigurohet baza ligjore për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e transfuzionit, po ashtu edhe përcaktohen institucionet që janë bartëse kryesore të përgjegjësisë. Edhe pse grupi punues profesionist është mbështet edhe në rekomandimet e këshillit Evropian, për përgatitjen, përdorimin dhe sigurimin e komponentëve të gjakut dhe në rekomandimet e BE-sëe Këshillit Evropian që përcakton standardet e kualitetit dhe sigurisë së grumbullimit, kontrollit, precizimit, procedimit, ruajtjes dhe distribuimit të gjakut human dhe përbërësve të gjakut. Në strukturën e projektligjit nuk zbatohen në tërësi parimet e direktivës së BE-së, nuk merren parasysh çështjet specifike të cilat konsiderohen të obligueshme, do të veçoj disa nene të cilat mendoj se duhet të plotësohen dhe duhet të precizohen. Neni 3 duhet të specifikohen kompetencat e Ministrisë së Shëndetësisë, Qendrës Kombëtare të Kosovës për transfuzion të gjakut dhe njësitë të transfuzionit të spitaleve, për t'i shërbyer funksionalitetit të institucioneve shëndetësore, duhet të shtohet: “Mbledhja e gjakut dhe përbërësve të tij, ekzaminimi laboratorik, verifikimi i cilësisë mund të ushtrojnë edhe institucionet shëndetësore” pra njësitë transfuzive, ndërkaq lejen për punë dhe monitorimin e zbatimit të aktivitetëve e bjen Ministria e Shëndetësisë në kohë të caktuar pas verifikimit se i plotësojnë kushtet për punë në bazë të rregullave të praktikës së mirë dhe standardeve për punë në shërbimet e transfuzionit. Ndërkaq mbikëqyrjen profesionale e bën Qendra Kombëtare e Kosovës për transfuzion të gjakut, njësitë transfuzive janë të detyruara që të gjitha të dhënat e kërkuara t’ia japin në shqyrtim, jo do t’u mundësonte spitaleve t’i kalojnë vështirësitë e shumta që shkakton centralizimi i testimit, vonesa për shkak të transportit dhe distribuimit të gjakut dhe të komponentëve të tij. Projektligji parashikon një numër të madh të dispozitave të cilat duhet të zbatohen përmes akteve nënligjore, nuk precizohen afatet kohore të nxjerrjes së tyre. Mosprecizimi i kriterëve profesionale për këtë është gjaku, plazma ose e qelizave të gjakut në nenin 10.....do të shkaktoj vështirësi në implementimin e plotë të ligjit.

Neni 10 nën 2 duhet plotësuar, nëse sipas kriterëve profesionale, personat e gjakut duhet të përjashtohen përgjithmonë për shkak se në gjak të tyre ka shkaktar që përhapen me transfuzion të gjakut, duhet të përcaktohen sëmundjet dhe gjendjet, po ashtu edhe për dhuruesit që përjashtohen përkohshëm të përcaktohen intervalet kohore, varësisht nga sëmundja apo gjendja e dhuruesit.

Në projektligj mendoj se duhet të shtohet: “Kompenzimi për gjakun e dhuruar”, meqë përqindja e qytetarëve që ofrojnë gjakun e tyre për të sëmurët ose të lënduarit është në 1% dhe numri më i madh përfshinë dhuruesit familjarë dhe se dhurimi i gjakut është vullnetar anonim dhe pa pagesë duhet t’i shtohet përkrahje që dhuruesit të lirohen nga participimi në institucionet shëndetësore, varësisht nga numri i dhënieve. Në emër të Partisë Demokratike të Kosovës e përkrahim në parim, shqyrtim të mëtutjeshëm do të kontribuojmë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KOSOVËS KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të AAK-së deputetja Hundozi.

DEPUTETJA ZYLFIJE HUNDOZI – Z kryetar, ministra të nderuar, kolegë deputetë.

Në ligjin për shëndetësi është paraparë që sfera e transfuzionit të gjakut, kontrollimit të gjakut dhe produkteve të tij të bëhet me akt nënligjor, por si duket Ministria e Shëndetësisë ka probleme me përpilimin dhe zbatimin e akteve nënligjore e në anën tjetër vërehet se ka hiperproduksion në hartimin e ligjeve të vogla edhe me këtë rast po na ofron një ligj të ngjashëm. Në përgjithësi ligji i ka përfshi mjaft kapituj të rëndësishëm për lëmin e transfuzionit të gjakut, por i ka edhe ato që mungojnë fare. Në ato pjesë të paraqitura ka edhe mangësi, vërehet një centralizim i shprehur i veprimtarisë nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe qendrës kombëtare të Kosovës për transfuzionin e gjakut, gjë që e cila ka ekzistuar deri më tani. Ku spitalet e qyteteve tjera pos Prishtinës janë detyruar që para çdo transfuzioni të gjakut ta qojnë gjakun në Prishtinë për testim e pastaj të ipet transfuzioni i gjakut që ka shkaktuar shpenzime të panevojshme të transportit dhe në raste urgjente kjo mënyrë e punës për dike ka mund të jetë fatale. Me formimin e komiteteve spitalore, transfuzive nëpër spitale siç është paraparë me këtë projektligj, kjo çështje nuk rregullohet. Infeksionet e llojllojshme nga transfuzionet janë realitet i përditshëm, prandaj është shumë me rëndësi të bëhet testimi i mirëfilltë i gjakut, të dhuruesit për këtosidomos ato virale siç është testimi i HIV-it dhe hepatitit, para se të bëhet transfuzioni, me asnjë nen nuk rregullohet kjo çështje, por vetëm përmendet shkarazi, për shkak të lëmisë me rëndësi të cilën e trajton ky Projektligj dhe për shkak të mundësisë që komisioni funksional të përpiloj amendamente që do të përmirësojnë kualitetin e këtij Projektligji, grupi parlamentar i aleancës për ardhmërinë e Kosovës e përkrah në parim miratimin e tij. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të Orës deputetja Fatmire Mulhaxha – Kollçaku.

DEPUTETJA FATMIRE MULHAXHA – KOLLQAKU - Faleminderit z. kryetar. Qëllimi i Projektligjit për transfuzionin e gjakut, kontrollin dhe komponentëve të tij ka për qëllim që ta kompletojë legjisllacionin e fushës së shëndetësisë edhe pse siç u cek edhe nga kolegët e mi fillimisht ishte e paraparë që të jetë si akt nënligjor. Megjithatë

duke e pasur parasysh edhe faktet që janë prezantuar në Ligjin që na është ofruar, ku shihen statistikat ku nën 1% sot kemi dhurues të gjakut dhe prej atyre pjesa dërmuese janë familjar, kjo flet që për nevojën e madhe që në një formë të bëhet promovimi i dhurimit të gjakut sot në Kosovë duke i përfshi të gjitha aktivitetet për motivimin, organizimin, edukimin dhe regrutimin e dhënësve për furnizim kombëtar me gjak, çka edhe është precizuar në Projektligj. Ne mendojmë gjithashtu se janë dhënë disa vërejtje për pajtueshmërinë me legjislacionin e BE-së nga Agjencioni për Integritet Evropian dhe mendojmë se në amendamentimin e mëtejshëm të çështjeve specifike të cilat janë potencuar dhe nuk janë harmonizuar me legjislacionin evropian duhet t'i ketë parasysh komisioni gjatë amendamentimit, mirëpo në bashkëpunim me ministrinë e shëndetësisë, konkretisht me kryesuesin e grupit punues.

Vërejtje kamë edhe te neni 34 ku flitet për infektimin e pacientëve të cilët do ta marrin gjakun, nuk është mirë e precizuar se cilat masa do të ndërmerren, sepse këtu duhet të kemi edhe ndëshkime, është paraparë me ligje ekzistuese, mirëpo me siguri duhet të jetë shumë më mirë e precizuar edhe me këtë projektligj sepse dihet se gjaku i cili ju dhurohet pacientëve dhe të gjithë atyre që kanë nevojë duhet paraprakisht të testohet, gjithashtu u fol edhe për mënyrën e centralizuar, sepse ne sot e dimë se shumica gjaku testohet në Prishtinë, por konkretisht për hepatitin “b” dhe “c” dhe më pastaj kthehet në qendrat apo spitalet regjionale dhe kemi shumë vërejtje nga terreni nga mjekët që janë në spitale regjionale për këtë mënyrë tash centraliste.

Gjithashtu kur flitet për dhuruesit duke pasur parasysh një përqindje kaq të vogël të dhuruesve me të vërtetë duhet gjetur forma të stimulimit dhuruesve, sidomos dhuruesve të shumëfishtë, ekzistojnë mënyra të ndryshme me të cilat mund të stimulohen sot dhuruesit e gjakut në Kosovë, prandaj edhe thërras për një propozim konkret që ne deputetët e Kuvendit të Kosovës që të jemi dhurues të gjakut kështu të gjithë dhe sa më shpejt ta thërrasim qendrën e transfuzionit kombëtar për gjak dhe në mënyrë publike të tregojmë që edhe ne jemi ata të cilët do ta përkrahim këtë projektligj dhe dhurimin e gjakut në Kosovë, sepse gjaku dhe derivatete e tij janë diçka që shpëtojnë jetëra e të gjithë atyre që kanë nevojë. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Në emër të grupit 6+ deputeti Gjezair Murat.

POSLANIK DŽEZAIR MURAT – Poštovani predsedniče, g. Ministri, kolege poslanici . Ja bih da se pridružim analizi ovog zakona u ime PG koju predstavljam. Podržavajući mnogo toga što je rečeno o izuzetnom značaju ovog n/z i mislim da se uređuje jedna posebna oblast da se dopunjuje i komplementirna zdravstvena usluga stanovnika Kosova donošenjem ovog zakona i ja bih se ovom prilikom pozabavio alarmatnim podacima koji su izneti da je recimo broj davaoca krvi građana Kosova ispod 1%, porast kada je u pitanju onih koji stradaju u saobraćanoj nesrećama zatim potrebe sve većeg broja ljudi za krvlju iziskuje na jedan način možda i malu dopunu drugog poglavlja ovog zakona koji se odnosi na adavanje i prikupljanje krvi. Mi smo podržavaoci nekih načina stimulanja stanovnika, one kategorije koje su u prilici da daju, ali da se iznađu metode i načini. S obzirom na to da su davaoci krvi dobrovoljci onda načini koje demokratske zemlje već imaju kada su u pitanju stimulanja i neke vrste simulacija kada su u pitanju davaoci

krvi. U tom cilju mi smo zagovornici preciznijeg regulisanja ovog poglavlja kako bi se ovaj cilj postigao. Ova deklaracija kancelarije procesa za evropske integracije pomalo kontradiktorna, jer u jednom delu govori kako je ovaj zakon u skladu sa zakonima Evropske zajednice, a na drugi način daje i primedbu da nepotpuno postavlja pitanja usklađivanja, neka specifična pitanja. Međutim, sve u svemu mi nakon detaljne analize smatramo da se radi o jednom dobrom zakonu što je i diskusija mojih kolega pokazala do sada uz primedbe koje su date nadamo se da dobijemo jedan dobar zakon u oblasti zdravstva. Mi ga u načelu podržavamo. Hvala vam!

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Në emër të Grupit për Integrim Ferid Agani.

DEPUTETI FERID AGANI – Ju faleminderit z. kryetar. Grupi Parlamentar për Integrim e përshëndet dëgjimin e parë të këtij projektligji në Kuvend të Kosovës, ndonëse është e qartë se baza ligjore për nxjerrjen e këtij ligji është kontestuese, sepse ligji për shëndetësi nuk e parasheh aktin ligjor i cili e rregullon këtë çështje, siç thanë edhe disa nga parafolësit e mi, megjithatë ky është edhe një argument më tepër që ligji për shëndetësi duhet t'i nënshtrohet procedurës së amendamentimit sa më të shpejtë, sepse i kemi disa nene të cilat janë në kundërshtim me realitetin ligjor, i cili po krijohet në këtë Kuvend. Konkretisht ky projektligj në një pjesë të rëndësishme në mënyrë shumë precize dhe të saktë i rregullon shumë aspekte të rëndësishme që kanë të bëjnë me gjakun, transfuzionin e tij dhe shumë aspekte tjera të menaxhimit me gjakun dhe derivatet e tij, por mendoj se një mungesë esenciale e ka çështjen e rregullimit të transfuzionit të gjakut, të grumbullimit, ruajtjes, testimit, transportit dhe sektorit privat në shëndetësi. Konkretisht në të vetëm neni 18 paragrafi 3 thotë se sa i përket sektorit privat në shëndetësi kjo çështje rregullohet me Ligjin për shëndetësi i dhe me Ligjin për veprimtari private në shëndetësi, si dhe thirret në ligjin për të drejtat në përgjithësi të qytetarëve për kujdesin shëndetësor. Në qoftë se i shohim këto ligje tash, Ligjin për veprimtari private në shëndetësi e shohim se vetëm neni 5.2 i këtij ligji referohet në çështjet e transfuzionit të gjakut dhe atë i referohet nenit 46 të Ligjit për shëndetësi, d.m.th përgjegjësia po shkon prej ligjit në ligj. Në qoftë se e shikojmë nenin 46 pika "C" të Ligjit për shëndetësi shohim se ai paragraf e rregullon vetëm çështjen e ndalesës së veprimtarisë private në lëmin e grumbullimit të gjakut dhe derivateve të tij dhe asgjë tjetër. Mendoj se një ligj çfarë është ky, që është special, duhet të japë përgjigje të qarta ligjore në lidhje me atë se si duhet të zhvillohen marrëdhëniet në sektorin publik dhe privat dhe të përzier të shëndetësisë ku ka mungesë serioze në këtë aspekt, duke qenë se nuk ofron asnjë dispozitë ligjore dhe asnjë orientim se në çfarë drejtimi këto marrëdhënie do të zhvillohen dhe rregullohen me ligj. Konkretisht derisa vetëm ndalohet çështja e grumbullimit të gjakut nuk bëhet asnjë fjalë për atë se si duhet të ruhet, si duhet të testohet, si duhet të transportohet dhe si duhet të zbatohet transfuzioni dhe cila do të jetë marrëdhënia e institucioneve private shëndetësore, në radhë të parë spitalore me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të gjakut të Kosovës.

Ne si komision parlamentar për shëndetësi kemi pasur përvojë dhe kemi përvojë me amendamentimin e ligjeve të tilla dhe t'ju them se përvoja ka qenë jo fort pozitive, duke ndërhy në aspektet e tilla esenciale të një ligji shumë herë kemi krijuar edhe probleme të

cilat më vonë janë manifestuar në praktikë, ta shohim ligjin për veprimtarinë private në shëndetësi i cili ka hy në fuqi në vitin 2004 i cili ende nuk është dukur e u zbatuar në tërësi për shkak të problemeve të ndryshme teknike të cilat ekzistojnë ndërmjet nivelit qendror dhe komunal të pushtetit sa i përket fushës së shëndetësisë. Duke pasur parasysh këtë që e thash dhe po ashtu edhe vërejtjet të cilat i ka dhënë agjensioni për integritet evropian dhe i cili në tri nene ka konstatuar se direktiva evropiane lidhur me këtë çështje nuk është respektuar. Grupi Parlamentar për integritet propozon që propozuesi i këtij Projektligji ta tërheq këtë projektligj, ta rishqyrtoj edhe njëherë, ta plotësoj me të gjitha aspektet esenciale të funksionimit të tij dhe pastaj t'ia paraqet Kuvendit për miratim. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Para se t'ja jap fjalën deputetit Ilaz Pireva ftoj deputetët që nuk janë në sallë që të kthehen sa më parë.

DEPUTETI ILAZ PIREVA – Edhe unë lidhur me këtë ligj kam disa vërejtje edhe pse shumica prej tyre u thanë nga parafolësit, mirëpo këtu duke u mbështetur në aktin administrativ për themelimin e Qendrës së Transfuzionit të Gjakut dhe në disa ligje të tjera nga fusha e shëndetësisë kemi një shpërputhje. Ndërsa me këtë ligj Qendra Kombëtare për Transfuzionin e Gjakut është si institucion terciar apo tretësor dhe zbaton dhe ofron shërbime të transfuzionit të gjakut dhe të aktiviteteve arsimore dhe të punës kërkimore shkencore në udhëzime kemi që Qendra e Transfuzionit të Gjakut tërësisht të ndahet nga strukturat e Universitetit. Po ashtu kemi edhe një shpërputhje relativisht të madhe edhe me atë që u tha nga parafolësit se si të furnizohen me derivate të gjakut dhe të plazmes së njeriut institucionet private. Ne kemi pritur që mu ky ligj këtë çështje do ta zgjidhë. Për fat të keq siç u tha edhe me parë ligji këtë çështje vetëm sa e prek, por nuk e zbërthen më tutje. Kemi një paqartësi ku thotë se asnjë pagesë nuk mund të behet sa i përket gjakut në anën tjetër kemi thotë një pagesë, e kamë fjalën për akte që e rregullojnë këtë materie mund të bëhet sa i përket shpenzimeve, mbledhjes përpunimit, deponimit dhe thotë se lejohet që të ketë edhe një përfitim të arsyeshëm të cilin e përcakton Ministria, cili është ai përfitim, unë nuk di dhe nuk mund të shohë në bazë të këtyre akteve që i kemi këtu, po ashtu siç u tha se përcaktohet me nenin 46 të Ligjit që nuk lejohet që në institucione private të ketë ato institucione të cilat do të merren me grumbullimin dhe përpunimit të derivateve të gjakut, nga ligjet e tjera shihet se mund të ketë edhe në këtë fushë, kur të licencohen nga Ministria, prandaj është një materie mjaft e ndjeshme për të cilën ky ligj nuk ka ofruar zgjidhje, por besoj që në punën e Komisionit duhet bërë që të gjitha këto dilema të cilat u shtruan sot në leximin e parë gjatë punës sonë të zgjidhen dhe në fund edhe një herë për hartuesit e ligjeve dhe e kamë fjalën pikërisht nga fusha e shëndetësisë është koha e fundit që të bëjnë konsolidimin e terminologjisë juridiko-mjekësore sepse brenda krejt këtyre ligjeve që nuk janë të pakta që janë nxjerrë kemi një terminologji që bie shpeshherë në kundërshtim njëra me tjetrën. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Pasi nuk ka të tjerë të interesua për diskutim lus regjinë dhe deputetët që të përgatiten për votim.

Në sallë janë momentalisht 75 deputet.

Votojmë tash!

Për65
Kundër4
Miratohet ligji në parim.

Ju faleminderit. Pauzë për drekë deri në orën 1,30 minuta.

Fajli 1.

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Po fillojmë sesionin e pasditës, në shqyrtimin e parë të Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen nga zhurma

Projektligji i është shpërndarë deputetëve me 1 shtator 2006, dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore, do t'i adresohen për shqyrtim Komisionit funksional, përgjegjës për raportimin si dhe komisioneve kryesore. Ftojë ministrin Ardian Gjini që, në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të kuvendit, ta prezantojë projektligjin. Ju faleminderit!

MINISTËR – ADRIAN GJINI

Ju faleminderit zoti kryesues,
Të nderuar deputet të Kuvendit të Kosovës,
Në Kosovë zhurma seriozisht dhe në mënyrën më të dukshme, është duke ndikuar në kualitetin e jetës së qytetarëve të Kosovës, qofshin punëtoritë e vogla, apo veprimtaritë e tjera ekonomike, të cilat gjenden në zonat ngusht të banuara, qofshin baret, apo aktivitetet e tjera, të gjitha ndikojnë që. Në mjediset tona ku banohet, kualiteti i jetës është dukshëm më i ulët. Në të njëjtën kohë kjo ulje e kualitetit të jetës, ndikon drejtpërdrejtë në shëndetin e qytetarëve, e aq më tepër shpeshherë shkakton edhe pezëm, edhe konflikte në mes të qytetarëve të Kosovës. Ligji për mbrojtjen nga zhurma, e ka pikërisht qëllimin që t'i evitojë këto dukuri në shoqërinë kosovare, që të ndihmojë në ngritjen e kualitetit të jetës dhe që t'i hapë dyert që këtu e tutje Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës të mund të ndikojnë në përafrimin e normave të lejuara, të krijimit të zhurmës me ato të Unionit Evropian. Hartimi i ligjit, është treguar si domosdoshmëri për këto çështje, mirëpo, edhe për shkak se ndikon drejtpërdrejtë, edhe në planifikimet të cilat i bëjmë, për shkak se ne nuk kemi harta të zhurmës, nuk kemi zona të cilat mbrohen nga zhurma, nuk kemi zona në të cilat do të mund të ketë të paktën edhe trajtime shëndetësore, në të cilat vende territori mbrohet nga zhurma. Ju e dini se, që prej autolarjeve e deri te ofiçinat, ekzistojnë muret e spitaleve të Kosovës. Ky ligj i ka krerët si në vijim:

Kreu i parë, trajton qëllimin e ligjit, për të cilin vetëm sa fola pak më parë dhe shtrirjen në zonat e caktuara dhe përkufizimet,

Kreu i dytë, trajton masat për parandalim dhe mbrojtje nga zhurma,

Kreu tretë, trajton dokumente të nevojshme për menaxhimin e mbrojtjes nga zhurma, siç janë, hartat e zhurmës dhe plani i veprimit.

Kreu katër, trajton përgjegjësinë dhe detyrat, të cilat duhet t'i përmbushin organet dhe personat juridik dhe fizikë,

Kreu pesë, trajton mënyrën e dhënies së lejes për kryerjen e veprimtarive profesionale, për mbrojtje nga zhurma, dhe personave të cilët duhet të jenë të autorizuar nga Ministria.

Kreu gjashtë, trajton organet e autorizuar, të cilat bëjnë mbikëqyrjen profesionale për implementimin e këtij ligji,

Kreu shtatë, trajton dispozitat ndëshkuese, gjobat, dhe shumat e parapara për to, Ndërsa

Kreu tetë, trajton detyrat e Ministrisë, dhe atyre të vetëqeverisjes lokale, për nxjerrjen e akteve nënligjore, si dhe hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Të nderuar deputetë, gjatë kohës së hartimit dhe pas hartimit të ligjit, edhe unë, edhe stafi i Ministrisë së Mjedisit, kanë pasur biseda më shumë prej jush, po ashtu i kanë marrë edhe vërejtjet, edhe sugjerimet, edhe konsideratat të cilët deputet, veç e veç i kanë pasur, për ligjin për mbrojtjen nga zhurma, mendoj se të gjitha kanë qenë shumë të arsyeshme, në fakt e kanë ngritë seriozisht, kualitetin e këtij ligji, mirëpo ato të cilat nuk janë adresua, mendoj se kanë të bëjnë më tepër me, çështjen e normave të lejuara, të llojeve të zhurmave. Për këtë, vetëm kisha dashtë të them se, për ta pasur një ligj i cili hapë dyert, e fillimit të rregullimit të kësaj çështje në Kosovë, ka qenë e vështirë, për të mos thënë e pa mundur, që të inkorporohen të gjitha normat në këtë fazë.

Inkorporimi i të gjitha normave në këtë fazë, do të thotë në Kosovë, do të kishte rrezikua vetë implementimin e ligjit, siç ka ndodhë në disa raste tjera. Për këtë arsye, ne jemi kufizua, për nxjerrjen e një ligji i cili do ta bëjë të pa mundshme, si për Qeverinë, ashtu edhe për Kuvendin e Kosovës, që në vazhdimësi të nxjerrë, dhe të ngritë normat, deri sa të arrin në nivel i cili do të jetë kompatibil, me nivelet të cilat sot gjendemi në Unionin Evropian. Mendoj se, aprovimi i këtij ligji nga ana e juaj sot, do të jetë një ndihmesë e madhe, jo vetëm për Ministrinë dhe për Qeverinë, por për cilindo qytetar, që të fillojmë të mendojmë dhe ta ngritim kualitetin e jetës. Besoj se, secili prej nesh jemi dëshmitar të një ndotje serioze nga zhurma në cilindo kënd të Kosovës. Duke iu thirr edhe një herë, që të aprovohet ligji, ju falënderoj për vëmendje.

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti ministër, tani për ligjin në radhë janë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës, është paraqitur Nekibe Kelmendi.

DEPUTETJA – NEKIBE KELMENDI

Ju faleminderit zoti kryesues, i nderuari ministër, të nderuar kolegë deputet, mendoj se ky Projektligj, siç e tha edhe sponsori është i domosdoshëm për tu proceduar dhe pas amendamentimit për t'u miratuar në Parlament, sepse zhurma mjedisore në Kosovë ka marrë përmasa shqetësuese, e deri më tash nuk ka pasur mundësi të para ndalohet.

Marrë në tërësi, Projektligjin të cilin po e shqyrtojmë, i plotëson parimet e Bashkësisë Evropiane, në këtë fushë. Megjithatë, kamë një vërejtje të përgjithësuar e cila ka të bëjë me shkurtesa që përdoren në këtë projektligj, që është bërë dukuri edhe për ligjet tjera, pra për shkurtesat e institucioneve dhe të organizatave të ndryshme. Mendoj se, emërtimet e institucioneve dhe të organizatave, duhet të thuhet në mënyrë të plotë, kurse në kllapa, mund të jepet edhe shkurtesa e tyre, sepse, për ata që do ta zbatojnë ligjin dhe për vetë qytetarët, të cilët pas miratimit të Projektligjit në Parlament, ky do të merr formën e ligjit, këto shkurtesa nuk janë të kuptueshme, dhe kjo paraqet vështirësi, për implementimin e ligjit.

Kalojmë në vërejtjet e veçanta.

Vërejtja vijuese ka të bëjë me nenin 25. paragrafi 1. nën paragrafi 1, i cili nuk korrespondon me nenin 2, të këtij Projektligji, sepse neni 2, nuk e përcakton fare nivelin e zhurmës, kështu që, neni 25. paragrafi 1. nën paragrafi 1, nuk mund të zbatohet në praktikë, pra gjobitja nuk mund të zbatohet.

Më tutje neni 25. paragrafi 1. nën paragrafi 2. nuk korrespondon me nenin 4 të këtij Projektligji, sepse neni 4. i rregullon masat mbrojtëse dhe zhurmat, siç janë: pengesa e paraqitjes së zhurmës dhe zvogëlimi i zhurmës.

Ndërkaq neni 25. paragrafi 1. nën paragrafi 2, që bënë pjesë në pjesën ndëshkuese, bënë fjalë për gjobitjen në rast të mos lejimit të matjes së zhurmës, nga ana e personit të autorizuar, i cili person në nenin 4 fare nuk përmendet.

Neni 20 paragrafi 1 i Projektligjit duhet të plotësohet me direktivat e BE-së të cilave u referohet ky paragraf, sepse ligjin duhet ta kuptojnë zbatuesit e tij, dhe vetë qytetarët jo të gjithë janë në dijeni, për direktivat e BE-së, andaj direktivat në fjalë, duhet të gjejnë vend dhe të përfshin në këtë paragraf, apo në një nen të ri, ose në disa nene të reja, nëse janë më shumë.

Neni 26. parasheh aktet plotësuese normative për 10 nene, për nenet 2, 7, 8, 10, 11, 12, 13, 17, 18 dhe 19, për të cilat plotësime, autorizohet Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, që t'i njerrë këto akte plotësuese. Ndërkaq, unë mendoj se, Parlamenti nuk mund tija kaloj përgjegjësinë e vetë, një ministrie për plotësimin e neneve të ligjeve, të caktuara me akte nënligjore. Nga ana tjetër aktet nënligjore

duhet të jenë të natyrës udhëzuese dhe ato duhet të shpjegojnë ligjin dhe të lehtësojnë implementimin e tij, e jo ti plotësojnë normat ligjore, madje 10 nene prej 28 neneve sa ka gjithsej ky ligj, në ç'mënyrë ministri do ta merrte rolin e Parlamentit, për plotësimin e ligjit, në rastin konkret të neneve, siç bëhet fjalë në këtë Projektligj dhe si vërejtje e fundit është se, për faktin se ministrit përkatës, i lehet hapësirë që t'i plotësojë këto 10 nene për një periudhë deri në 12 muaj, atëherë në fakt ky ligj nuk do të jetë i zbatueshëm, për derisa të mos plotësohen nenet e lartpërmendura, edhe po të hyjë në fuqi dhe po të nënshkruhej menjëherë nga PSSP-a. Megjithatë, duke e ditur rëndësinë që ka ky Projektligj, e në emër të grupit parlamentar të LDK-së, propozoj që i njëjti në parim, të miratohet në lexim të parë, kurse kontributin e vetë për përmirësimin dhe amendamentimin e këtij projektligji, grupi parlamentar i LDK-së do ta jep në faza të mëtutjeshme.

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zonja Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka Afrim Arzuallxhiu.

DEPUTETI- AFRIM ARZUALLXHIU

Ju faleminderit!

I nderuari zoti kryesues, i nderuari ministër, kolegë të nderuar, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e ka analizuar me përkushtim Projektligjin për mbrojtje nga zhurma, kundër faktit se është një kopje e projektligjit kroat, jemi të mendimit se ky Projektligj, mund të aprovohet në parim ashtu që t'i hapet rruga për punë të mëtutjeshme në këtë Projektligj. Lidhur me rolin dhe rëndësinë e Projektligjit, për t'u mbrojtur nga zhurma, besoj se është e mjaftueshme, atë çka na tha ministri në paraqitjen e vetë dhe ajo çka është e shënuar në materialin që kemi marrë në tekstin e projektligjit. Projektligji është mjaftë i shkurtër dhe relativisht i mirë, kurse vërejtjet që kemi në këtë projektligj janë të tilla, që mund të evitohen dhe të tejkalohen me punën në Komisionin funksional. Vërejtjet, sugjerimet, në këtë Projektligj dhe kontributin tonë në evitim të metave, të këtij Projektligji, do ta japin natyrisht në Komisionin funksional. Pra grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës është për aprovimin në parim të Projektligjit, për mbrojtje nga zhurma. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës zoti Komnova.

DEPUTETI – MAZLLOM KUMNOVA

Ju faleminderit zoti kryesues, edhe Grupi i AAK-së ka treguar gatishmëri për t'u përfshirë në shqyrtimin e Projektligjit, për mbrojtjen nga zhurma, duke u nisur nga faktet se një ligj i tillë i mungon kuadrit ligjor në Kosovë e para, dhe e dyta, rrëmuja urbanistike, që aktualisht është krijuar në Kosovë, ka ndikim që zhurma të jetë një ndër faktorët e përkeqësimit të shëndetit të njeriut . Edhe pse angazhimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për hartimin e një projektligji, të tillë duhet përgëzuar, mirëpo sipas procedurës së hartimit të projektligjit vërehet se ka mangësi ,duke u nisur se grupi hartues është i përbërë vetëm nga zyrtarët e kësaj

ministrie, dhe me sa duket nuk është krijuar ndonjë mbështetje e ekspertëve, të kësaj kompetence, qoftë nga universiteti, apo nga ministrinë e tjera dhe për këtë çështje mendoj se edhe ministri, i dha shpjegimet e duhura. Po ashtu kemi vërejtur se, në parim janë respektuar direktivat evropiane, që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga zhurma, por nuk e dha se cilat janë ato direktiva që janë marrë dhe inkorporuar në këtë projektligj. Në vërejtjet tona parimore zënë vend edhe vërejtja se mungojnë edhe vlerat kufizuese dhe standardet sipas nenit 2 dhe neneve të tjera, edhe pse në nenet vazhduese, i referohen këtij neni, mu për këto vlera kufizuese, dhe standardet përkatëse. Në këtë drejtim, krijohet dilema se a mund të jetë funksional, dhe i pranueshëm ky Projektligj, nesër në praktikë gjatë zbatimit të tij. Është fakt se disa standarde mund të rregullohen edhe me akte nënligjore, mirëpo arsyetimet e tilla shpesh nuk janë treguara, efektive në praktiken tonë. Nëse Komisioni funksional për këtë Projektligj, gjatë procedimit të tij qoftë edhe komisionet tjera, mund të kërkojnë ndihmën dhe të ekspertëve tjerë kompetent, atëherë mund të kemi nesër një ligj të mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti Kumnova, në emër të Grupit Parlamentar ORA, është paraqitur Gazmend Muhaxheri.

DEPUTETI – GAZMEND MUHAXHERI

Ju faleminderit zoti kryesues,

Projektligji për mbrojtjen nga zhurma, ka rekomandimin e Agjencionit për Integritet Evropian, ose na Zyra e Kryeministrit. Mirëpo, duhet të përmirësohet puna e kësaj agjencie dhe vërejtjet e rekomandimet, të cilat i drejtohen këtij ligji, t'i shpërndahen edhe deputetëve, e jo të ndalen vetëm për zyrën e kryeministrit, ose të bashkëngjitet këtu vetëm shkresa që ka ardhur ky rekomandim dhe deputetët e Kuvendit, mos të jenë të informuar çfarë përmbajnë këto rekomandimet dhe cilat janë vërejtjet e kësaj agjencie evropiane, në ligjin në fjalë. Ky projektligj do t'i gëzojë të gjithë qytetarët e Kosovës, që gjatë stinës së verës kanë probleme të shumta me zhurmën që vjen prej lokaleve të natës. Por nëse i mbetet kësaj qeverie zbatimi i këtij projektligj, këta qytetarë që sot i gëzohen, së shpejti do të jenë të zhgënjyer me punën e kësaj qeverie, se ndoshta do t' i duhen nja 4 – 5 vjet me nxjerrë akte nënligjore, pastaj edhe nja 4 – 5 vjet për ta zbatuar këtë ligj, kështu që me punën që janë duke bërë, pas nja 10 vjet ka gjasë të fillojë zbatimi i këtij projektligji. Grupi ynë parlamentar i jep përkrahje këtij ligj të kalojë dhe të miratohet në Kuvend, edhe të miratohet, po shpreson që një Qeveri e ardhshme ndoshta do të jetë më e përgjegjshme dhe do ta futë në funksion më shpejt. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti Muhaxheri, në emër të Grupit Parlamentar 6+ janë paraqitur Rifat Krasniq dhe Husnija Boshkoviq.

Cili keni me folë?

DEPUTETI – RIFAT KRASNIQ

Ju faleminderit zoti kryesues,

Tarimçilik, Ormancilik ve Çevre Komisyonu adına, oldukça önemli olan bu Yasa Tasarısıyla katkıda bulunan Çevre Bakanlığının çalışmasını selamlamak istiyorum. Düşünceme göre, bu Yasayla, Kosova yöresinde gürültü ve kirlenmeyi yaratan öznelerle karşı gereken koşullar sağlanmakta ve garanti edilmektedir. Sözkonusu proje, otomobiller, uçaklar ve çevrede gürültü yaratan tüm diğer teknik araçlar sayısının artması neticesi olarak mevcut durumun bir göstergesidir. Bundan ötürü, Başkanlığımı yapmış olduğum Komisyonun bu yönde gereken katkıyı sunacağından eminim.

Teşekkürler! Ju faleminderit zoti kryesues!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit, në emër të Grupit për Integrimin zoti Gjergj Dedaj.

DEPUTETI – GJERGJ DEDAJ

Mbasi unë bëj zhurmë shumë shpesh, po bëj edhe tash, edhe është mirë që e përgëzoj edhe kryetarin, e Kryesinë e Kuvendit që Ligjin për peshkatari për zhurmë, për plehra kimike, ka dhënë shumë art, tepër prioritet, se çështjes së statusit të referendumit, Kushtetutës që, po edhe kjo është një pjesë e zhurmës parlamentare, që mendoj bëhet nga ana demokratike, por ndoshta nuk kuptohet mirë në Kosovë, kryetari që shkojë, ka qenë në një mbledhje ku keni qenë edhe Ju zoti kryesues, kur është marrë një ide, një qëndrim, që të futet shumë shpejtë çështja e hartimit, të Kushtetutës së Kosovës, e në momentin kur është shumë e rëndësishme, çështja e statusit, Ju keni qitë do ligje që janë të rëndësishme, por që mendoj që kanë pasë kohë me u shqyrtue pakëz vonë, e çështjet prioritare, po i mbyllni sytë para çështjeve që janë kruciale është shumë keq.

Grupi Parlamentar për Integrimin, i jep përkrahje këtij ligji, por shpresojmë që në shqyrtimet e mëtejme, d.m.th. në Komisionet përkatëse, do të kihet parasysh ku isha ndalë në një çështje që, mu si qytetar të Prishtinës, ku është një kaos në trafik, më pengon çështja e zhurmës, që po na bëjnë makinat e Qeverisë së Kosovës, edhe të presidencës, edhe të institucioneve, të ministrave, që shpeshherë shumë herët po na i zgjojnë fëmijët nga gjumi, me ato sirenat, unë i kuptoj se janë shumë të ngutshëm, dhe shumë dinamik, në kryerjen e obligimeve dhe detyrave që i kanë para vetes, por unë mendoj se duhet të përcaktohet me ligj, se kur dhe si mund ti përdorin ato buri, posaçërisht në vendet urbane, ku sinjerisht kohë e pa kohë e ndoshta kur ju ngutet me shkua në ndonjë restorant, pa nevojë bëjnë një zhurmë të madhe. Ju faleminderit shumë!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti Dedaj,

Unë jo me qëllim ku me e ditë se çfarë, por jam i obliguar që të replikoj dhe t'i referohem Rregullores të Kuvendit, zoti Dedaj, të cilën duhet ta shohësh se Kryesia

nuk i bjen ligjet dhe nuk i bën ligjet. Kryesia menaxhon kërkesat e Qeverisë dhe ajo i ka sjellë këto ligje dhe ne i kemi sjellë në Parlament.

2. Kërkesat e Parlamentit të Kosovës, Kryesia do t'i shqyrtojë çdo herë, por jo edhe kërkesat të cilat, nuk e kanë kohën e duhur, prandaj nuk më duket e drejtë ajo që, po akuzoni kryetarin në këtë rast, nuk po dua me e mbrojt, as Kryesinë e Kuvendit, por ne jemi organ më shumë teknik, i këtij Kuvendi, që udhëheqim mbledhjet, që përpiqemi me e bë një rend të ditës, të pranueshëm, konform rregullave që na i keni caktuar ju vetë, këtu sipas Rregullores.

Për fjalë është lajmëruar deputetja Remzije Nimani.

DEPUTETJA- REMZIJE NIMANI

I nderuari kryesues, i nderuari ministër, zonja dhe zotri deputet!

Parimisht përkrah Qeverinë që na e ka sjellë në shqyrtim Projektligjin për mbrojtjen nga zhurma, ngase në rrethanat e tanishme, zhurma në jetën e përditshme është bërë kompleks, që e dëmton dhe e pengon jetën normale. Mendoj se rregullimi i pengimit të zhurmës, do të ketë një rëndësi të madhe dhe do të jetë një rregullim i përcaktuar me ligj, mbi masat mbrojtëse nga zhurma. Në veçanti mbrojtjen nga zhurma duhet kërkuar edhe nga entet dhe institucionet, sikurse nga personat fizikë, ashtu edhe ata juridikë. Mendoj se nuk janë përcaktuar të gjitha format e mbrojtjes efikase nga zhurma. Në veçanti në orët e mbrëmjes, nga kafiteritë, motelet dhe hotelet, të cilat pa ndërprerje dhe pa të drejtë, me muzikën përtej mase, ushtrojnë dhunë psikike mbi qytetarët. Ngjashëm me këtë është edhe përdorimi i tepruar i zërave të sirenave të automjeteve, qofshin ato private, të SHPK-së, apo edhe të KFOR-it. Vlerësoj se preambula e Projektligjit fillon me rregulla, me Rregulloren e UNMIK-ut, në vend se të fillojë me dispozitat e Kornizës Kushtetuese. Projektligjit nuk përcakton zona të qeta, gjegjësisht mjediset ku nuk guxon të ketë fare zhurmë. Zhurmë mbi bazën e prioritetit të krijimit të qetësisë. Zhurma jo vetëm se është e dëmshme për shëndetin e njeriut, por ajo është edhe në kundërshtim me vlerat e lejuara njerëzore.

Mendoj se masat mbrojtëse nga zhurma duhet të saktësohen edhe të caktohen, sikurse që duhet të përcaktohen edhe përgjegjësitë, për realizimin e mbrojtjes nga zhurma. Po ashtu duhet të përcaktohet dhe organi përgjegjës, i cili do të shqyrtojë ankesat dhe shqetësimet e qytetarëve, duke pasur kompetenca që ta mbrojë vërtet qytetarin nga zhurma, sipas standardeve ndërkombëtare.

Zhurma dhe mos qetësia, sikur shkojnë barazi dhe këtu ligji nuk përcakton shqetësimin dhe zhurmën që shkaktohet nga përdorimi i armëve në ahengje të ndryshme. Ndonëse më vjen keq, por duhet theksuar se, zhurmë shkaktoj edhe grupet dhe individët e pa përgjegjshëm, me britmat e tyre natën, apo ditën, si pasojë e konsumimit të alkoolit. Si pasojë e zhurmës në mjedise të caktuara është e drejtë që, para se të ndërtohen objekte të ndryshme, të merret pëlqimi paraprakisht nga qytetarët, dhe të garantohet nga investitori se, nuk do të ketë zhurmë. Nga projektligji unë kuptoj, se nuk janë përcaktuar qartë kompetencat mbrojtëse nga zhurma, në mes të komunës dhe Qeverisë, dhe kjo do të rezultojë që, zhurma të vazhdon edhe më tutje. Mendoj se në Kosovë mungojnë mbikëqyrësit që do të

aplikonin këtë ligj dhe do të pengonin zhurmën, ngase askund nuk kemi inspektor të mjedisit. Projektligji nuk saktëson çka kuptohet, me kufijtë e lejuar të zhurmës. Me këto vërejtje dhe sugjerime, përkrahi në parim Projektligjin duke shpresuar se, me amendamente konkrete do të plotësohet edhe më mirë. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zonja Nimani, për fjalë është paraqitur deputeti Emrush Xhemajli.

DEPUTETI – EMRUSH XHEMAJLI

I respektuari kryesues, të nderuar kolegë deputetë dhe ministra, Është bërë zakon që të thuhet se projektligjet që po ofrohen janë në pajtim me normat e të drejtave të njeriut, me normat e Bashkimit Evropian e kështu me radhë, por sa i përket Projektligji që të është ofruar për mendimin tim mbetet shumë për t'u dëshiruar në këtë aspekt. Unë nuk po pajtohem aq me atë që e tha zoti Dedaj. Ky projektligj i ka interesuar bile shumë, Qeverisë së Kosovës, edhe e ka pasur si prioritet jo bash krejt pa rëndësi. Duke i pasur parasysh ato që i thashë më lart, mendoj se Projektligji duhet të jetë në pajtim jo vetëm me të drejtat e njeriut, por edhe me normat e shtetit.. Duke i pasur këto parasysh, mendoj se në këtë Projektligj, duhet bërë këto ndryshime, po tash po them konkrete

Në nenin 15 2, thuhet kështu: zhurma e cila shkaktohet në raste të manifestimeve, nuk guxon të depërtojë në rrugët ose vendet e tjera. Kjo pjesë duhet të hiqet edhe për faktin se është e pazbatueshme edhe për faktin se nuk mund të kështu të ndodhë. Kjo pjesë duke qartë se, është kufizim i të drejtës së qytetarëve për të protestuar, përkatësisht ky nen, merret me kufizimin e pa arsyeshem, të një të drejte që hynë në kuadër të drejtave themelore të njeriut. Merre me mend, aq do të disiplinoheshin protestuesit, saqë sipas ligjit, nuk duhet të ndihet zëri i tyre përtej rrugës. Ku protestohet, pra, këtu qahet halli i Qeverisë, e jo halli i zhurmës që i bezdis qytetarët.

Janë disa nene tjera. Kur lejohet zhurma, me pasoja të rënda për mendimin tim, edhe për imazhin e një vendi dhe shteti, për të cilën nuk duket se janë, e çajné kokën fort propozuesit e ligjit. Andaj, unë mendoj se pjesërisht duhet të hiqet paragrafi 3. i nenit 16. dhe duhet të mbetet lejimi i i zërimit ditëve të festave, ndërsa ritet religjioze, me gjithë respektin reciprok të feve në mes veti, i mban secili në mënyrën e vet tradicionale, ashtu siç ka qenë, pa i penguar të tjerët. Kjo pjesë e paragrafit duhet të hiqet ,sepse e favorizon edhe e rrit garën dhe përçarjen fetare, në kurriz të qytetarëve, që dëshirojnë të jenë neutral në këtë luftë, të pa deklaruar që po stimulohet sot, kundër Kosovës për t'ia marrë pavarësinë asaj.

Kush punon në zyrat e Kuvendit të Kosovës, e këtu ka disa që punojnë, e dinë mirë se a mund të punohet në disa pjesë të ditës, nga zhurmat që vijnë dhe nga ato lloj zhurma që përzihen temat vendore, e ndërkombëtare me krijim përbërje, kështu siç jemi vendas e ndërkombëtar.

Me këto vërejtje që thashë, cilat mendoj se janë shumë esenciale, dhe mendoj se gati si pikërisht për këtë edhe u pru ky ligj këtu, se nuk është bash krejt kot, parimisht do ta mbështesja në vijim, në parim, ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti Xhemajli, për fjalë është paraqitur deputeti Husnija Beshkoviq.

DEPUTETI – HUSNIJA BESHKOVIQ

Hvala poštovani predsedavajući, poštovani ministri, dame i gospodo poslanici. Nacrt zakona o zaštiti od buke zasnovan je na strategiji zakonske osnove Ministarstva i Vlade, da se ostvari mogućnost da imamo zdravu sredinu za građane Kosova, da imamo veću građansku odgovornost i veći privredni razvoj. Zakonom o zaštiti od buke na teritoriji Kosova investitori, individualni građani ulaze u postupak obaveza i prava koje proizilaze iz ovog zakona. Za razliku od postojećeg zakona o zaštiti od buke ovaj N/zakona je neophodan zbog postojećeg stanja povećanog broja emitere buke, vozila, aviona i drugih tehničkih sredstava koja zagađuju sredinu od buke. Zakoni koji su do sada na snazi ne odgovaraju sadašnjoj situaciji ekonomskog i industrijskog razvoja Kosova. Neophodnost ovog zakona zasniva se na potrebi da matriju iz oblasti zaštite životne sredine uvede u adekvatan zakonski okvir. Ovaj N/zakona teži da uspostavi osnovne principe u cilju izbegavanja, sprečavanja ili smanjenja prioriternih štetnih efekata kao rezultat buke u okolini. Vodeći cilj ovog zakona je potreba usklađivanja standrada životne sredine Kosova sa onim iz evropske zajednice. Razmatrajući ovaj N/zakona uočili smo izvesne nedostatke, primera radi: u n/zakonu nigde nisu posebno obrađene sadašnje i buduće turističke destinacije Kosova. Do duše pominju se strateške mape ali koje nisu dovoljno precizne u regulisanju materije kada su u pitanju turistička naselja Kosova, gde bih po našem predlogu na primer u turističkim zonama trebalo eksplicitno zabraniti izvođenje građevinskih radova u špicu turističke sezone. U primerku n/zakona koji ja posedujem, dakle ja lično, priložena je deklaracija kancelarije za evropske integarcije, ali ova deklaracija koja je priložne u zakonu koji ja imam se odnosi na zakon o eksproprijaciji, a ne na zakon o buki. Verovatno je napravljena tehnička greška koju treba što pre ispraviti, takođe je veom neophodno detaljna lektorska obrada ovog n/zakona. I pored navedenih nedostataka, ali zbog važnosti zakona PG 6+ u načelu prihvata ovaj n/ ona, a svoj dalji doprinos daćemo u procesiranju istog u daljem postupku. Hvala vam!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit, në radhë është deputeti Berat Luzha

DEPUTETI – BERAT LUZHA

I nderuari zoti kryesues, unë pajtohem parimisht me referimin e ministrit, për Projektligjin për mbrojtjen na zhurma, por kamë disa vërejtje konkrete të cilat shpresoj se do të eliminohen gjatë amendamentimit në komisionin përkatës. Ky projektligj kemi një fjalor prej 35 përkufizimeve që është tepër shumë, kurse shumica e këtyre përkufizimeve janë bërë kotë, sepse ato nuk përdoren në tekstin e ligjit, d.m.th. nuk korrespondojmë me tekstin, si janë bie fjala hekurudhë kryesore, aeroport i madh, relacioni bazë, ndikim, mision, pastaj indikatorët e zhurmës të quajtura LDMN L-ditë L-mbrëmje, njejtë e kështu me radhë, d.m.th. se, për çdo përkufizim duhet të jetë zbatimi ,në tekstin vijues të ligjit.

Është e diskutueshme kur rruga kryesore në këtë projektligj, përkufizohet ajo rrugë në të cilën kalojnë mbi 3 milion automjete në vit, hekurudhë kryesore çfarë në

Kosovë nuk ka, qenka hekurudha nëpër të cilën lëvizin mbi 30 mijë trena në vit, kurse aeroport i madh qenka ai, që ka mbi 50 mijë lëvizje në vit. Këso përkufizimesh për këto nocione, deri tash nuk kemi dëgjuar, ndoshta janë standarde ndërkombëtare, por në Kosovë, këto standarde nuk arrihen sidomos tani për tani.

Sipas nenit 26, duhet që brenda 12 muajve ministri të nxjerrë 10 akte nënligjore, që është numër tepër i madh, dhe që le të kuptohet ose do të vështirësohet, jashtëzakonisht zbatimi i ligjit, ndaj do të mbetet në vullnetin e ministrit, rregullimi i vazhdueshëm i normave të ligjit. Sidoqoftë mendoj se, ligji është i mirë, është shumë i nevojshëm, por për rrethanat tona, është shumë vështirë i zbatueshëm. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zotri Luzha, për fjalë është paraqitur deputetja Naxhije Doçi.

DEPUTETJA- NAXHIJE DOÇI

Ju faleminderit zoti kryesues, i nderuari zoti kryesues, të nderuar ministra, kolegë të nderuar deputet dhe të gjithë ju të pranishëm në sallë.

Projektligji për mbrojtjen nga zhurma, është shumë i nevojshëm dhe i një rëndësie shumë dimensionale, për kohën dinamike në të cilën po jetojmë, se krijon një mjedis të shëndoshë, për qytetarët e Kosovës.

Edhe ne banorët e Kosovës, kemi nevojë për standarde mjedisore, të rregulluara legjislativisht mirë, në harmoni me ato të Bashkësisë Evropiane, se ne Evropë jemi, jo vetëm gjeografikisht si vend, por tani edhe si shteti bërë mirë, me mundin dhe me sakrificat e të gjithëve. Flakja e euforive të zhurmshme, që krijojnë efekte të dëmshme, ndjeshmëri dhe bezdisje te të tjerët, duhet të jetë kulturë dhe etikë, edhe e jona në Kosovë, se edhe ne jemi popull i civilizuar. Vërejtjet e mija në këtë Projektligj, i kamë nda në dy grupe.

Grupi i parë, ka të bëjë me disa plotësime të këtij Projektligji, ngase vendi ynë kujtoj se ka disa cilësi specifike zhurmash, nga burimet e ndryshme që duhet paraparë, se si duhet për tu mbrojtur prej tyre, që të përshtatemi me normat e Bashkësisë Evropiane.

Në nenin 7. kryerreshti nën 2, ku bëhet fjalë për burimin e zhurmës nga makinat, përkatësisht nga veturat, duhet shtuar edhe ndonjë nën-rresht tjetër, ku do të parashihej mbrojtja edhe nga zhurma e tepruar e borisë, së automjeteve natën.

Duhet ndaluar edhe zhurmën, nga makinat luksoze në montim dy-tymtarësh të mëdhenj, jashtë masës normale, pra me nga dy auspuh të mëdhenj, në përdorim të adoleshentëve të pa përvojë. Miturakët e tillë kur u grahin makinës në qytet, për të ekspozuar para të tjerëve pamjet, dhe vlerën e veturës së tyre të dalluar, japin gas të madh me qëllim, tejkalimi i zhurmës jashtë vlerave të lejuara kufitare, krahas shkaktimit të ndjeshmërisë te të tjerët, e ndotin edhe ajrin që ndikon keq, në shëndetin e qytetarëve. Propozoj, edhe që pas nenit 16, të bëhet një nen i ri, ku do të parashihej, ndalimi, apo pengimi i zhurmës së tepruar, të shkaktuar nëpër dasmat tona.

Është mirë që, të përkufizohet dasma në dy ditë, e jo të fillojë një javë para martesës dhe të vazhdojë, edhe gati një javë tjetër pas sajë. Kjo krejt, ngase në dasmat tona bëhet zhurma të tejkaluara në tupana, zurna, defa, apo në kohë të fundit, edhe manjetofona me smadhues të zërit deri në kupë të qiellit, ku tërë lagja mbetet pa qetësi dhe pa gjumë.

Gjithashtu në kuadër të nenin të fjalë, kujtoj se duhet paraparë një nën-rresht që në dasmat tona të përdoren përafërsisht 5 – 6 vetura, për ta marrë nusen, e jo 30 e 40 sish, se me to jo vetëm që po bëhet zhurmë pa nevojë, edhe tejkalime vlerash të lejuara për qytetarët, po nga ekspozimi eufori ki entuziazmit të dasmorëve, po shkaktohen edhe ndeshje vdekjeprurëse prej tyre. Mendoj se sidomos duhet për të bërë, nen të veçantë për këtë Projektligj, për pengimin e qitjes me armë zjarri, të qytetarëve gjatë dasmave, si me revole, pushkë automatike etj. kjo krejt ngase jemi dëshmitar që shumë vrasje me pahiri, apo edhe nga pa-kujdesia që po ngjajnë raste të tilla tek ne.

Shumë vrasje shkaktohen edhe nga të qiturit, edhe në gjendje të dehurit, pos kësaj kur po dëgjon, dëgjohen rafalët e automatikëve apo të revoleve, çdo banorë në lagje po frikohet prej këtyre krismave. Si propozim për diskutim mbasi duhet të bëhet me dije se edhe zërat e kombonarëve të kishave, dhe thirrja e zërit të hoxhës nëpër xhamia, e sidomos me mjetet e smadhuara, për së tepërmi është mirë të rregullohet po me këtë ligj ashtu edhe siç është rregulluar për shtetet tjera demokratike. Edhe gjeneratorët që janë bërë domosdoshmëri, e dhembshme në Kosovën e pas-luftës, krijojnë po-ashtu zhurmë bezdisëse për qytetarët, por kur të tillët funksionojnë në ambiente të mbyllura, siç janë qendrat tregtare, etj. të ngjashme e rrezikojnë me të madhe dhe shëndetin e përgjithshëm të jetës në te, dhe të qytetarëve që frekuentojnë aty pari. Nuk mendoj se të bëhet ndonjë nen i veçantë, për këtë aspekt, sepse mendoj që, problemi i tillë do të zgjidhet me zgjidhjen e funksionimit të termocentraleve tona që tani nuk funksionojnë mirë.

Gabimet gjuhësore në këtë projektligj, janë si vijon:

Si zakonisht që të gjitha projektligjet tona deri më sot, kanë qenë për-plotë me gabime gjuhësore edhe ky projektligj ka gabime të shumta sintaksore, drejtshkrimore dhe kalke, po unë do t'i theksoj vetëm disa prej tyre.

Në faqen e parë në rreshtin e parë dhe të tretë është përdorur parafjala mbi, gabimisht, në vend të parafjalës për Për shembull thuhet mbi caktimin e Ministrisë, ose mbi shqyrtimin, e duhet për caktimin dhe për shqyrtimin, sepse parafjala mbi përdoret vetëm para emrave konkretë, p.sh. mbi kokë, mbi bankë, etj. Po theksoj edhe se ky Projektligj, nuk ka numra në faqe, por unë ia kam venë vetë, për lehtësi leximi ,prandaj në faqen 19 ekziston fjala në datën me radhë, ZNSHY që është i pakuptim,sepse nuk është sqaruar çka simbolizojnë këto, dorëzoi etj. duhet shkruar në vend të parafjalës “në” parafjalën “më” pra më kaq, kaq etj.

Vërehet edhe përdorimi gabimisht i trajtave të shkurta të përemrave vetorë , p.sh. në faqen 8. “ti” është shkruar ngjithë p.sh. duhet t'i përmbushim e duhet shkruar ndaras, me apostrof. Në nenin 25 është paraparë dënimi me gjobë prej 500 deri në 1000, deri në 10.000 € për ata që bëjnë zhurmë, kujtoj se kjo është shumë për fillim. Prandaj propozoj që dënimet të fillojnë prej 200 € e tutje. Janë disa zhurma, kjo për arsye se, janë disa zhurma të vogla, që mbas shkaktarit të tyre, janë shumë të ngarkuar me to. Në fund po theksoj se projektligji e përkrah në parim, pasi ka një

material të ngjeshur dhe shumë të nevojshëm për nevojat tona, por që të jetë në nivelin edhe më të mirë, ka nevojë ende që të punohet në te. Respektimi i vlerësimeve të deputetëve në Kuvend, si dhe vlerësimi gjatë debateve me qytetarë, nga ana e Komisionit Funkcional, kujtoj se do ta finalizoj suksesin në këtë material. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zonja Doçi. Për fjalë është paraqitur deputetja Selvije Halimi.

DEPUTETJA – SELVIJE HALIMI

Ju faleminderit zoti kryesues, i nderuari ministër dhe ju kolegë deputetë.

Se ligji për zhurmën është i domosdoshëm, sidomos në kohën nëpër të cilën po kalojmë, kjo nuk do koment. Mirëpo unë dua të ndalem te një fakt kur çdo gjë në Kosovë është e politizuar, madje shkelet edhe etika profesionale, nga politikat e caktuara. Unë jam kundër asaj që të gjitha aktet plotësuese normative të mbesin në përgjegjësinë e ministrit. Një ligj me 28 nene dhe me 10 akte normative, kjo nuk do koment, se çka do të ndodhë më pastaj. Sidomos kur kemi të bëjmë me personat e autorizuar për kryerjen e veprimtarive profesionale për mbrojtjen nga zhurma. Në kreun e 5 neni 18 ,ku flitet për provimet profesionale të cilat do t'i japin personat kompetentë që do të merren me vlerësimin apo me mbrojtjen nga zhurma. Unë dua ta shtroj një pyetje këtu se, sa deputetët po aprovojnë ligje të cilat do të jenë në dobi të qytetarëve? Jemi duke aprovuar ligjin që në parim është i domosdoshëm, sepse zhurma po na pengon të gjithëve, mirëpo sa do të aplikohet ky ligj në praktikë që qytetarët do të jenë më të qetë nga zhurma. Po e marr vetëm një shembull që po bëj një largim nga tema aktuale, por që ka të bëjë me zhurmën dhe këtë e krahasoj pastaj me gjobën. 100 deri në 1000 € gjobën për personin që bën zhurmë. Dihet mirëfilli se në çdo komunë, e në veçanti në Prishtinë, kemi mungesë të parkingjeve. Veturat parkohen tërthorazi qoftë pas dite, qoftë gjatë natës apo në orët e mbrëmjes dhe kur një qytetari i duhet që, urgjentisht ta përdorë makinën e vet, e ka të bllokuar nga makina tjetër dhe detyrohet që të bërtasë me sirenë, për t'ju lejuar rruga që të dalë.

Ajo zhurmë është më se shqetësuese për qytetarët, sepse mund të ndodhë edhe në pikë të natës. Si do ta shqiptojmë dënimin me gjobë ndaj atij që përdor sirenën për t'iu lirua rruga. Apo do ta fajësojmë atë që është parkuar kundër normave. Ku ta parkojë ai veturën? Do të thotë ne duhet të aprovojmë ligje, ne duhet t'i zbatojmë ligjet, por jo të lejojmë politizime, duke lënë të gjitha aktet normative dhe udhëzuese, në kompetencë të ministrave. Nuk po flas konkretisht vetëm për tash, sepse nesër mund të jetë një ministër tjetër, i partisë tjetër, mirëpo, sa këto ligje do të jenë në shërbim të qytetarëve. Me çfarë, si do të matet, apo si do të shqiptohet masa e dënimit, gjatë ndërtimeve nëpër objektet banuese gjatë veprimeve apo shpimeve të ndryshme, nëpër ndërtesa. Në ligj askund nuk parashihet se çdo person i cili do të bëjë renovime apo ndryshime në objektin e banimit duhet paraprakisht t'i lajmërojë banorët e asaj ndërtese për zhurmën që do t'u bëjë qytetarëve dhe për afatin kohor se kur mund të lejohet ajo zhurmë. Secili nga qytetarët mund të bëjë renovim, apo ndryshime në objektin e banimit, duhet që paraprakisht t'i lajmërojë

banorët e asaj ndërtese për zhurmen që mund t'u bëjë qytetarëve dhe për afatet kohore se kur mund të lejohet zhurma.

Secili nga qytetarët mund të bëjë renovim apo ndryshim të planit në ndërtesën e vet, që është e lejuar apo në objektin e vet, apo në shtëpinë e vet, mirëpo janë ato afatet kur ai mund të bëjë zhurme.

Unë mendoj se ne aprovojmë një ligj duke u thirr në atë se është i rëndësishëm , mirëpo, jo për 12 muaj, kur do të plotësohet numri me akte normative, nga ana e ministrit, gjegjësisht nga ana Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, por ndoshta edhe për 5. vite do të jetë i pazbatueshëm, apo ndoshta do të mund ta zbatojmë duke i shfrytëzuar këto zbrazëtira ligjore për dikë nënë e për dikë njerjë. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zonja deputete, më të paraqitur për këtë ligj nuk ka me diskutua, kërkoj nga deputetët që të përgatiten për ta miratua në parim ligjin dhe lus regjinë që ta përgatis teknikën për votim.

Në sallë janë 66 deputetë për

Pra votojmë, tash!

Për	61
Kundër.....	1
Abstenim.....	0

Konstatoj që Projektligji për mbrojtjen nga zhurma është miratuar në parim dhe besoj që deputetët do të kenë kohë dhe do të jenë të përkushtuar në bazë të vërejtjeve që jepen këtu dhe të tjera, që t'i bëjnë amendamentet në kohën e duhur.

Pasi që u miratua në parim në bazë të rregullës 23. pika 6 e rregullës 35 pika 2 Kuvendi ngarkon këto komisione:

Komisionin për Pylltari Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe referues,

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, si dhe

Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin prej 2 muaj nga shqyrtimi i parë ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime, sipas rregullës 35.6.

Të nderuar deputetë dhe deputete, ne kemi në shqyrtim pikën e 8 të rendit të ditës, Projektligjin për pajisje nën presion,

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pajisjet nën presion

Por ministri,- atëherë e paskan autorizuar zëvendësministrin për Energjetikë,

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 6 shtator 2006 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin e miratimin e tij në parim. Vërejtjet parimore do t'u adresohen për shqyrtim, Komisionit funksional përgjegjës, për raportim, si dhe komisioneve kryesore. Zoti Agron Dida ,zëvendësministër në Ministrinë për Energjetikë do ta lexojë Projektligjin e Ministrisë tjetër.

DEPUTETI – AGRON DIDA

I nderuari zoti kryesueses, të nderuar deputetë, kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave, respektivisht të Qeverisë së Kosovës, t'i paraqes Kuvendit të Kosovës.

Projektligjin për pajisje nën presion. Ky projektligj është rezultati i punës, dhe përkushtimit të vazhdueshëm, të Ministrisë së Energjetikës dhe Minierave, për kompletimin e infrastrukturës ligjore në sektorin të cilin e mbulon kjo Ministri. Në gjendjen nëpër të cilën po kalon Kosova, është domosdoshmëri që të krijohen mekanizma të nevojshëm, që në mënyrë profesionale do ta bëjnë kontrollimin e pajisjeve nën presion, posedimi dhe përdorimi jo i rregullt i të cilave paraqet rrezik serioz për jetën e njerëzve, kafshëve dhe të mirave materiale, nëse ato nuk përdoren dhe mirëmbahen si duhet.

Siç dihet, tani në Kosovë nuk kemi mekanizma adekuatë për mbikëqyrjen dhe kontrollimin e pajisjeve nën presion, të cilat sipas direktivave evropiane, paraqesin pajisje me rrezikshmëri të lartë, ato paraqesin rrezik të përherëshëm, nëse nuk projektohen, prodhohen, përdoren dhe mirëmbahen si duhet dhe nëse nuk kontrollohet vazhdimisht gjendja teknike e tyre. Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme, që përcaktojnë kushtet për rregullimin dhe garantimin e sigurimit të jetës, shëndetit, vlerave materiale dhe mbrojtjes së mjedisit, nga rreziqet e shfryrjeve dhe shpërthimeve të shkaktuara nga enët e thjeshta nën presion. Pajisjet nën presion dhe pajisjet transportuese nën presion, duke synuar krijimin e një baze të mirëfilltë ligjore, si dhe nxitjen dhe zhvillimin e shfrytëzimit optimal dhe të sigurt të pajisjeve nën presion.

Ky projektligj është përfunduar, është përafruar dhe harmonizuar me legjislacionin e BE-së dhe ka shumë pak implikime buxhetore, gjë që i bënë të mundur funksionalizimin dhe aplikimin e tij shumë të shpejtë në jetën praktike.

Më 20 shtator 2006, ky projektligj është shqyrtuar në Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë , Miniera Transport dhe Telekomunikacion dhe pas këtij takimi, ku janë diskutuar dhe sqaruar disa çështje, me zyrtarët e Ministrisë së Energjetikës dhe të Minerave, anëtarët e këtij Komisioni janë pajtuar se projektligji është i gatshëm për aprovim në parim, nga ana e Kuvendit të Kosovës. Qëllimet themelore të këtij projektligji janë:

Krijimi i një baze të mirëfilltë dhe të qëndrueshme ligjore në sektorin e energjisë, promovimi i përdorimit të sigurt dhe në përputhshmëri me standardet e pranuar mjedisore dhe të sigurisë, i pajisjeve nën presion, krijimi i mekanizmave efikas dhe të profesionalizuar siç janë kudo në botë, që do të mbajnë mbledhjen, analizën dhe përpunimin e informacioneve dhe kryerjen profesionale të veprimeve, që lidhen me rreziqet e posedimit dhe të përdorimit të pajisjeve nën presion, me qëllim të mbikëqyrjes dhe kontrollit efikas, të pajisjeve nën presion, gjatë ushtrimit të aktiviteteve me këto pajisje. Nga ana e subjekteve të ndryshëm dhe 4. nxitja dhe përdorimi i teknologjive moderne, të pajisjeve nën presion, duke i specifikuar afatet kohore të përdorimit të tyre, dhe jetëgjatësinë e tyre në përgjithësi.

Të nderuar deputetë përmbajtja normative e Projektligjit, për pajisje dhe presion është e sistemuar në 6 kapituj, që paraqesin një tërësi koherente normative, me qëllim të pasqyrimin adekuat, të tërë kompozicionit të ligjit dhe të qasjes më të lehtë në përmbajtjen e tij konkrete, duke respektuar parimet themelore të metodologjisë legislative dhe të teknikës juridike për hartimin e ligjit. Andaj ju propozoj që pas procedurave të shqyrtimit ky ligj, ky Projektligj, të miratohet nga Kuvendi i Kosovës dhe t'i hapet rruga e fuqizimit të tij, gjë që do të jetë në funksion të kompletimit, të infrastrukturës ligjore në sektorin e energjisë, dhe njëkohësisht do të jenë në interes të përgjithshëm, të qytetarëve të Kosovës duke shtuar sigurinë për jetën dhe shëndetin e njerëzve, dhe sigurinë e të mirave materiale. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti Dida. Unë kërkoj falje, sepse kisha teknikën këtu gabimisht, letra është bërë në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe Industrisë dhe për ata të pashë me habi, thashë si është e mundur me ndryshua, Pas leximit të zëvendësministrit filloj me diskutimet lidhur me këtë Projektligj. Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës është paraqitur deputeti Ibush Jonuzi.

DEPUTETI- IBUSH JONUZI

Ju faleminderit zoti kryesues, te nderuar ministra, deputet të respektuar dhe gjithë të pranishëm,

Më lejoni që t'i paraqes qëndrimet e grupit parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për Projektligjin për pajisjet nën presion.

Ky projektligj në shikim të parë duket i shkurtë, por rëndësia e tij është shumë e madhe, për faktin se e mbulon një fushë mjaftë të ndryshme, ku flitet për pajisje që mund të jenë shumë të rrezikshme, për jetra të njerëzve, të kafshëve, shpezëve, dhe për objekte, stabilimente të ndryshme gjithashtu. Prandaj e vlerësojmë të nevojshëm miratimin e këtij Projektligji, i cili duhet të zbatohet në fazën e projektimit, prodhimit, konformitetit, të pajisjeve në presion, atestimet si dhe përdorimin e pajisjeve që i përkasin kësaj fushe. Nëse këto që u thanë më lart

zbatohen si duhet, atëherë u shmangemi rreziqeve të mundshme. Projektligji përcakton parime themelore për përdorimin e pajisjeve në presion, por nuk është gjithëpërfshirës, sepse i mungon pjesa e projektimit dhe ajo e prodhimit. Me siguri hartuesit kanë menduar që disa fusha të mbulohen me akte nënligjore të cilat i përgatit ministria përkatëse.

Ndërkohë që të isha ndalur shumë shkurtë në disa sugjerime, apo vërejtje konkrete,

Neni 4.pika 4.5 duhet të korrigojohet, pastaj neni 9 pika 9.3 gjithashtu të korrigojohet, neni 10 pika nën c), të riformulohet, neni 10 pika 10.7, të plotësohet dhe të riformulohet.

Por gjatë punës së Komisionit funksional këto dhe vërejtjet tjera do t'i kemi parasysh.

Ndërkaq, sa i përket buxhetit Projektligji nuk ka implikime të mëdha buxhetore, në krahasim me rëndësinë që e ka. Është e rëndësishme se çështjet e përdorimit pajisen në presin, janë në përputhje me ligje të BE-së. Kështu në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështesim në parim Projektligjin dhe shprehim gatishmërinë për ta dhënë kontributin e plotë në Komisionin funksional. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti Jonuzi, në emër të grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës është paraqitur deputetja Hatixhe Hoxha.

DEPUTETJA- HATIXHE HOXHA

Zoti kryesues, të nderuar deputetë,

Mendoj se është me interes nxjerrja e ligjit, i cili do të përcaktonte parimet për përdorimin e pajisjeve nën presion. Duke mundësuar në këtë mënyrë evitimin e rreziqeve, që mund të shkaktojnë ato. Mendojmë se me vendosjen e rregullave në këtë drejtim, do të garantohej shëndeti i njeriut, vlerat materiale, mbrojtja e ambientit nga rreziqet e shpërthimeve të shkaktuara nga enët e thjeshta nën presion, pajisjet nën presion dhe pajisjet transportuese nën presion.

Ne e kemi shqyrtuar këtë Projektligj dhe kemi disa vërejtje në të, si në nenet që u përmendën edhe më herët, nga parafolësi, në nenet 4 te mbikëqyrja e tregut, në kreun 4. nenin 9. inspekcioni i pajisjeve nën presion, si dhe në nenin 10. duke pasur parasysh faktin se do të japim kontributin tonë edhe në Komisionin funksional. Si grup parlamentar e mbështesim në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zonja Hoxha, në emër të grupit parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, është paraqitur deputeti Mazllo Kumnova.

DEPUTETI – MAZLLOM KUMNOVA

Zoti kryesues, edhe këtë Projektligj grupi i AAK-së e ka shqyrtuar me kujdes dhe ka konstatuar se Projektligji për pajisje nën presion, është hartuar në bazë të dokumenteve dhe kërkesave të Bashkësisë Evropiane, ka respektuar procedimin e hartimit të një Projektligji të tillë etj.

Përveç kësaj grupi ynë ka vlerësuar se qëllimet e këtij Projektligji janë dhënë, sipas formimit të mekanizmave efikas dhe kompetentë, për mbledhjen, grumbullimin, analizën dhe përpunimin e informacioneve, dhe kryerjen profesionale të veprimeve që lidhen dhe kanë të bëjnë me rreziqet, jo vetëm të përdorimit, por edhe të posedimit të pajisjeve nën presion. Dispozitat e këtij Projektligji sigurojnë, mbikëqyrin edhe kontrollin efikas të subjekteve të ndryshme gjatë posedimit por edhe të përdorimit në kuadrin e aktiviteteve të tyre me këto pajisje.

Edhe pse Projektligji rregullon një veprimtari të kufizuar, do të thotë vetëm për subjektet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e tërë, pajisja me presion, ne mendojmë se duhet të mbështet një Projektligj i tillë. Pa dyshim këtij projektligji i duhet një përmirësim dhe riformulim, ato që u thanë edhe më parë, të disa dispozitave që nuk kanë dhënë drejtpërdrejtë dhe të konkretizuar të formësuar gabimisht dhe nga ana gjuhësore. Këtu përmirësimë kërkon, padyshim neni 4, neni 9, neni 10, etj. këto përmirësimë është mendim i këtij grupi se, mund të bëhen gjatë procedimit në Komision, dhe të cilat në procedim thjeshtë, do ta keni edhe ndihmën tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti Kumnova, në emër të Grupit Parlamentar ORA është paraqitur deputeti Genc Gorani.

DEPUTETI – GENC GORANI

Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar anëtarë të kabinetit qeveritar, zonja dhe zotërinj deputetë, me kënaqësi mjaftë të madhe e mirëpres arritjen e këtij projektligji, gjegjësisht ligji. Mendojmë se është e rëndësishme për të hyrja dhe pjesëmarrja në aktivitete ekonomike dhe në përgjithësi, do të jetë shumë më e madhe, andaj arritja e këtij Projektligji është për t'u përshëndetur. Përshëndes strukturën e qartë, të thjeshtë, të shkurtër të neneve të këtij projektligji, që me 14 – 15, nene faktikisht e bënë një rregullim jashtëzakonisht të rëndësishëm në këtë fushë. Për përfundim kisha dashtë të theksoj se në implikimet buxhetore për prej vetëm 15.000€ të një projektligji që ka efekt kaq të rëndësishëm, ndikon edhe diçka tjetër, atë se ky projektligj, me këtë vëllim të neneve dhe me këtë implikim buxhetor, ka mund të silltet më herët dhe e dyta nëse më lejohet t'i sugjerojë Qeverisë, ndoshta, do të kishte mujtë Qeveria të na propozojë një listë të ligjeve kanë implikime relativisht modeste buxhetore dhe që nuk kërkojnë kompetenca dhe veçanërisht kapacitete teknike për ti përpiluar që t'i kalojmë sa më shpejtë këto projektligje dhe t'i bëjmë ligje që do të kishin mundësi të na ndihmojnë shumë në aspekte.

Pra edhe një herë konfirmoj mbështetjen në parim, të këtij projektligjit të Grupit Parlamentar ORA. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti Gorani, në emër të Grupit Parlamentar 6+ është paraqitur deputeti Xhezair Murati.

DEPUTETI – XHEZAIR MURATI

Hvala vam gospodine predsedavajući. I ja se pridružujem kolegama na izjavu ovog zakona. Naša parlamentarna grupa se posebno osvrnula od šest poglavlja, na treće poglavlje, gde je u ovom zakonu za opremu pod pritiskom posebno bitno baratanje opremom pod pritiskom. Mislim tu je jedna naša bitna primedba da je ovo poglavlje moglo sigurno malo opširnije biti i detaljnije obuhvaćeno, jer sve nevolje koje proizilaze iz nedovoljnog iskustva i specifičnosti vezano za baratanje opremom upravo su obuhvaćene ovim poglavljem. U onom delu gde se govori o tome koja su dokumenta i zakoni korišćeni mislim da je nedovoljna dokumentacija i zakoni koji su korišćeni za pripremu ovog našeg zakona, ali i u deklaraciji Kancelarije za evropske integarcije stoji jedna opaska da nije obuhvaćena sva materija, a da ništa ovde detaljno nije predviđeno, šta aje to propušteno. Pitamo se takođe da li je dvanaest meseci dovoljna, odnosno da nije predugačak period, za donošenje podzakonskih akata, jer će praksa sigurno pokazati njihovu potrebu za kraće vreme. Sve u svemu mi dajemo još jednu primedbu da u radnoj ekspertskoj grupi ponovo nema predstavnika iz drugih zajednica, u kontinuetu dajemo tu primedbu, međutim, stručnjaci se oglašavaju od te naše primedbe, ali u načelu mi prihvatamo ovaj zakon smatrajući potrebom njegovo usvajanje. Hvala !

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zoti deputet, në emër të Grupit Parlamentar për Integrim, është paraqitur deputeti Gjergj Dedaj.

DEPUTETI – GJERGJ DEDAJ

Edhe Grupi Parlamentar për Integrim i jep mbështetje këtij projektligji, me shpresë se do të kompletohet dhe do të funksionalizohet në punën e mëtejme. Ju faleminderit!

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit. I lus deputetët që të kthehen në sallë për të votuar. E fundit për diskutim është paraqitur deputetja Qibrije Hoxha.

DEPUTETJA – QIBRIJE HOXHA

Ju faleminderit zoti kryesues,

Unë desha të shpreh mendimi tim në lidhje me këtë projektligj, Projektligji për pajisjet nën presion, e ka rëndësinë e vet, sepse synon vendosjen e rregullave, me qëllim të mbrojtjes së jetës së njerëzve, vlerave materiale, si dhe mbrojtjes së

ambientit nga rreziku i shpërthimeve të pajisjeve nën presion, Pra, unë jam për miratimin në parim të këtij projektligji.

Në 6 kapitujt të këtij projektligji, është siguruar një bazë ligjore për tregtimin dhe përdorimin e pajisjeve nën presion, por më duhet thënë se e shoh të mangët këtë projektligj, për shkak se mungojnë kërkesat themelore të sigurisë, siç janë; projektimi, prodhimi, dhe neni që rregullon transportin e këtyre pajisjeve nën presion.

Sot pajisjet nën presion, të çfarëdo lloji qofshin ato, e gjejnë përdorimin e gjerë në shoqëri, qoftë në amvisni, në industri, në mjekësi, etj. Ne jemi dëshmitarë të shpërthimeve të këtyre pajisjeve që ndodhin herë pas here, te përdoruesit në Kosovë, natyrisht se nuk dihen shkaqet e këtyre prishjeve, të pajisjeve nën presion, mirëpo duhet të jemi të vëmendshëm që sigurinë e këtyre pajisjeve, ta rregullojmë me ligj.

Unë mendoj se, rëndësinë e kërkesave të sigurisë për pajisjet nën presion, është prodhimi dhe transporti, para kërkesave që janë përfshirë në këtë Projektligj. Këtë e them sepse, një prodhim i mirë, me kualitet të lartë, i cili është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore ndërkombëtare, dhe kombëtare, paraqet siguri më të madhe, se një prodhim, për të cilin ne nuk mund të bëjmë kërkesë për kualitet, për shkak të vakumit ligjor. Prandaj, pa kritere të përcaktuara me ligj, e që janë në harmoni me ligjet evropiane, për prodhim të pajisjeve nën presion, ne nuk kemi kurrfarë garancish për sigurinë e këtyre pajisjeve. E njëjta vlen sa i përket transportit të pajisjeve nën presion, transporti i pajisjeve nën presion, kërkon që të respektohen kritere të veçanta, në mënyrë që të mos vije deri te dëmtimi, shpërthimi apo ndonjë dëmtim tjetër, që mund të rrezikojë jetën e njerëzve, si dhe mund të shkaktojë dëme të mjedisit dhe vlerave tjera materiale. Me nenin 3 pika 3.2 është paraparë që Ministria e Energjetikës dhe e Minierave do ta rregullojë me akte të veçanta nënligjore, çështjen e projektimit, prodhimit dhe transportimit, të pajisjeve nën presion. Shpresoj se Ministria Energjetikës dhe Minierave, do ta bëjë këtë në afat sa më shkurtë. Ju faleminderit!.

KRYESUESI – XHAVIT HALITI

Ju faleminderit zonja Hoxha. Konstattoj që diskutues të tjerë nuk ka . Në sallë janë 67 deputetë . Mendoj që janë krijuar kushtet për të filluar me votimin. Pra ,po votojmë për ta miratuar ligjin në parim. Lus regjinë që të përgatitet dhe deputetët të votojnë,
Votojmë, tash!

Për64
Kundër..... 0
Abstenim..... 0

Ligji në parim është miratuar.

Në bazë të rregullës 23.6. dhe rregullës 35 pika 2 Kuvendi ngarkon këto komisione:

**Komisioni për Tregti, Industri, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe referues,
Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe
Komisioni për Komunitete.**

**Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, të shqyrtojnë Projektligjin, dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime, sipas rregullit 35.6.
Ju faleminderit!**

Po kalojmë në shqyrtimin e dytë të Projektligjit të trashëgiminë kulturore

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për trashëgiminë kulturore

Sipas konstatimeve që kemi miratimi në parim, i këtij Projektligji është bërë me 27.07.206, komisionet parlamentare kanë shqyrtua, dhe Kuvendit i kanë paraqitur raportet dhe rekomandimet me amendamente.

Në bazë të raporteve të Komisioneve kryesore, dhe Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport, si Komision funksional raportues, në vijim jepet radhitja e Komisioneve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për trashëgiminë kulturore si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë kushtetuese, ka vlerësuar se Projektligji për trashëgiminë kulturore, ka bazë juridike në kornizën kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka konstatuar se dispozitat e Projektligjit për trashëgiminë kulturore, përmbajnë implikime buxhetore,

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar,se dispozitat e Projektligjit për trashëgiminë kulturore dhe amendamentet e propozuara, nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Për fjalë është paraqitur deputeti Nimon Alimusaj. Në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, fjalën e keni zoti Musaj.

DEPUTETI – NIMON ALIMUSAJ

**Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar kolegë deputetë,
Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, ka qenë çdo herë i interesuar që Ligji për trashëgimi kulturore, të jetë sa më i përkryer dhe të aprovet sa më shpejtë, duke pasur parasysh çdo herë rëndësinë e tij dhe faktin se ky ligj lidhet me standardet. Komisioni në mbledhje të shumta të tij, duke pasur parasysh vërejtjet e ekspertëve vendorë, dhe të jashtëm, sidomos të Këshillit të Evropës, ka bërë 59, amendamente të cilat sot ju kolegë deputet i keni përpara. Mirëpo ky Komision, me qëllim që ligji, të jetë sa më i qartë, dhe sa më lehtë për**

implementim, pas kontrollimit të amendamenteve të veta, ka konstatuar se janë të domosdoshëm të bëhen edhe disa ndryshime, përkitazi me disa amendamente që vetë i ka dhënë, dhe me ndonjë nen.

Le të më lejohet t'i japë këto vërejtje, këto propozime shtesë:

Amendamentet 16 dhe 17, të paraqitur nga Komisioni, që lidhen me nenin 2.21, me nenin 2.23 dhe me nenet 7.19.

Termet “fushë e mbrojtur”, duhet të jenë “sipërfaqe të mbrojtura”.

“Fushë speciale” duhet të jetë “zonë e veçantë”.

“Hapësirë” duhet të jetë “sipërfaqe e mbrojtur”

Arsyetim

1. Këto ndryshime bëhen në pajtim me Ligjin për planifikimin hapësinor, Ligji 2003/14.
2. Amendamenti 21, i propozuar nga Komisioni, që lidhet me nenin 3.3 ku thuhet: duhet të krijohet një bazë e të dhënave Dejtabëjs në dy forma, të shkruar dhe elektronike, e standardizuar dhe e centralizuar, pra e trashëgimisë kulturore, me akt nënligjor dhe duhet të jetë i lejuar për qasje përmes një rrjeti institucional.
Propozimi, neni 3.3 duhet të formulohet kështu: Ministria krijon bazën e të dhënave Dejtabëjs të standardizuar dhe të centralizuar, në dy format të shkruar dhe elektronike, qasja në këto të dhëna lejohet përmes një rrjeti institucional.

Arsyetimi

Nëse i lihet Ministrisë të themelojë Detabëjs me akt nënligjor, prapëseprapë, këtë do ta bënte Ministria dhe do të ishte më mirë që kjo çështje të rregullohet me ligj, dhe jo me një akt nënligjor.

3. Amendamenti 41, në nenin 6.7, dhe nenin 6.8, fjala “demolim dhe mbulesë” duhet të mbeten si në projektligj me arsyetimin se, amendamenti i propozuar nga Komisioni, e humb kuptimin e nenit, ngase në këtë rast kemi të bëjmë me demolimin dhe me mbulesën e jashtme, është fjala për fasadën, mbulesën e jashtme të ndërtesave, monumenteve etj. e jo dëmtimin dhe pamje të jashtme, siç është cekur në amendament.
4. Gjithashtu Komisioni është i pajtimit që neni 7.18, të formulohet siç e ka propozuar Komisioni për Komunitete, ku thuhet: lejohet intervenimi në tokë brenda zonës mbrojtëse, në kuptimin e veprimtarive bujqësore, me leje të shkruar nga institucioni kompetent, e jo ashtu siç e ka propozua Komisioni në amendamentin 46. Le të më lejohet në fund them se Grupi arlamentar i Lidhjes Ddemokratike të Kosovës i ka shqyrtuar me kujdes këto

amemndamente dhe këtë propozim shtesë të Komisionit dhe do t'i aprovojë këto amendamente. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – ju faleminderit z. Alimusaj, për fjalë është paraqitur edhe deputetja Sala Ahmetaj

DEPUTETJA SALA AHMETAJ - Partia Demokratike e Kosovës vazhdimisht dhe me përgjegjësi ka dhënë kontribut për përmbushjen e standardeve për Kosovën. Një nga këto standarde është edhe Ligji për trashëgiminë kulturore. Ne si grup parlamentar jemi të vetëdijshëm se ky ligj nuk është zgjidhja më e mirë, por është edhe një përpjekje që bëjmë për ndërtimin e shtetit të pavarur të Kosovës, prandaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do t'i votojë këto amendamente, por tek amendamenti nr. 4 i propozuar nga Qeveria me partnerë ndërkombëtarë mendojmë se nuk është përkthyer në mënyrën më të saktë dhe për pasojë mund të shkaktoj keqkuptime. Këto mangësi dhe pasaktësi në përkthim na janë përvjedhur. Propozoj që në vend të fjalës: “në përputhje”, të jetë “në mënyrë specifike” dhe fjala “definin” të zëvendësohet me fjalën “rregullon”. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI KOLË BERISHA - Vazhdojmë me aprovimin e amendamenteve. Amendamenti nr. 1, i mbështetur nga Komisioni FunkSIONAL,

Votojmë: tash!

Në sallë janë aktualisht 76 deputetë

Për 60
Kundër..... 7 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 2, i mbështetur nga Komisioni FunkSIONAL, votojmë,tash!

Për 66
Kundër..... 7 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 3, votojmë, tash!

Për..... 65
Kundër..... 5 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 4, urdhëroni profesor! Profesor Hamiti e ka fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Kolegë të nderuar z. Kryetar i Kuvendit. Këtu në këto amendamente është dashur ta specifikoj Komisioni përkatës, por ata që i kanë lexuar e dinë edhe vetë pa ua shpjeguar askush që ekzistojnë dy amendamente specifike, është ky katërshi që do ta votojmë tash , dhe ky 59 që është i fundit. Të dytë kanë të bëjnë me përkufizimet e fuqisë së këtij ligji, do më thënë të bëjnë me

përkufizimet e fuqisë të këtij ligji, relativizohet funksionimi i tij në fushat e veçanta. Këto janë nene specifike që janë kërkuar për arsye të përtej trajtimit të materieve ligjore që ashiqare është arritur pajtimi në Komision, por nuk është sqaruar qartë këtu. Meqë kanë këtë funksion unë parapëlqej se kur jemi të amendamenti 4 për shkak se ka pasaktësi në përkthime që të merret varianti që e dha kolegja Sala pak përpara, të lexohet dhe të votohet ai formulim jo si është formulimi këtu. Kaq, jemi të katërshi kur mërijmë atje, mbërijmë të ai i fundit, por të ky katërshi, sepse formulimi shqip vërtetë është jo shumë i saktësuar, duhet të kapet esenca e tij, pra kolegja Sala e dha një formulim që e saktëson dhe unë propozoj që ai formulim si i tillë të votohet. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit profesor. Deputetja Selviqe Halimi e ka fjalën

DEPUTETJA SELVIQE HALIMI – Ju faleminderit z. kryetar! Edhe unë shqetësimin tim e kam rreth kësaj se Komisioni pak më herët u takua dhe i prezantoi tash, që kolegu deputet disa ndryshime që janë bërë këtu në amendamente dhe profesoresha Salë gjithashtu dhe sa u informova unë, ato ndryshime nuk ju kanë arritur as juve atje që e drejtoni seancën dhe ne pa marrë parasysh sa e kemi lexuar krejt t'i mbajmë mend të gjitha amendamentet dhe ndryshimet, kështu që është mirë të secili amendament të ngritet edhe një herë dikush nga Komisioni dhe të jepë variantin e Komisionit tash së fundi, në mënyrë që ne ta votojmë variantin e fundit nga Komisioni. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Atëherë kërkoj nga deputetja Sala Ahmetaj që ta diktoj tekstin – riformulimin e këtij amendamenti.

DEPUTETJA SALA AHMETAJ - Shtirirja e Ligjit duhet të jetë e përkufizuar për çështjet që ndërlidhen në mënyrë specifike me trashëgiminë kulturore dhe tjetra trashëgimia kulturore që ndërlidhet ose deri vonë kanë konfesionet fetare do të jetë e qeverisur nga legjislacioni i cili e rregullon statusin e komuniteteve fetare në Kosovë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Atëherë vazhdojmë me këtë formulim të këtij amendamenti. Votojmë, tash!

Për..... 68
Kundër..... 4 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 5 – Votojmë, tash!

Për 66
Kundër..... 6 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 6 – Votojmë, tash!

Për..... 65
Kundër 6 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 7 – Votojmë, tash!

Për..... 64
Kundër 6 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 8 – votojmë, tash!

Për..... 64
Kundër 5 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 9 – votojmë tash!

Për..... 63
Kundër 3 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 10 – votojmë, tash !

Për..... 62
Kundër 8 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 11 – votojm, tashi !

Për..... 62
Kundër 8 - kalon amendamenti
Abstenim..... 1

Amendamenti nr. 12 – votojmë, tash!

Për 48
Kundër..... 5 - kalon amendamenti
Abstenim..... 1

Amendamenti nr. 13 – votojmë, tash!

Për 63
Kundër 6
Abstenim 1 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 14 – votojmë, tash!

Për..... 63

Kundër 6 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 15 – votojmë, tash!

Për 62

Kundër 7 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 16 –

Unë prita që do të intervenojë tash përfaqësuesi i Komisionit, se ne nëse mbaj mend mirë, unë përpiqem të mbaj mend, ajo çka ka folur kolegu i ynë për nenin 16, 17, 21 dhe një më vonë, janë variantet e tjera dhe ju lutem ta paraqesë – tash është koha ta paraqes variantin. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Niman Alimusaj e ka fjalën

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ – Te amendamenti 16, i cili lidhet me nenin 2.21 shikoni atë nen e keni përbri, e keni zonë mbrojtëse, nënkupton një fushë pra “fushë mbrojtëse”, propozohet të jetë “sipërfaqe e mbrojtur”, sepse kështu është në Ligjin për Planifikimin Hapësinor. Menjëherë nën amendamentin 17 e keni “fushë speciale” propozohet, e në amandmanent e kemi “hapësirë e veçantë” të propozohet të jetë “Zonë e veçantë” se edhe ky term është në atë Ligjin për Planifikimin Hapësinor, do më thënë duhet të akordohen këta dy terma me ligjin paraprak. Amendamenti mbetet pikërisht këto që janë definuar e këto mbeten, po atje në Ligj ku e keni “Zonë e mbrojtur” duhet të jetë “Sipërfaqe e mbrojtur” ne anën e majtë, neni, shikoje nenin, neni 2.21 e keni “Zone e mbrojtur duhet të jetë “Sipërfaqe e mbrojtur” në Ligj. Këtu e keni nenin 2.23, shiko majtas e ki “fushë speciale”, duhet të jetë “Zonë e veçantë” këto janë ato dy ndryshime që i ka propozuar si shtesë Komisioni.

KRYETARI KOLË BERISHA –Kalojmë në aprovimin e këtyre amendamenteve me propozimet që i dha kryetari i Komisionit.

Urdhëroni z. Kryeziu, Fadil Kryeziu e ka fjalën.

DEPUTETI FADIL KRYEZIU – Duke përcjellë me vëmendje këtë që e propozoi përfaqësuesi i Komisionit kompetent, unë desha vetëm t’jua lexoj se si do të dukej ky nen, pra neni 2.21 është “Fushë mbrojtëse” nënkupton një fushë të vendit ,siç është përcaktuar në nenin 2 të Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligji nr. 2003/14 i cili është ambienti i perimetrit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme që mund të mbrohet nga ndonjë zhvillim ose veprimtari që mund të dëmtojë kuadrin e dukshëm ose tentim tjetër të trashëgimisë kulturore.

KRYETARI KOLË BERISHA – Deputeti Nimon Alimusaj e ka fjalën

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ - Të gjitha ndryshimet gjuhësore që i ka bërë Komisioni që janë, në vend “definuar” të jetë fjala e “përcaktuar” mbetet, por në këtë amendament Komisioni nuk e ka ndryshuar termin “Zonë mbrojtëse” edhe tash e ka shtuar që përveç këtyre ndryshimeve që i kanë në amendamentin 16, të ndryshohet edhe “fushë mbrojtëse” në “sipërfaqe e mbrojtur” dhe del krejt ashtu si e tha kolegu deputet.

KRYETARI KOLË BERISHA – urdhëroni profesor Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI – Kolegë të nderuar edhe të Komisionit edhe deputetë, mos të bëjmë paqartësia. Ne e kemi në këtë rast të votojmë alternativë. E kemi Ligjin dhe e kemi amendamentin. Votim të tretë ne nuk mund të bëjmë, prandaj unë kërkoj nga Komisioni që ta sqarojë ç’do të thotë amendamenti 16, se ne nëse votojmë kundër 16 –teshit mbetet qysh është varianti i Ligjit. Nëse ne ndërtojmë një amendament që nuk e voton në mënyrën qysh është shprehur ligji, atëherë duhet të formulohet saktë. Të dy variantet që i thatë ju nuk janë njësoj, Na thoni ju se a duhet të votohet amendamenti 16 apo jo? Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni profesoreshë Sala Ahmetaj e ka fjalën

DEPUTETJA SALA AHMETAJ – Amendamenti 16 i propozuar më herët, këtu është bërë një pasaktësi ndoshta në rregullimin e amendamenteve. Ka të bëjë kryesisht me korrigjime, d.m.th. fjala “Definuar” zëvendësohet me fjalën “Përcaktuar” dhe në vazhdim fjala “Aktivitet” zëvendësohet me fjalën “Veprimtari”. Këto ndryshime vlejné për tërë tekstin e Projektligjit dhe në fund të nenit fjalët “ndryshim” zëvendësohen me fjalën “tjetër”, d.m.th. amendamenti i propozuar, amendamenti 16, që është propozuar më herët nga Komisioni është kryesisht një korrigjim gjuhësor, kurse këtu amendamenti i propozuar më vonë d.m.th. numri ndoshta nuk është dhënë saktë, por ne ose duhet ta shtojmë si amendament tjetër të veçantë – ka të bëjë vetëm me terminologji. Ne nuk e dimë cila është më e mirë, por po e harmonizojmë me Ligjin për Planifikimin Hapësinor. Kjo është, a e keni tani të qartë? E tani në vend të fjalës “fusha e mbrojtur” do të jetë “ sipërfaqe e mbrojtur”, tek neni 2.21 dhe tek neni 2.23, po këtu të dyja ose shkojë me radhë

Neni 2.21, këtu -te ky nen- kryesisht kemi të bëjmë me përkufizimin e nocioneve “zona mbrojtëse” d.m.th. nënkupton një fushë të vendit që është definuar, është sipërfaqe e mbrojtur, vërtet “fusha e mbrojtur” duhet të jetë “ sipërfaqe e mbrojtur. Këtu nuk është e saktë, nuk është gabimi te ne.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni profesor Hamiti

DEPUTETI SABRI HAMITI – Unë po e vë vullnetin në shërbim për krejt këto diskutime që po bëhen. Sa po kuptoj unë definitivisht Komisioni nuk e tërheq 16-shin, por propozon t’i shtohet një fjali amendamentit 16 vetëm i shtohet, që “ zona

mbrojtëse duhet të nënkuptohet si “sipërfaqe e mbrojtur” pikë.Kjo hyn në amendamentin 16 dhe votohet. Kjo është definitivisht ajo që u tha krejt tash. Ju faleminderit! Jo jo brenda këtij një fjali e re dhe brenda 16-shit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Deputeti Alimusaj, urdhëroni

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ – Ky nen, tash po shoh pak edhe një qartësi tjetër lidhet me 2.22 ku e ki “fushë e mbrojtur” duhet të jetë edhe “sipërfaqe e mbrojtur “, jo nuk e kam gabim, por duhet të jetë 22 fushë e mbrojtur – sipërfaqe e mbrojtur, kurse amendamenti 16 me këto përmirësime gjuhësore shkon kështu siç është propozuar nga Komisioni.

KRYETARI KOLË BERISHA – Deputeti Hydajet Hyseni e ka fjalën

DEPUTETI HYDAJET HYSENI - Ju faleminderit z. Kryetar, korrigjimi i kësaj natyre mund të bëhet edhe me një nen të veçantë siç është propozuar nga Komisioni që duhet të them me këtë rast që ka punuar shumë në këtë ligj, por po e shfrytëzoj rastin dhe të them se në kuadër të korrigjimeve do të duhej korrigjuar edhe shprehja “zonë mbrojtëse”, që nuk përputhet me variantin anglisht, pra “tektiv zonë” dhe me variantin serbisht “zashtiqena zona”, do të duhej që edhe në gjuhën shqipe të jetë “zonë e mbrojtur” dhe jo mbrojtëse, sepse mbrojtëse merr një kuptim krejt tjetërfare. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – deputeti Nahit Hasani

DEPUTETI NAHIT HASANI – Unë e kam te amendamenti 46 ju lutem

KRYETARI KOLË BERISHA – qenkemi ngutë pak më tepër .A kemi formulim të qartë të këtij neni, të amendamentit 16? Nimon Alimusaj e ka fjalën.

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ – Të gjitha fjalët që janë ndryshuar nga Komisioni në amendamentin 16 – fjala “definuar”, “përcaktuar”, fjala “veprimtari” që e keni përpara të ndryshe shkojnë në amendamentin 16, të rregullohet neni 2.21, kurse për nenin 2.22 ndryshohet “fusha e mbrojtur” në “sipërfaqe të mbrojtur”, d.m.th është një nen që e ndryshon një term që nuk e kemi në amendamente, është fjala për nenin 2.22.

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëro profesor! Profesor Hamiti e ka fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI - Shikoni është, nuk ka nevojë të krijojmë – hajt t’a lëmë formulimin e Komisionit nëse kanë qef me thënë ata që e formuluan dhe të ecim tutje. Nuk ka variant tjetër. Në situatën ligjësore që jemi tash ne mundemi vetëm ta plotësojmë 16-shin dhe unë propozova të hyjë në 16-shin edhe ajo shprehje që i referohet nenit 2.22 dhe mbaroi, nuk ka variant tjetër. Ne jemi në

situatën kur tjetër nuk mund të bëjmë, plotësohet me këtë frazë dhe i referohet nenit 2.21 dhe në votojmë nenin 16, nuk ka mundësi tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!
Votojmë, mendoj se kemi diskutuar mjaft rreth kësaj çështjeje.
Votojmë tash

Për..... 56
Kundër.... 9 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 17 – Votojmë, tash! me vërejtjet që i ka dhënë Komisioni

Për 57
Kundër 6 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 18 – votojmë, tash!

Për..... 60
Kundër..... 3 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 19 – votojmë, tash!

Për 63
Kundër..... 3 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 20 – votojmë tash!

Për 66
Kundër..... 5 - kalon amendamenti

KRYETARI KOLË BERISHA – Urdhëroni Nimon

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ - Amendamenti 21 lidhet me nenin 3.3. Nga Komisioni ka qenë i formuluar kështu: Duhet të krijohet në bazë të të dhënave database në dy forma të shkruar dhe elektronike, pra e standardizuar dhe e centralizuar e trashëgimisë kulturor me atë ligjor dhe duhet të jetë lejuar për qasje përmes një rrjeti institucional. Ky amendament Komisioni propozon të formulohet kështu: Ministria krijon bazën e të dhënave të standardizuara dhe të centralizuara me të dy format të shkruar dhe elektronike. Qasja në këto të dhëna lejohet përmes një rrjeti institucional. Arsyetimi ishte ky. Nuk ka nevojë për arsyetim.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Këtu z. kryetar një sqarim për deputetët, por edhe për ata që evidencojnë- çka po ndodhë kur po votojmë, faktikisht Komisioni ka hequr dorë prej amendamentit të vet të parë dhe e ka rikorrigjuar ligjin në këtë

nen d.m.th ne ta kemi të qartë do ta votojmë formulimin e ri që e lexoj z. Nimon Alimusaj tash. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit – votojmë, tash!

Për 62
Kundër 6 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 22 – votojmë, tash !

Për..... 63
Kundër..... 6- kalon amendamenti

Amendamenti nr. 23 - votojmë, tash!

Për 54
Kundër..... 8 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 24 – votojmë tash!

Për..... 58
Kundër..... 10 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 25 - votojmë tash!

Për 55
Kundër..... 9 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 26 – votojmë tash!

Për 57
Kundër..... 8 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 27 – votojmë tash!

Për 56
Kundër..... 9 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 28 – votojmë tash!

Për..... 60
Kundër..... 8 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 29 – votojmë tash!

Për..... 61
Kundër 9 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 30 – votojmë tash!

Për 55
Kundër..... 4 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 31 – votojmë tash!

Për..... 54
Kundër..... 5 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 32 - votojmë tash! - një numër i deputetëve nuk po voton fare, prandaj po del numri i vogël i votimeve

Për..... 57
Kundër 6 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 33 – i kemi në sallë 70 deputetë - votojmë, tash!

Për..... 60
Kundër 6 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 34 – votojmë tash

Për..... 59
Kundër..... 5 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 35 – votojmë, tash

Për 59
Kundër..... 5 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 36 – votojmë, tash

Për..... 62
Kundër..... 5 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 37 – votojmë tash

Për..... 66
Kundër..... 4 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 38 – votojmë tash

Për..... 54
Kundër..... 5 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 39 – Janë dy propozime: propozimi i Komisionit FunkSIONAL dhe propozimi i Komisionit për Buxhet -

Fjalën e ka deputeti Lutfi Zharku

DEPUTETI LUTFI ZHARKU – Ju faleminderit z. kryetar! Kur e kemi shqyrtuar na këtë amendament, parimisht kemi ardhur në përfundim se çështja e lirimit për shpenzimet në punët e konservimit apo pavarësisht në punët e trashëgimisë kulturore është e rregulluar me Ligjin mbi tatimin në fitim, me Ligjin mbi të ardhurave e korporatave e tjera, kështu që duhet të lihet çështja e lirimeve tatimore të rregullohet me anë të ligjeve tatimore, kurse këto të fshihen. Ky ka qenë qëndrimi i Komisionit për Buxhet. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka profesor Nimon Alimusaj

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ – Pikërisht përkitazi me këtë nen nga Komisioni, nga disa anëtarë të Komisionit që kanë qenë në Strasburg në Këshillin e Evropës është kërkuar ky nen të formulohet kështu në pajtueshmëri, siç e thanë ata edhe me ligjet e vendeve të tjera rreth kësaj çështjeje dhe këtë e ka pasur parasysh Komisioni kur nuk e ka aprovuar propozimin e Komisionit për Buxhet.

**KRYETARI KOLË BERISHA – Do të thotë se do ta votojmë propozimin e Komisionit FunkSIONAL a po?
Urdhëroni z. Zharku**

DEPUTETI, LUTFI ZHARKU – Me falni nuk dua replikë, parimisht qëndrimi i Komisionit ka qenë që kjo çështje të rregullohet me ligj tjetër. Kjo është arsyeja dhe unë nuk mendoj se çështjet e lirimeve tatimore duhet të përfshihen në ligjet apo të shpërndahen në ligjet e ndryshme dhe qëndrimi i Komisionit ka qenë shumë parimor, nuk është Komisioni kundër nenit vetëm se këto çështje janë të rregulluara me ligjet tjera. Këtu është arsyeja e asgjë tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Z. Brajshori

DEPUTETI, BEHXHET BRAJSHORI - Z. kryetar mendoj se nuk duhet të jetë praktikë që një ligj ta përjashtojë tjetrin. Duhet të kemi parasysh këtu, që është e nevojshme të kemi restaurim e konservim, por në këtë rast, nëse ne do ta aprovonim amendamentin e Komisionit FunkSIONAL, kjo do të vinte në kundërshtim me Ligjin për tatimin e të hyrave dhe të veprimtarive të caktuara që mund të bëhen. Unë mendoj se kjo çështja e Komisionit FunkSIONAL për buxhet është e qëlluar, ndoshta amendamentit të Komisionit FunkSIONAL mund të ia shtojmë një prapashtesë nëse nuk është rregulluar me ndonjë ligj tjetër. Me ndonjë ligj tjetër do të thotë, se nëse është rregulluar me Ligjin mbi tatimin që nuk lirohen atëherë nuk lirohen, prandaj kjo është ajo që mund të harmonizohen të dy amendamentet.

KRYETARI KOLË BERISHA – urdhëroni! Deputetja Sala Ahmetaj

DEPUTETJA SALA AHMETAJ – Mendoj, për plotësimin që e dha z. Brajshori kujtoj se tani mund ta votojmë propozimin, sepse ne kemi kërkuar që të lirohet nga detyrimi në tatim natyrisht në përputhje edhe me ligjet tjera në fuqi që e rregullojnë këtë çështje.

KRYETARI – do te thotë se ju jeni në mbështetje të propozimit të Komisionit për Buxhet po?

Urdhëroni z. Brajshori edhe një herë

DEPUTETI BEHXHET BRAJSHORI – Unë do të shtoja amendamentit të Komisionit Funkcional pas pikës aty nëse nuk është e rregulluar me ndonjë ligj tjetër në mënyrë tjetër. Kaq.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! – Deputetja Nekibe Kelmendi

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Pajtohem me ato çka po synon z. Brajshori, por kisha me formuar pak ma ndryshe këtë, nëse kjo nuk është e rregulluar ndryshe me ndonjë ligj në fuqi.

KRYETARI KOLË BERISHA – Mirë, ju faleminderit! z. Zharku

DEPUTETI LUTFI ZHARKU – Z. Kryetar, nuk desha të hyjë në detaje në rregullimin e Ligjit mbi të ardhurat në korporata dhe Ligjin mbi tatimin në fitim që është e rregulluar kjo çështje. Parimisht ky nen është në kundërshtim me ato dy ligje derisa aty thuhet se shumica prej 5% të të hyrave mund të zbritet dhe prano si shpenzime të zbritshme këtu është në kundërshtim - e tërë shumica e investuar duhet të lirohet kështu. Unë nuk desha me hy shumë në detaje shpjegimit të çështjeve tatimore, megjithatë aty është e rregulluar ndryshe te ky ligj është ndryshe. Kështu që për atë arsye ne kemi dashur që çështja tatimore të lihen, të rregullohen me Ligjin mbi, parimisht me Ligjin mbi tatimet e jo me Ligjin mbi trashëgiminë kulturore. Kjo është e përfshirë në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave dhe Ligjin mbi tatimin në fitim. Është e përfshirë veç me disa specifika. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – nënkryetari i Komisionit z. Alimusaj

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ - Komisioni pajtohet me formulimin që e dha z. Brajshori dhe e plotësoj z. Nekibe, dhe të votohet për te.

KRYETARI KOLË BERISHA – do të thotë votojmë – votojmë për propozimin e Komisionit Funkcional me shtesën: nëse kjo nuk është rregulluar me ndonjë ligj tjetër në fuqi, ndryshe4

Votojmë tash!

Për 44
Kundër 17
Abstenime... 10 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 40 – votojmë tash

Për..... 54
Kundër..... 7
Abstenime 3 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 41 – votojmë, tash – ka vërejtje. Urdhëroni

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ - ... Në amendamentin që e keni përpara ka pasur të përmirësuara dy fjalë dhe më vonë kam vërejtur se zëvendësimi i fjalës “demolim” dhe mbulesë në nenet 6.7 dhe 6.8 e ka ndryshuar kuptimin e nenit, prandaj propozoj që të mbetet ashtu siç ka qenë më parë në Ligj, do me thënë të mos votohet ky amendament dhe të mos ndryshohet vetëm fjala “demolim” edhe fjala “mbulesë” të mbesin si kanë qenë në nenin 6.7 dhe 6.8, këto të mos ndryshohen, arsyetimi tjerat mbeten siç i ka propozuar Komisioni.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sala Ahmetaj

DEPUTETJA SALA AHMETAJ - Profesori e dha sqarimin po e përplotësoj. Amendamenti të votohet, por me një korigjim fjala “demolim” dhe “mbulesë” duhet të mbetet si janë në Projektligj, të tjerat të votohen ashtu si janë në amendament.

KRYETARI KOLË BERISHA – a pajtohem tash? Shkojmë në votim me këto vërejtje që u dhanë. Shkojmë në votim – *votojmë tash*

Për..... 54
Kundër..... 10
Abstenime 4 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 42 – votojmë tash!

Për 60
Kundër..... 4 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 43 – votojmë tash

Për..... 60

Kundër..... 6 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 44 – votojmë tash

Për 63
Kundër.... 5 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 45 – Ka vërejtje. Urdhëroni z. Nekibe

DEPUTETJA NEKIBE KELMENDI – Nëse lejon institucioni kompetent atëherë mund t'i shkaktohet dëm rezervatit, por asnjë rezervat nuk duhet të pësojë dëm, nuk e di pse edhe Ligji edhe amendamenti thonë nuk lejohet asnjë veprimtari që shkakton dëmtim të ndonjë rezervati arkeologjik pa lejen e shkruar nga institucioni kompetent. Dëmi bëhet gjithsesi, por tash po varet me leje, në mënyrë institucionale. Nuk e di nëse kjo mund të kalojë kështu, as në Ligj as këtu.

KRYETARI KOLË BERISHA – Përfaqësuesi i Komisionit deputeti Nimon Alimusaj

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ – Unë nuk kam koment rreth kësaj. Komisioni kështu e ka paraparë, ekspertët kanë qenë aty edhe ata e dinë se çfarë dëmtimi mund të lejohet, por...

KRYETARI KOLË BERISHA – Votojmë tash

Për 33
Kundër 21 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 46, janë dy propozime – Nahit Hasani, urdhëroni

DEPUTETI NAHIT HASANHI – I nderuari kryetar, i nderuar ministër, të nderuar kolegë deputetë – Pas shqyrtimi të Ligjit dhe projekt amendamenteve që m'i kanë pru, ne në Komisionin FunkSIONAL e kemi nxjerr një qëndrim përgjysmë thuaja ashtu me kundërshtime vetëm se, mendoj që tash këtu që u tregua ky ta them popullorqe allesh verish me këto amendamente si i kemi i ndryshuar apo nuk i kemi ndryshuar tregon se edhe Komisioni FunkSIONAL për Kulturë, Arsim dhe Shkencë nuk ka qenë në nivelin e duhur për të përgatitë amendamentet. Po, çështja që është këtu më e rëndësishmja është se kemi dy amendamente dhe Ligji. Unë mendoj që Komisioni FunkSIONAL hoqi dorë pikërisht nga amendamenti i vet kur e ka parasysh se e ka marrë kuptimin negativ pikërisht nuk lejohet asnjë intervenim për tokë bujqësore. Unë mund të them se e kam këtu Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut, që është miratuar me 10.12. 1948 në Kombet e Bashkuara dhe neni 17 i kësaj, që ky nen edhe i Komisionit FunkSIONAL edhe i Komisionit për të Drejtat e Njeriut edhe Ligji, neni 7, janë në kundërshtim pikërisht me këtë Kartë të Drejtave të Kombeve të Bashkuara.

Pika e parë e nenit 17 thotë: “Gjithkush ka të drejtë të ketë pasuri, si i vetëm ashtu edhe në bashkësi me të tjerët”. Pika e dytë e këtij neni po ashtu asnjëri nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij, pra me anën e këtij neni bujqit apo ata pronarë të cilët e kanë pasurinë nga këto zona të mbrojtura janë privuar nga e drejta e tyre dhe neni 2 i po kësaj Karte të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut secili i gëzon të gjitha të drejtat dhe liritë e parashtruara në këtë deklaratë pa kurrfarë kufizimesh. Për sa i përket racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, besimit fetar, mendimit politik ose tjetër, origjinës kombëtare a shoqërore, pasurisë, lindjes ose tjetër. Prandaj, pronarët e këtyre janë të sanksionuar me anë të këtij ligji që të shpronësohen me dhunë. Neni 13 i këtij ligji thotë: “Gjithkush ka të drejtën e lirisë së qarkullimit dhe banim brenda kufijve të shtetit”. Me këtë ligj dhe me këtë nen, neni 7 trashëgimisë kulturore na e ndalojmë lëvizjen e lirë të qytetarëve për lëvizje në ato objekte të trashëgimisë ku e kemi marr zona të mbrojtura, ndërsa për këtë tjetrën Protokollin e Konventës së Evropës për të drejtat e njeriut dhe i lirisë themelore në nenin 1 thotë: “çdo person fizik apo juridik ka të drejtën për respektimin e pasurisë së tij”. A e respekton me anë të këtij ligji edhe miratimit të këtij ligji pikërisht këto elemente të personit fizik dhe juridik. Unë mendoj se jo, prandaj si do ta argumentojnë që ne pikërisht në hartat që na kanë pru për trashëgimi kulturore, këtu mund t’i shihni secili nga UNOSEK-u nga Grupi Negociator dhe nga Serbia çfarë lëvizje të lirë do të kenë qytetarët ose pronarët e pronës së tyre nëpër ato territore. Kush do të më thotë se në 200 hektarë të Istogut, që i kap kisha si zonë mbrojtëse, do të kenë liri ata ta lëvrojnë apo ta kultivojnë pasurinë e tyre bujqësore, aktivitetin bujqësor ta bëjnë në pronën e tyre. Me anë të këtij ligji ata janë të sanksionuar që këtu nuk kanë të drejtë për pa e pasur një leje të veçantë nga organi kompetent. Organi kompetent kush do të jetë? Po ashtu i kemi 700 hektarë të Manastirit të Deçanit, po ashtu e kemi Kishën e Levinskit në Prizren, po ashtu e kemi me 42 objekte të cilat i sanksionojnë mbi 20% të sipërfaqes të tokës që qytetarët e Kosovës nuk kanë të drejtë të bëjnë lëvizje, do me thënë sipas Kartës – konventës janë të dënuar apo të gjykuar që ata të mos kenë të drejta për lëvizje dhe punë në aktivitetet bujqësore në pasurinë e tyre. Unë e kam edhe një hartë tjetër, e cila dëshmon pikërisht Manastirin e Deçanit përkatësinë etnike d.m.th. përkatësinë e kishës çfarë ka qenë në kohën e kaluar. Këto mund edhe si dëshmi t’ua japim me të cilën dëshmohet se pikërisht shqiptarët kanë qenë në këtë manastir, por unë në fund të kësaj më duhet të theksoj se të dy këto, unë kam qenë edhe në Komision që të hiqet pikërisht ky nen komplet, sepse është i dëmshëm pikërisht për procesin që do ta kemi pastaj. Prandaj nëse ky miratohet kështu unë u bëj thirrje pronarëve, të cilët i kanë pronat e tyre aty sipas nenit 33 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut të bëjnë ankesa në gjykatën kompetente në Strasburg për mbrojtjen e pasurisë së tyre. Çdo palë kontestuese mund t’i drejtohet gjykatës për çdo shkelje të dispozitave të Konventës e të protokolleve të saj për të cilat mendon se ka faj një palë e kontestuese. Nëse miratohet se qytetarët kanë të drejtë edhe duhet të ankohen Gjykatës së Strasburgut për shkeljen e të drejtave dhe lirisë themelore që u bëhen për pronën dhe lëvizjen e lirë atyre në këtë zonë. Prandaj, dhe një koleg dhe deputet pikërisht nëpër këto trashëgimi kulturore ku i kemi tash sigurisht se dikush është nga Ferizaji dhe di zonën mbrojtëse. E kemi rastin kur kishën e

xhaminë i ndan një mur që , cili do të jetë epërsia dhe kush do të jetë në trashëgimi të mbrojtjes? Cila do të jetë në zonë mbrojtëse xhamia nën kishën apo kisha nën xhami dhe pikërisht për fund dua t'ju tregoj, një barsoletë nga Gjakova, sigurisht se është e rëndësishme për këtë moment se ata thonë: “Kishe dal gjakovari me ble në pazar te një katundar, dhe i thotë a bëjmë pazar për mallin që e kishte, thotë po, i kujt është malli, i babës? Thotë hajde po bëjmë Pazar se me kon i jot nuk guxoj. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit z. Hasani. Profesor Hamiti e ka fjalën.

DEPUTETI SABRI HAMITI – Z. kryetar i Kuvendit – unë e respektoj mënyrën e interpretimit të kolegut pararendës, mirëpo duhet tërhequr vërejtjen, sepse po përsëritet i njëjti fenomen edhe me një nen përpara. Përpara e patëm të njëjtin problem me 7.14 tash jemi te 7.18. Prandaj ,deputetët le t'i lexojnë mirë ligjet në leximin e parë. Te ne gati është bërë formale kalimi me lexim të parë, kalimi në lexim të parë faktikisht është kalim i ligjit dhe tashti kur e kanë lexuar prej germe në germë edhe mbas amendamenteve njerëzve u janë kujtuar çfarë konsekuencash kanë. Unë mendoj, që në kuptimin legjislativ ne sot asgjë nuk mund të bëjmë pos mund të votojmë amendamentet ose të mbetet neni siç ka qenë. Në kuptimin e legjislacionit neni 7.18 dhe varianti i Komisionit nuk thonë asgjë, kurrfarë dallimi pos që përmendën e kanë bërë pllug, do me thënë është e njëjta gjë dhe nuk di pse e kanë bërë. Pra amendamenti 1 dhe amendamenti i Komisionit dhe i ligjit është janë një përmendë,e bërë plug dhe asgjë tjetër nuk ka. Ndërsa amendamenti b, më lejoni të komentoj ,sepse unë shoh dallim të madh, është krejt diçka tjetër dhe amendamenti b) ofron variant, unë për vete me që i pari është mirë, sepse funksionalisht nuk thotë asgjë, përmendë plug, unë për vete në këtë variant për ta bërë më funksional dhe ma të korrigjueshëm nenin 7.18 , do ta votoja (benë) që e ka dhënë Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve. Ju faleminderit.

KRYETARI I KUVENDIT KOLË BERISHA – Ju faleminderit profesor, fjalën e ka nënkryetari i Komisionit Nimon Alimusaj, urdhëroni!

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ – Qe në fillim e kam thënë se Komisioni ka hequr dorë nga amendamenti 46 dhe propozon që të votohet varianti (b) i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komunitetit, këtë e kam thënë që në fillim prandaj edhe tash apeloj në emër të Komisionit që të votohet për variantin e dytë.

KRYETARI KOLË BERISHA – Sanije u dhanë mjaft sqarime lidhur me këtë. Urdhëroni! Sanije Aliaj

DEPUTETJA SANIJE ALIAJ – Z kryetar, të nderuar deputetë, në Komisionin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Interesave të Komuniteteve shqetësimet që i ka dhënë z. Nait ,por edhe unë, i kemi shtruar lidhur – duke u nisur nga ajo që

pasuria e patundshme është pasuri e shenjtë dhe duke u nisur nga fakti që qytetarët kanë të drejtë në punimin e tokës dhe kultivimin kulturave bujqësore. Ne i kemi propozuar këtë amendament dhe kërkojmë që në Kuvend të votohet, por edhe e kemi në gjendje faktike se i kemi dy amendamente prandaj unë, është shumë më i pranueshëm amendamenti i Komisionit për Komunitete dhe kërkoj të votohet. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Kalojmë në votim në variantin (b)

Votojmë tash!

Për 53
Kundër..... 8 - kalon amendamenti – varianti (b)

Amendamenti nr. 47 – Votojmë tash

Për..... 59
Kundër..... 2 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 48 –Votojmë tas!

Për 59
Kundër..... 8 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 49 – Votojmë tash!

Për..... 62
Kundër. 4 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 50 – Votojmë tash

Për..... 57
Kundër.... 5 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 51 – Votojmë tash!

Për..... 62
Kundër.... 7 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 52 – Votojmë tash

Për..... 54
Kundër.... 4 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 53 – Urdhëroni Agim Krasniqi

DEPUTETI AGIM KRASNIQI - Unë desha të bëjë një intervenim krejtësisht parimor këtu. Te amendamenti 53 do të thotë 9.10 Aktivitetet bazike të muzeve, do të thotë do të duhej edhe këtu ta zëvendësojmë fjalën: “aktivitetet” me “veprimtaritë” për të qenë kompatibil edhe me nenin e mëparshëm. Ky korrigjim dhe e detyra, është bërë fenomen apo ndoshta e quajtur sindromë që në shumicën e neneve, të gjitha projektligjeve e kemi fjalën: “ duhet të ketë; duhet të jenë; duhet të bëhen; duhet të sigurohet dhe kemi disa raste për shembull: kemi amendament të posaçëm thotë: “duhet të “ fjala duhet – duhet të fshihet si amendament në raste të tjera plotë e përplot fjalë të tilla që nuk e kanë vendin aty. Edhe këtu kemi disa edhe në këtë nenin 9.11 e kemi: “duhet të ketë lehtësim “ ose në amendamentin e përparshëm “ duhet të jenë nën mbrojtje” jo nën mbrojtje e tjera, d.m.th ne duhet të kemi një lekturim që mos të merremi me këto fjalë edhe korrigjime të tilla por kjo në mënyrë gjenerale le të shkoj të rregullohet. Do të kemi më vonë edhe ndonjë nen tjetër kur kemi demolim – zëvendësimi i fjalës “demolim “ me fjalën “dëmtim”, atëherë le të vlejë në mënyrë gjenerale dhe fjala “demolim” fshihet e në vend të sajë zëvendësohet kudo me fjalën tjetër “dëmtim”. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputetja Sala Ahmetaj

DEPUTETJA SALA AHMETAJ – Për fjalën “aktivitet” dhe për disa fjalë të tjera ne me një amendament të veçantë kemi kërkuar që të korrigjohen.

KRYETARI KOLË BERISHA – Nuk ka nevojë të përsëriten vazhdimisht. kalojmë në votim – *Votojm, tash!*

Për..... 62
Kundër.... 6 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 54 -Votojmë tash

Për 61
Kundër..... 4 - kalon amendamenti

Amendamenti nr. 55 – Votojmë tash

Për..... 57
Kundër..... 3 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 56 –Votojmë tash

Për 63
Kundër 3 – kalon amendamenti

Amendamenti nr. 57 – Votojmë tash

Për..... 54
Kundër 5 – kalon amendamenti

Amendamenti 58 – Votojmë tash

Për..... 61
Kundër..... 6 – kalon amendamenti

Amendamenti 59 – Votojmë, tash

Fjalën e ka nënkryetari i Komisionit Nimon Alimusaj

KRYETARI – Profesor u votua

DEPUTETI NIMON ALIMUSAJ - Veç një sqarim e kam. Nuk e kam qëllim me kërkuar ndryshimin e votimeve, vetëm një sqarim: ky amendamenti 59, ky formulim nuk është hartuar nga Komisioni për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, ky është propozuar nga ekspertët e Këshillit të Evropës, po Ministria e Kulturës paska harrua në këtë version, të cilin ne e kemi përpara.

KRYETARI KOLË BERISHA – Profesor ju lutem është e qartë krejt kjo dhe kemi votuar për amendamentin.

Për 45
Kundër.... 8 – kalon amendamenti

Ju lutem ju thërras që ta votojmë tekstin në tërësi të amendamenteve

Votojmë tash!

Meqenëse kemi ende disa pika të rendit të ditës, jeni për të vazhduar seancën apo ta lëmë për nesër? Natyrisht se, për nesër apo... dhe shikoni, ne fahet juaja e keni gjetur një ftesë që e bëri Kolegji Turk Mehmet Akif për iftar, i theret të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës, në orën 17,30 minuta.

Nëse vazhdoni të flisni të gjithë përnjëherë, unë nuk mund me ju kuptuar çka po thoni.

**Urdhëroni Nafije Berisha
Vazhdojmë nesër në orën 10.**

VAZHDIMI I SEANCËS PLENARE më 10.10.2006

KRYESUESI SABRI HAMITI – Kolegë të çmuar, vazhdojmë punën, pika e 10

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për hulumtimet gjeologjike

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, si komision funksional dhe raportues, është bërë radhitja e rekomandimeve dhe amandamenteve në tekstin e Projektligjit për hulumtime gjeologjike si vijon. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për hulumtime gjeologjike ka bazë juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për hulumtimet gjeologjike dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore. Komisioni për të Drejtat dhe interesat e komuniteteve, ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për hulumtime gjeologjike dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kalojmë në votimet e amendamenteve

Ju lutem, bëhuni gati të votojmë amendamentin nr. 1.

Amendamenti 1

Votojmë tash!

Për 61

Kundër 3

Kalon amendamenti 1

Amendamenti 2

Votojmë tash.

Për 66

Kundër 3

Kalon amendamenti 2

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Për 61

Kundër 4

Kalon amendamenti

Amendamenti 4

Votojmë, tash!

Për.....66

Kundër..... 3

Kalon amendamenti 4

Amendamenti 5

Për.....66

Kundër..... 1

Kalon amendamenti

Amendamenti 6

Për 66

Kundër..... 0

Kalon amendamenti 6

Amendamenti 7

Për.....62

Kundër.....1

Një abstenim.....1

Kalon amendamenti 7

Amendamenti 8

Për.....69

Kundër.....2

Abstenim.....1

Kalon amendamenti 8

Amendamenti 9

Për68

Kundër.....2

Abstenojmë..... 2

Kalon amendamenti numër 9

Amendamenti 10

Për.....71

Kundër..... 2

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 10

Amendamenti 11

Për..... 61

Kundër..... 3

Abstenim..... 3

Kalon amendamenti 11

Amendamenti 12

Për..... 63

Kundër..... 1

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 12

Amendamenti 13

Për.....66
Kundër..... 3
Abstenim.....0

Kalon amendamenti 3

Amendamenti 14

Për.....58
Kundër..... 2
Abstenim.....1

Kalon amendamenti 14

Amendamenti 15

Për.....65
Kundër 1
Abstenim..... 3

Kalon amendamenti 15.

Dhe se fundi do ta votojmë Ligjin në tërësi me amendamentimet që janë bërë. Jemi duke votuar. Urdhëro zonjë, çka ke me thanë.

DEPUTETJA SALA SHALA – Ju faleminderit z. kryesues, përshëndetje për gjithë kolegët deputetë. Unë në fillim e kërkoja fjalën. Në lidhje me këtë projektligj. e shoh të arsyeshme dhe të nevojshme të bëj sqarim në lidhje për Projektligjin për hulumtimet gjeologjike, që e kemi tash në votim, përkatësisht në kapitullin ku rregullohet Agjensioni Gjeologjik i Kosovës. Ky kapitull nuk është amendamentuar pavarësisht nga propozimet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike. Me këtë rast dua t’jua tërheq vërejtjen kolegëve të mi deputetë, se ky projektligj do ta ketë fatin sikurse Projektligji për Miniera dhe Minerale, i cili pret ende në sirtarë pa u nënshkruar. Prandaj unë e kam një sugjerim që si deputet, si Kuvend të kemi shumë kujdes që të mos shndërrohemi vetëm në makina votimi, po, jo, pa i analizuar mirë edhe ato projektligje të cilat nuk janë nënshkruar dhe ta kërkojmë fajtorin pse nuk janë nënshkruar a është se Kuvendi po bien në lajthitje apo nuk është diçka në rregull.

Më lejoni edhe dy tri fjali, sqarim desha të sqarojë këtë Kuvend, Kapitulli ku flitet për Agjensionin Gjeologjik të Kosovës dhe inspeksionin, ka qenë çështja më e përfolur në petkun e temës tabu për shkak të konfrontimit të interesave në mes ndërkombëtarëve dhe vendorëve. Asociacionet e tilla apo dikasterët e tillë siç janë: shërbimet gjeologjike apo agjensionet gjeologjike në Evropë. 70% e tyre funksionojnë si shërbime gjeologjike në nivel Qeverie. Kështu këshillohet edhe në projektin për formimin e Shërbimit Gjeologjik të Kosovës për të cilin e kam pasur dje një pyetje parlamentare, se sa ka kushtuar ky projekt i hartuar nga shërbimi gjeologjik britanez, projekt ky që nuk është përfillë aspak nga sponsori si ndërsa

pyetjes se kush mban përgjegjësinë për mjetet e harxhuara dhe për mosnënshkrimet e këtyre ligjeve përgjigjja do të ishte në qoftë se mund të them: Vire në dardhë: nuk mbanë kurrkush përgjegjësi.

Nuk i kuptojë akrobacionet e këtij koalicioni qeveritar për këto mashtrime që i kanë thjeshtë opinionin se po bëjnë diçka në infrastrukturë ligjore sidomos në ligjet bazike, si është ky që po analizojmë tash. NË vazhden e këtyre mashtrimeve ishte paraqitja pompoze për gjoja suksesin në hartimin e ligjeve që e bënin në zyrtarë qeverie në simpoziumin që u mbajt në Mitrovicën e harruar edhe nga mediat. Sipas këtij zyrtari në Londër po u jepka një çmim për ligjin ma të mirë në Kosovë për miniera, a na e dimë me çfarë ligji funksionojnë minierat , ku janë minierat dhe çka fiton Kosova?

Unë desha të bëjë një sqarim. Votoni ,por do ta pritë fatin e Ligjit të më parshim për miniera dhe minerale, edhe ky ligj nuk do të nënshkruhet, urdhëroni. Ju faleminderit, për fjalën që ma dhat, ju faleminderit që nuk e more fjalën, ju faleminderit të gjithëve.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Zonjë e nderuar, ti je deputete dhe i di rregullat, kur hyhet në votime nuk ka diskutime, megjithatë insistove dhe e more fjalën, e more fjalën dhe i the tri fjali për ligjin dhe kalove në sferat e tjera. Ju lutem keni kujdes, ju i dini rregullat e këtij Parlamenti që keni votuar me konsensus dhe përmbajuni, para se të votohet ligji keni drejtë të jepni vërejtje e hedh në votim pas shqyrtimit të dytë dhe me amendamente plotësuese projektligjin për hulumtimin gjeologjike,

Votojmë tash!

Për	52
Kundër.....	19
Abstenojnë.....	4

Kalon Ligji për hulumtimet gjeologjike

Kalojmë në pikën e rendit të ditës nr. 11

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shëndetin riprodhues

Ju lutem para se të fillojmë, a ka dikush të thotë diçka?,

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si komision funksional dhe raportues në vijim jepen radhitja e rekomandimeve dhe e amandameteve në tekstin e Projektligjit për shëndetin riprodhues si vijon:

Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për Shëndetin riprodhues ka bazën juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për shëndetin riprodhues dhe amendamentet e propozuara nuk përbëjnë implikime buxhetore.

Komisioni për Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për shëndetin riprodhues dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kalojmë në votime të amendamenteve, amendamenti nr. 1 që është i komisionit funksional .Votojmë tash!

Amendamenti 1

Për.....	65
Kundër.....	2

Kalon amendamenti 1

Amendamenti 2

Votojmë tash!

Për.....	62
Abstenim.....	1

Kalon amendamenti 2

Amendamenti 3

Votojmë tash!

Për.....	61
Abstenim.....	1

Kalon amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash!

Për.....	57
Abstenim.....	1

Kalon amendamenti 4

Amendamenti 5

Votojmë tash!

Për.....	61
S'ka abstenime..	

Kalon amendamenti 5

Amendamenti 6

Votojmë tash!

Për.....	55
Abstenim.....	1

Kalon amendamenti

Amendamenti 7
Votojmë tash
 Për..... 60
 Abstenim..... 1
Kalon amendamenti 7

Amendamenti 8
Votojmë tash!
 Për..... 65
 Abstenim..... 2
Kalon amendamenti 8

Amendamenti 9
Votojmë tash!
 Për..... 66
 Abstenim..... 1
Kalon amendamenti 9

Amendamenti 10
Votojmë tash!
 Për..... 60
 Abstenim..... 2
Kalon amendamenti 10

Amendamenti 11
Votojmë tash
 Për..... 64
 Abstenime..... 2
Kalon amendamenti 11

Amendamenti 12
Votojmë tash
 Për..... 59
 Abstenime..... 2
Kalon amendamenti 12

Amendamenti 13
Votojmë tash
 Për..... 58
 Kundër..... 3
 Abstenim..... 3
Kalon amendamenti 13

Amendamenti 14
Votojmë tash!
 Për..... 57

Abstenime..... 3
Kalon amendamenti 14

Amendamenti 15

Votojmë tash!

Për..... 59

Kundër..... 2

Abstenim 1

Kalon amendamenti 15

Amendamenti 16

Votojmë tash!

Për..... 66

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 16.

Nafije Berisha e ka fjalën

DEPUTETJA NAFIJE BERISHA – Fillimi dhe përfundimi i këtij amendamenti janë në kundërshtim me njeri - tjetrin, se në fillim flitet për çdo individ, kurse në fund të amendamentit është lëshuar fjala e “tij”, por ka mbetur vetëm fjala e “saj”, Pra, ose duhet të shtohet “e saj” ose “e tij” ose të hiqet fjala të “saj” krejt dhe pas fjalës jetësore të mbetet “pikë”. Përgatitet gjatë gjithë ciklit jetësor “pikë”. Edhe fshihet të “saj”, d.m.th. nuk prejdukohet në gjini fare.

KRYESUESI SABRI HAMITI – Individu është mashkullore lexo mirë në regull është votojmë amendamentin nr. 17.

Amendamenti 17

Votojmë tash!

Për..... 59

Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 17

Amendamenti 18

Votojmë tash!

Për..... 63

Abstenim..... 4

Kalon amendamenti 18

Amendamenti 19

Votojmë tash!

Për..... 55

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 19

Amendamenti 20

Votojmë tash!

Për..... 57

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 16

Amendamenti 21

Votojmë tash!

Për..... 54

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 21

Amendamenti 22

Votojmë tash!

Për..... 62

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 22

Amendamenti 23

Votojmë tash!

Për..... 62

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 23

Amendamenti 24

Votojmë tash!

Për..... 57

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 24

Amendamenti 25

Votojmë tash!

Për..... 63

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 25

Amendamenti 26

Votojmë tash!

Për..... 58

Kundër..... 2

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 26

Tani e hedhim në votim Projektligjin bashkë me amendamentet që i votuam këtu,

Projektligjin për shëndetin riprodhues

Votojmë tani!

Për..... 67

Abstenim..... 2

Votohet projektligji për shëndetin riprodhues.

Kalomë në pikën vijuese të rendit të ditës

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Peshkatari dhe Aquakulturë

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor si komision funksional dhe raportues në vijim jepen radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e projektligjit për peshkatari dhe aquakulturë si vijon.

Komisioni për Çështje gjyqësore legjisacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për peshkatari dhe aquakulturë ka bazë juridike në Kornizën Kushtetuese.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për Peshkatari akuakulturë dhe amendamentet e propozuara nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe interesat e komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për peshkatari dhe akuakulturë dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Kalojmë në votimet e amendamenteve

Amendamenti 1

Votojmë tash!

Për..... 68

Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 1

Amendamenti 2

Votojmë tash!

Për..... 68

Kundër..... 1

Kalon amendamenti 2

Amendamenti 3

Votojmë tash!

Për..... 62

Kundër..... 1

Abstenime..... 2

Kalon amendamenti 3

Dhe të gjithë janë të Komisionit funksional, pa përjashtim.

Amendamenti 4

Votojmë tash!

Për..... 65

Abstenime..... 2

Kalon amendamenti 4

Amendamenti 5

Votojmë tash!

Për..... 60

Kalon amendamenti 5

Amendamenti 6

Votojmë tash!

Për..... 65

Kundër..... 1

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 6

Amendamenti 7

Votojmë tash!

Për..... 60

Kundër..... 2

Kalon amendamenti 7

Amendamenti 8

Votojmë tash!

Për..... 56

Kundër..... 3

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 8

Amendamenti 9

Votojmë tash!

Për..... 60

Kundër..... 3

Kalon amendamenti 9

Amendamenti 10, pra 10 nuk është votuar, urdhëroni

DEPUTETI MAHIR YAGCILAR – Ju faleminderit z. kryesues, kur është fjala te amendamenti 10 te germa h “pëlqimi ekologjik” duhet me ndryshuar në vend ekologjik duhet “pëlqimi mjedisor” se përputhet me ligjin për mjedisin. Në vend “pëlqimi ekologjik” duhet “pëlqimi mjedisor”

KRYESUESI SABRI HAMITI – Te përfaqësuesi i Komisionit kërkon që te amendamenti 10 te paragrafi nën h Formulimi i “pëlqimi ekologjik” të bëhet “pëlqimi mjedisor”.

E hedh këtë në votim këtë amandament me këtë vërejtje kush është për tash.

Amendamenti 10

Për..... 64
Kundër..... 3
Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 10

Amendamenti 11

Votojmë tash!

Për..... 63
Abstenim..... 1

Amendamenti 12

Votojmë tash!

Për..... 64
Kundër..... 1
Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 12

Amendamenti 13

Votojmë tash!

Për..... 64
Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 13

Amendamenti 14

Votojmë tash!

Për..... 58
Kundër..... 1
Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 14

Amendamenti 15

Votojmë tash!

Për..... 67
Kundër..... 1
Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 15

Amendamenti 16

Votojmë tash!

Për..... 64

Kundër..... 1

Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 16

Amendamenti 17

Votojmë tash!

Për..... 62

Kundër..... 1

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 17

Amendamenti 18

Votojmë tash!

Për..... 65

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 18

Amendamenti 19

Votojmë tash!

Për..... 67

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 19

Amendamenti 20

Votojmë tash!

Për..... 63

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 20

Amendamenti 21

Votojmë tash!

Për..... 68

Kundër..... 2

Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 21

Amendamenti 22

Votojmë tash!

Për..... 65

Kundër..... 1

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 22

Amendamenti 23

Votojmë tash!

Për..... 52

Kalon amendamenti 23

Amendamenti 24

Votojmë tash!

Për..... 62

Kalon amendamenti 14

Amendamenti 25

Votojmë tash!

Për..... 59

Kalon amendamenti 25

Amendamenti 26

Votojmë tash!

Për..... 64

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 26

Amendamenti 27

Votojmë tash!

Për..... 54

Kalon amendamenti 27

Amendamenti 28

Votojmë tash!

Për..... 68

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 28

Unë vetëm po jua kujtoj që në sallë janë 73 veta, është e drejta e njerëzve të votojnë ose të abstenojnë ose të jenë kundër, por të mos të votojnë fare nuk është mirë. Mendoni mirë për këto punë. Është puna e juaj. Ai që nuk do as të votojë as për ,as kundër ai inekzistentë , vullnetarisht.

Ju thërras ta votoni Projektligjin për peshkatari dhe akuakulturë me amendamente që i votuam tani, Votojmë për ligjin në tërësi tani.

Efekti i plotë

Për..... 70

Abstenim 1

Kalon ligji. Votohet projektligji për peshkatari dhe akuakulturë,

Pika e rendit të ditës

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 “Për naftë dhe derivate të saj”.

Në bazë të raporteve të komisioneve kryesore dhe të Komisionit për Ekonomi, Industri, Tregti ,Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion si komision funksional dhe raportues në vijim jepet radhitja e rekomandimeve dhe amendamenteve në tekstin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin të Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivatet e naftës si vijon.

Komisioni për Çështje Gjyqësore ,Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ka vlerësuar se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivatet e naftës ,ka bazë juridike në Kornizën Kushtetues.

Komisioni për Buxhet ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti dhe naftë dhe derivatet e naftës dhe amendamentet e propozuara, nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve ka vlerësuar se dispozitat e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për tregti me naftë dhe derivatet e naftës dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Ne do të procedojmë me votimet e amendamenteve. Votojmë amendamentin nr. 1

Amendamenti 1

Votojmë tash!

Për.....	62
Kundër.....	3
Abstenim.....	4

Kalon amendamenti 1

Amendamenti 2, i komisionit funksional,

Votojmë tash!

Për.....	60
Abstenim.....	3

Kalon amendamenti 2

Amendamenti 3

Votojmë tash!

Për.....	60
Abstenim.....	3

Kalon amendamenti 3

Amendamenti 4

Votojmë tash!

Për..... 6

Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 4

Amendamenti 5

Votojmë tash!

Për..... 61

Abstenim..... 3

Kalon amendamenti 5

Amendamenti 6

Votojmë tash!

Për..... 61

Kundër..... 1

Abstenim..... 1

Kalon amendamenti 6

Amendamenti 7

Votojmë tash!

Për..... 63

Abstenim..... 3

Kalon amendamenti 7

Amendamenti 8

Votojmë tash!

Për..... 59

Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 8

Amendamenti 9

Votojmë tash!

Për..... 61

Abstenim..... 2

Kalon amendamenti 9

E votojmë në tërësi me amandamentimet Projektligjin për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit nr. 2004/5 për naftë dhe derivatet e saj.

Votojmë tash!

Për..... 65

Abstenime..... 2

Konstatohet se Kuvendi me shumicë votash miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/5 për naftë dhe derivatet e saj. Kolegë të çmuar me këtë mbaron rendi i ditës. Ju faleminderit.

Shihemi në seancën e radhës.

